

BIBLIOTEKA
SHTETIT

92

850



LEFTER
DILO

AVNI
RUSTEMI

92
D. 10.

LETTER DILO

AVNI RUSTEMI



Handwritten in blue ink:
A scribble resembling a stylized 'D' or 'L' followed by the number '23066'.

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

NGA LIBHOVA NË SHKOLLËN E MESME

«...që këtej doli një djalë i juaj, i zoti e me zemër të madhe; me zemër të guximshme dhe me mendje të qartë, Avni Rustemi. Ai nuk ishte njeriu i ëndërrimeve të kota, por një revolucionar, dhe ishte pikërisht revolucionar sepse kishte dalë nga gjiri i vuajtur i këtij populli, i këtij qyteti, ku sundonte kalaja e feudalëve, kamxhiku i tyre»¹⁾

Në këmbët e kalasë dhe përreth saj shtrihen lagjet e Libohovës. Shumica e banorëve të tyre shfrytëzoheshin egërsisht nga pashallarët e vendit brez pas brezi. Këta pashallarë, siç thotë populli, u kishin pjekur peshkun në buzë bujkrobërve të të gjithë luginës. Feudalët kishin përvetësuar toka e male, ujin e burimeve të Buretos, pyjet e kullotat, duke i katandisur fshatarët e zonës përreth në bujkërobër të vërtetë.

Feudalët brez pas brezi ishin ngritur kundër luftërave për liri e për çlirimin kombëtar e shoqëror të masave popullore. Kur në Gjirokastër vep-

1) Enver Hoxha. Fjalim në Libohovë. «Zëri i popullit», 29 maj 1969.

ronte Abdyl Frashëri me shokë, Neki pashë Libohova, pasardhës i Maliq pashës u ngrit hapur kundër lëvizjes patriotike. Pashai disfatist e tradhtar u ngrit kundër organizimit të Degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Gjirokastrë. Në këtë kohë Abdyl Frashëri u detyrua t'i jepte këtij tradhtari një pëllëmbë të shëndoshë në një mbledhje të organizuar në Gjirokastrë. Maliq pashë Libohova, gjyshi i Mufit bej Libohovës dallohej përmbi pashallarët e tjerë jo vetëm nga pasuria që zotëronte por edhe nga krimet që kryente.¹⁾ Mizoritë e tij ishin të panumërta. Ai ekzekutonte në litar fshatarë të rinj për kundërshtimet që i bënin. Kështu veproi ai me V. Naçin nga Peshkopia e Poshtme e Gjirokastrës, të cilin e vari në dritaren e shtëpisë së vet²⁾. Ai i shfrytëzonte gjer në palcë fshatarët e Bularatit. Maliq pasha u kishte rrëmbyer nga goja ujët e pijshëm fshatarëve të Dropullit, atë ujë të cilin nipi i tij, Mufit bej Libohova pretendonte, me paturpësinë më të madhe, në një letër të datës 5 gusht 1920, «se ishte prona e tij e trashëguar nga Ali pashë Tepelena»³⁾. Ai nuk i lejonte fshatarët të pinin nga ky ujë, pa le pastaj të ujitnin tokat e tyre.

Por Libohova e punës dhe e trimave e përbuzi pashanë dhe oxhakun e tij. Bejlerët gjakpirës shkonnin të dehur në Kalista, tok me qentë e tyre të tërbuar, të cilët i lëshonin përmbi bujqit e fshatarët e mjerë. Por fshatarët e shtypur e të shfrytëzuar deri në palcë, i urrenin shtypësit e egër, që jetonin në kurriz të tyre dhe revoltën e tyre e shprehnin edhe

1) Historiku i fshatit.

2) Po aty.

3) Fondi i Muzeut Historik të Gjirokastrës.

me armë në dorë. «Pashai — shkruante një fshatar nga Nepravishta — ishte gjysmë injorant, vrasës e gjakpirës dhe grabitës tokash, strehues kriminelësh, që nuk ngopesh së përvetësuarit arat e Zervatit, në Agoradhe, etj.¹⁾

Megjithë mjerimin dhe varfërinë e madhe, Libohova i ruajti nëpër shekuj traditat e mrekullueshme të krahinës, duke përbuzur jetën e shthurur të pashait. Nga kjo Libohovë ishin ato amvisa që i përmend me nderim Bajroni, kur kaloi në Libohovë, në tetor 1809 dhe gjeti këtu «gatimet më të mira, që nuk i kishte shijuar, as në Spanjë e as në Portugali»²⁾. Ai pa e adhurroi veshje e armë të bukura kombëtare, në kundërshtim me pallatet e pashallarëve, në të cilat gjendeshin armë të dhuruara nga vetë sulltanët, shpata si ajo e sulltan Bajazitit, dorëzat e të cilave ishin mbushur me gurë të çmuar. Aty kishte armë e jatagane, me të cilat ishin kërcënuar e vrarë patriotë libohovitë, pionierë të gjuhës amtare. Kështu më 1882, Koto Hoxhi shkoi për të kërkuar aprovimin e Maliq pashës për çeljen e shkollës së parë shqipe në Gjirokastër. Pashai tërë zemërim iu përgjigj «se shkollat turqishte e greqishte ishin mjaft, dhe se të tjera nuk i duheshin gjë vendit»³⁾. Në atë kohë pashai i Libohovës, i lidhur ngushtë me arkondin gjirokastrit Nikollaq Zoton ishin ngritur në këmbë kundër mësuesve të parë të gjuhës e të arsimit shqip, që përhapnin abetaret e para shqipe.⁴⁾

Muret e dhomave të sarajeve të pashait të Libo-

1) Historiku i fshatit Peshkopi.

2) Illyria. Tiranë, 1936.

3) Papapano — Kujtime.

4) Po aty.

hovës ishin zbukuruar me armë e dhurata të sulltanëve e të qeveritarëve turq. Numrin e tyre e shtoi pasardhësi i tij, Mufit beu, me shpatat e dhuruara nga sulltan Abdyl Hamiti, i mbiemëruari «i kuq» për krimet e masakrat që bënte. Aty gjeje sahatë me vlerë që mbanin portretin e sulltan Reshatit VI, dhuruar Mufit beut, si shpërblim për librin e shkruar prej tij për Ali pashë Tepelenën, të cilin ai në këtë vepër e paraqet me origjinë turke.¹⁾

Hija e rëndë dhe e uñryer e sarajeve të pashallarëve e bejlerëve sundonte këtu tok me vatrat e fesë. Ndërsa brenda shtëpive të varfëra të Libohovës jetonin gratë e veja me burrat gjallë, që i prisnin t'u vinin nga mërgimi apo nga shërbimi nëntëvjeçar ushtarak. Taksidarët e xhandarët, të ulur në krye të vatrave varfanjake kërkonin taksat e vegjëlisë, taksën e së dhjetës edhe atëherë kur fshatari i Libohovës kishte në dhomën e tij përdhese vetëm ndonjë rrogë të tretur, ndonjë poçe të thyer, apo ndonjë okëmiell të misërt, në një trastë të grisur. Tagrambledhësit e pashpirtë, me forcën e armëve i hiqnin nga goja popullit bukën e fëmijës, kulaçin e hirit, u rrëmbenin edhe pulën kllockë, që e thernin para syve të tyre. Me kërrabë e me parmendë mbaheshin këto familje të varfëra, kryetarët e të cilave rrallëherë ktheheshin nga Tripoli, ku i dërgonte otomani, për të kryer shërbimin ushtarak. Shpesh ata ktheheshin duke mos gjetur në shtëpitë e tyre as prindërit, as arat, as vreshtat, as qetë, të cilët ishin vrrarë ose rrëmbyer nga xhandarët e Turqisë, ose nga pashallarët e pangopur.²⁾

1) Gazeta «Shqiptari». Stamboll, 11.2.1911, Nr. 50.

2) Fondi i Muzeut Historik Gjirokastër.

Në këtë mjerim jetonin banorët e varfër të Libohovës dhe të fshatrave, kur brenda në kala gëzonin sundimtarët e pashallarët e urryer. Një i tillë ishte edhe Mufit bej Libohova, nipi i Maliq pashës dhe i biri i Nekiut, grabitës i pangopur si i ati dhe stërgjyshërit e tij.

Kundër tij dhe asaj klase, së cilës i përkiste ai, u ngrit me forcë djali i lagjes Marinë, Avni Rustemi, lindur më 22 shtator 1895¹⁾, për të mbetur i pavdekshëm në historinë revolucionare të popullit të vet, si një personalitet demokrat revolucionar.

Ishte a nuk ishte 5-6 vjeç Mufit Libohova, kur në sarajin e tyre u paraqit një bashkëpunëtor i ngushtë i Abdyl Frashërit, dhe i kërkoi pashait të Libohovës që të bashkoheshin edhe krerët e Libohovës me Degën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. I dërguari i Abdyl Frashërit bisedoi drejtpërdrejt me Neki pashën, që kishte aty pranë e nëpër këmbë djemtë e tij: Mufitin dhe Sedatin.²⁾ Neki pasha u ngrit, mbylli mirë derën e dhomës, dhe i tregoi bashkëbiseduesit të vet djemtë e tij, duke i thënë se më parë e mbi të gjitha donte ata, «ndërsa Abdyl Frashëri — shtonte Neki pashë Libohova — e harroi familjen dhe mejtoi Shqipërinë».

Dhe ashtu siç u ngrit Neki pasha e luftoi kundër lëvizjes patriotike antiotomane të popullit të vet, ashtu u ngritën edhe djemtë e tij kundër interesave të atdheut.

Djemtë e pashait të Libohovës, punuan në shërbim të pushtuesve, gjithnjë në dëm të interesave të

1) Procesverbali Nr. 5 i gjykatës penale të Senit Nr. 791 — Paris, 13.6.1920.

2) Petraq Pepo. «Kujtime veteranësh» (1878-1912). Tiranë 1962.

atdheut, për t'i shërbyer klasës së tyre dhe për të përjetësuar sundimin e egër e shfrytëzues përmbi popullin e mjeruar. Ashtu si edhe prindërit e tij/Mu-fiti punoi për sulltanët, për princin gjerman Vidin, për imperialistët italianë dhe u bë bashkëpunëtor i ngushtë i Esat pashë Toptanit.

Në këto kushte social historike kur egzistonte një shtypje e shfrytëzim i egër feudal, të cilit masat popullore i përgjigjeshin me urrejtje dhe me lëvizje të fuqishme antifeudale e antiturke, në krahinën e Gjirokastrës lindi dhe u rrit Avni Rustemi, djali patriot i lagjes Marinë.

Avniu ishte bir i një familjeje patriote, që gjithë jetën bashkë me të vëllanë e tij më të madh Fejzon, ia kushtuan çlirimit të vendit nga pushtuesit dhe çlirimit të masave popullore nga shfrytëzimi çifligaroborgjez. I ati i Avniut, Neim Rustemi, ishte njeri i shkolluar. Ai njihte turqishten e greqishten. Ishte bujk në Libohovë¹⁾. Që prej shumë kohe, në mënyra të ndryshme ai kishte shprehur urrejtjen për pashanë dhe beun. Neim Rustemi kishte edhe tre vëllezër të tjerë dhe dy motra, Me gruan e parë ai pati tre djem. Me gruan e dytë, Lalenë, pati dy fëmijë: Avniun dhe motrën e tij, Xhanon.

Një rol kryesor në edukimin e Avniut me virtyte të rralla luajti mëma e tij Laleja. Ajo ishte një grua e mënçur, fisnike, tepër e shkathët, e zonja për të mbajtur rregull në një familje aq të madhe me dy barqe. Për këtë ajo nderohej e respektohej nga e gjithë lagjja Marinë.²⁾ Mëmë Laleja ishte amvisë me

1) Botim i AQSH. Avni Rustemi. Tiranë 1974, f. 43

2) Qendra Kulturore — Klubi i opingarëve «Shpresa» — Gjirokastrë.

autoritet, e zonja për të edukuar fëmijët e saj dhe e dashur me njerëzit. Avniu gjatë gjithë jetës e ka kujtuar me respekt të thellë.

Si një ballkon i gjerë përmbi fushë qëndon lagja Marinë ku lindi e u rrit Avniu. Aty ai u rrit gjer në moshën 12-vjeçare.¹⁾ Gjatë kësaj kohe ai pa fshatarët e vuajtur që punonin në fushë. Mbrëmjeve dëgjonte tregime nga i ati dhe i vëllai për grabitjet e bejlerëve e për tradhtinë e tyre, për pasurinë e madhe që kishin grumbulluar dhe për urrejtjen që kishite populli për ta. Më vonë, në disa kujtime të tij, Avniu tregonte se «duhet të kesh parë e dëgjuar si vepronin bejlerët e aristokratët, për t'i urreyer ata».²⁾

Me një çantë prej rrobe hedhur në sup, kalonte mëngjes për mëngjes Avniu i vogël për në shkollën fillore, nga Marina në qendrën e Libohovës. Ecte çdo ditë rreth dy orë në këmbë për të ndjekur mësimet. Po atë rrugë bënin edhe djemtë e Nepravishtës. Nga kodra e gjer te xhamia rruga ishte e drejtë. Duke luajtur ai bashkë me shokët e vet i afroheshin shkollës, tok me djemtë e Nepravishtës. Ditët e tjera ata takoheshin nëpër sofatë e portave të tyre me qemer të gurtë, ose në shpellat e Kodrës së Marinës. Takimet e shpeshta e kishin njohur atë me fëmijët e fshatit, të cilët i donte shumë. Atë shoqëri e miqësi Avniu e mbajti të gjallë tërë jetën, gjer në ditët e fundit të tij. Edhe shokët nuk e harruan për asnjë çast atë.

Kur Avniu u nis për në shkollën e mesme të Janinës me dashuri e përcolli gjithë familja: motrat e vëllezërit, mëmë Laleja që e vështronte në sy, e

1) Qendra Kulturore — Klubi i opingarëve «Shpresa» — Gjirokastrë.

2) Fondi i Muzeut Historik — Gjirokastrë.

i ati që nuk kurseu asgjë për t'i dhënë arsim. Vetë i ati e shoqëroi gjer në Janinë. Ai e porositi të mësonte e të shkonte në konvikt bashkë me vëllanë e tij Fejzon, më të madh nga mosha, ta dëgjonte atë si dhe kujdestarin, që do të interesohej për të e që banonte në një fshat afër Janinës.

Mbrëmjeve Avniu dëgjonte nga i vëllai tregime për patriotët shqiptarë që punonin në Janinë, për lëvizjet e para për arsimin shqip, për klubet që kërkonin të çelnin, për shkrimet në shtypin e qytetit, për shtrembërimet e shpifjet kundër lëvizjes sonë kombëtare, që herë pas here bënin gazetat e huaja.

✓ Në Janinë Avniu me shokët e tij, lexoi librat e para shqipe, botimet e Naimit, të Samiut, të Çajupit, kalendarët shqip botuar në Bukuresht, në Sofje, etj. Por ai që në të vërtetë u bë një mësues i parë për Avniun ishte Fejzua, i vëllai, i cili si në shkollë ashtu dhe jashtë saj dallohej për ndjenjat patriotike. Fejzua lexonte mjaft libra shqip, me të cilat e furnizonte një nëpunës në Janinë, që i thoshte shpesh: «Ju do ta gëzoni Shqipërinë». Ai ia forconte më tej ndjenjën e dashurisë për vendin, dhe për çlirimin e tij.

Studentët e rinj si Avniu, dëgjonin me habi e të emocionuar kujtime nga jeta shkollë e Naimit, Kristoforidhit, Vretos, Samiut, Ismail Qemalit, të cilët ishin shquar në mësim, duke ua shkuar shokëve të tjerë, për vullnetin, për dashurinë për dije e kulturë, për alfabetin latin, për të cilin një bashkënxënës i Naimit shkruan: «Shokët tanë grekë na përqeshnin meqenëse i flisnim keq për disa germa të abecesë greke, po dhe ne e merrnim hakën çdo herë që, në mësimin e latinishtes, kur ata përpiqeshin kot të thoshnin drejt germen b». Qysh në gjimnazin

«Zosimea» Naimi, me shokët e tjerë shqiptarë, mendonin se alfabeti latin ishte i favorshëm për gjuhën shqipe, duke qënë të kënaqur e të shpërblyer çdo herë që profesori i tregonte ata si shembull për shqiptimin e mirë të fjalëve latine»¹⁾.

Në Janinë shqiptarët ruanin kujtime nga mbledhjet e para, që ishin bërë këtu nga patriotët për një lidhje shqiptare. Në pranverë të vitit 1877 atje doli «Memorandumi i Janinës», hartuar nga Abdyl Frashëri, Koto Hoxhi etj. Koto Hoxhi, duke theksuar qëllimin e Memorandumit të Janinës shkruante se «fjala e Janinës ishte e para fjalë e jona, duke kërkuar me anën e saj të ishim autonomë, si po punojnë që të bëhen ata që ka rreth e qark mëmëdheu ynë».²⁾

Në Janinë shqiptarëve u shpërndahej një literaturë përparimtare, e cila dërgohej nga rrethet patriotike shqiptare të Bukureshtit dhe të Egjiptit. Atje kishte nxënës shqiptarë nga shumë krahina të ndryshme, që nga Filati e Elbasani, Durrësi, etj. Atje i vëllai i Avniut u njoh me studentin Sali Ceka. Në Janinë në fillim të shekullit tonë jetonin e punonin Nuçi Naçi, Kadri Gjata, etj.

Avni Rustemi shkoi për të vijuar mësimet në shkollën e mesme në Janinë³⁾, ku/kreu klasën e tretë, të katërt e të pestë me nota të shkëlqyera⁴⁾. Avniu shkante herë pas here në Bizdun, afër Janinës, ku jetonte familjarisht Metin Haxhiu, martuar me mot-

1) «Demokratia». Gjirokastrë, 18.1.1931.

2) Koto Hoxhi. Kopje e letrës. Muzeu Historik Gjirokastrë.

3) Emin Bilibashi. — Kujtime. QK GJ.

4) Po aty.

rën e madhe të tij, i cili dallohej si një përhapës i librave të para shqipe e si patriot i palodhur. Metini dinte të shkruante gjuhën shqipe. Gazetat e para shqipe që i nxirrte emigracioni, ai i përhapte rregullisht, duke i siguruar me anën e një bashkëfshatari që punonte në konsullatën franceze, në Janinë. Ai mbante lidhje me mësues shetitës të shqipes si Musa Demi, Nane Panajot Mexsi etj.¹⁾

Në këto rrethana e në lidhje të ngushtë me patriotët e kohës, po rritej e po formohej Avni Rustemi. Duke mësuar shkrimin shqip me shkronja latine ai mundi të lexonte literaturë të ndryshme e botime me alfabetin e shoqërisë së Stambollit. /Përshtypje të madhe i bëri veçanërisht atij leximi i veprës «Histori e Skenderbeut» e Naim Frashërit. Ai e lexonte dhe e rilexonte atë, dhe nëpërmjet saj njihej me fitoret e shkëlqyera të popullit shqiptar me Gjergj Kastriotin — Skënderbeun në krye. Kjo vepër la mbresa të thella në mendjen e shpirtin e Avniut. Ai i vuri vetes detyrë ta mësonte përmendsh atë epope të hartuar nga shkrimtari ynë i madh i Rilindjes.

Me këmbëngulje e me vullnet të madh ai përveçtesoi pjesë të tëra përmendsh nga kjo poemë, të cilat ua recitonte pastaj shokëve me mjeshtëri. Shumë fragmente të asaj epopeje i përdori si mjet për të përhapur ndjenjat patriotike. Vargjet e Naimit, të Çajupit, etj., i përdori për të bindur njerëzit që të mësonin shqipen. Një mësues i Avniut ishte Nuçi Naçi, drejtor i vjetër i shkollës shqipe të Korçës, burgosur dhe persekutuar nga turqit²⁾. Në vitet 1906-

1) Emin Bilibashi. Kujtime. QKGJ.

2) Bajo Topulli. Autobiografia. Fondi i Muzeut — Gjirokastrë.

-1930 ky mësues punoi për themelimin e gazetës «Zgjimi i Shqipërisë», që doli në Janinë më 1909.

Edhe në Janinë Avniut i ra në sy bashkëpunimi i bejlerëve me qeveritarët e lartë të Turqisë. Ai konstatoi se mjaft prej tyre, në vend që të ndihmonin lëvizjen shqiptare ishin ngritur kundër saj dhe bile këshillonin patriotët e rinj «të prisnin», ashtu si vepronte edhe Mufit bej Libohova. Nga fillimi i vitit 1908¹⁾, kur Avniu ishte akoma student në Janinë, u informua se qeveria turke, me një telegram drejtuar valiut në Janinë (vjeshtë 1907) urdhëronte ndjekjet kundër çetës së Çerçiz Topullit dhe premtonte se do t'i jepte një shumë prej 1500 lira turke atij që do të vriste Çerçiz Topullin me shokë. Avniu, i bindur për faktin se nuk kishte shqiptar që ta tradhtonte çetën për të hollat, u përgjigj atypëraty. «E kanë kot, mos ki frikë, nuk ka shqiptar që të tradhtojë Çerçizin me shokët e tij».²⁾

Avniu ishte akoma djalë i ri, kur u kthye në Gjirokastrë. Pasi kishte ikur në këmbë nga Janina, shkoi në Libohovë, mandej në fshatrat e Gjirokastrës, pastaj në qytet, ku u takua me vëllezërit e Çerçiz Topullit. «Duke pyetur për ne — tregon M. Gramenua — ai kërkoi të bashkohej me çetën, por e këshilluam të kthehej në shkollë, pa më tutje le të vinte me ne»³⁾. Në mbrëmje e kapi policia, e cila ishte lajmëruar nga Janina për ikjen e tij nga shkolla. Kështu e nisën përsëri në Janinë dhe e mbyllën në shkollë. Me sa duket nuk e vazhdoi dot gjimnazin, se e për-

1) «Liria». Selanik, 21.1.1908 dhe 24.5.1908.

2) Mahmut Xhafo Libohova. Kujtime. Fondi i Muzeut Historik të Gjirokastrës.

3) Mihal Grameno. «Kryengritja Shqiptare».

jashtuan për shkak të largimit të fshehtë dhe të përpjekjeve për t'u bashkuar me çetën kryengritëse. Për këtë arsye thuhet se shkoi në gjimnazin e Selanikut.¹⁾ Më vonë, në dhjetor 1909 ai u kthye në Libohovë. Në këtë kohë, me anën e një lajmërimi botuar në gazetë, Nuçi Naçi «aprovonte mendimin e tij për të shkuar në Normalen e Elbasanit, që ishte hapur atje»²⁾.

Avniu ishte i vendosur të shkonte në çetën kryengritëse. Këtë e vërtetojnë shokët e tij bashkëkohës Eqrem Çano e Mahmut Xhafo. I pari tregon se Avniu i kishte thënë atij «se në qoftë se nuk mund të eci dot vetë nëpër gërxhe e male, atëhere do të më marrë kalaqafë Çerçiz Topulli». I dyti shkon edhe më tutje, duke e sqaruar më mirë këtë dëshirë të Avniut dhe duke shtuar «se kushdo që do ta shihte Avniun e vogël pranë Çerçizit me shokë, ashtu të pafuqishëm siç ishte, nuk do të qëndronte pa i shkuar pas Çerçizit, i cili — siç thoshte Avniu — do të më merrte në kurriz, kur do t'i duhej të kalonte vende që nuk mund t'i kapërcente dot, pa ndihmën e tij».³⁾

Ka të tjerë që tregojnë se Çerçizi e mbajti Avniun tri ditë në çetë, pastaj e dërgoi përsëri në shkollë. Këto ai i ka kujtuar vetë në bisedën e bërë në Gjirokastrë, kur u kthye nga Parisi ku, midis të tjerave foli dhe për edukimin patriotik që u kish dhënë mëma e Çerçizit fëmijëve të saj. Në atë kohë Avniu kishte marrë vesh ndjekjet kundër familjes e vëllezërve të Çerçiz Topullit, që u burgosën në Janinë e që u zvarritën, të lidhur me hekura. Ai ishte

1) Mahmut Xhafo Libohova. Kujtime.

2) «Zgjimi i Shqipërisë». Janinë, 17.12.1909.

3) Fondi i Muzeut Historik Gjirokastrë.

informuar për bastisjet e përditshme të shtëpisë së tyre nga turqit, për mëmën e tyre, Hason, që nuk i qe trembur kurrë syri, por kishte qëndruar si luane-shë, duke mbajtur edhe gjashtore në dorë për orën e fundit.¹⁾

Edukimi patriotik që kishte marrë Avniu jo vetëm në familje por edhe në gjirin e popullit e midis patriotëve të tjerë nxiti jo vetëm atë, por edhe vëllanë e tij, Fejzon, të bashkohej me çetën. Në vend të Avniut, që nuk u pranua në çetë për arsye të moshës së re, shkoi Fejzua. Ai, një ditë, i veshur si hoxhë, me sarëk në kokë, tok me patriotin veteran Idriz Gurin u nis për në çetë. Fejzua ishte 26-28 vjeç, djalë i bëshëm e i fortë. Ai kaloi malin e Sopotit mbi Gjirokastër për të takuar çetën kryengritëse. Shoku, që e shoqëronte e paraqiti «hoxhën» tek Çerçizi dhe Mihal Gramenua me shokë, gjoja sikur ai kishte ardhur për të takuar kryengritësit.²⁾ Po sa u shtrua biseda mirë e mirë, Fejzo Rustemi flaku tutje sarëkun dhe rrëmbeu veshjen e kryengritësit. Që nga ajo ditë ai nuk u nda nga çeta, dhe luftoi me guxim kudo, veçanërisht në luftën e Vodicsës, ku tregoi trimëri të madhe».³⁾

Djemtë e Neim Rustemit, që të dy, nuk u ndanë kurrë nga lëvizja patriotike. Avniu vetë, me të marrë vesh se Çerçiz Topulli me Gramenon e shokë ishin nisur nga Manastiri në Korçë dhe prej andej do vinin në Gjirokastër, doli «tri orë larg Gjirokastrës për t'u takuar me pjesëtarët e çetës, që do të hynin

1) Mihal Grameno. Gazeta «Koha». Jamestown NY, 31 gusht 1918.

2) M. Grameno. Antikat Kombëtare. Tiranë 1975.

3) M. Grameno. Gazeta «Koha». Korçë, 24.4.1924.

në qytet.¹⁾ I përmalluar ai bisedoi me Çerçizin e me Mihalin, kërkoi prej tyre të dhëna e udhëzime për veprimet e nevojshme dhe shfaqti mendimin se bashkë me ca shokë të tjerë do të vinte në Gjirokastrë.

Mihal Gramenua duke kujtuar këtë ngjarje tregon «se ai e shtrëngoi djalosin e ri dhe e uthi me mall, duke i thënë të mos dëshpërohej se pritja e tij ishte e hapur edhe kishte kohë të punonte më mirë se ata për atdhenë»²⁾ Gramenua, luftëtar dhe shkrimtar, shikonte që në atë kohë te djaloshi i ri revolucionar «një patriot të madh, në sytë e të cilit lexohej dëshira e zjarhtë, për t'i shërbyer atdheut me gjithë forcën e shpirtit». Gramenua çmonte veçanërisht vullnetin dhe dëshirën e madhe të Avniut të etur për dituri.

Tok me kryengritësit, që hynë në Gjirokastrë ishte edhe Avniu. Bashkërisht u ngjiten kalldrëmeve të qytetit, për të shkuar në vatrën e Topullarajve, për t'u ndalur e nderuar me shkrepje armësh, dëshmorin e Mashkullorës, djalin e Tremishtit të Përmetit, që ishte varrosur nën muret e kalasë, i rënë para shtatë muajve, në luftë me turqit.

Ishte e dyta herë që Avniu ndodhej në shtëpinë e patriotëve Topullitë, e dyta herë që takohej me mëmën e tyre, me këtë kardhiqote trime, që pa u trembur para asnjë vështirësie, kishte ndihmuar çetën. Ajo kishte punuar në prapavijë, e bashkë me vajzën e saj u shpinte në Gjorkane bukë dhe fishekë luftëtarëve të lirisë. Asaj s'i bëri veshi tër, as natë as ditë edhe atëhere kur xhandarët i binin portës,

1) M. Grameno. Gazeta «Koha». Korçë, 24.4.1924.

2) Po aty.



Shtëpia ku lindi Avni Rustemi, në Libohovë.
(Porta e shtëpisë).



Avni Rustemi, student
në Normalen e Elbasanit
në vitin shkollor
1909-10.



Kolegji i Shën Mitër Koronës te arbëreshët,
në të cilin studioi Avniu.



MEMORANDUM

DELLA

Lega della Gioventù Albanese

IN

S. DEMETRIO CORONE

AGLI

ALBANESI D'ITALIA



CORIGLIANO CALABRO
STABILIMENTO TIPOGRAFICO DEL POPOLANO

1919

Memorandum i hartuar nga Avni Rustemi më 1919 kundër
Evropës kapitaliste.

për t'i kontrolluar shtëpinë, kur Çerçizi me shokë ishte në male e në luftë.

Në vjeshtë të vitit 1908 Avniu u largua nga Gjirakastra e u kthye në Libohovë. Mandej kaloi në Janinë, ku pati rastin të dëgjonte fjalën programatike të Bajo Topullit për shoqëritë e klubet shqiptare. Aty Bajua foli për nevojën e madhe të lulëzimit të gjuhës shqipe që «si një lule e bukur ishte mbuluar nga ferrat». ¹⁾

Përparimi i klubeve shqiptare, i shoqërive dhe i shkollave shqipe si në Janinë, Gjirakastër, Delvinë, Tepelenë, Përmet e nëpër disa katunde si në Progona, Filat, Ninat, frymëzonte të rinjtë revolucionarë. Avniu shkonte shpesh nga Libohova në Gjirakastër për t'i njohur mësuesit e gjuhës shqipe të shkollës «Liria», për të parë ndonjë libër a botim tjetër shqip në bibliotekën e klubit «Drita» të Gjirakastrës. Por këtu ai pa nga afër edhe persekutimet që bënin turqit kundër shkollës shqipe të Gjirakastrës dhe mësuesit Andrea Konomi. Pa se si qytetarët duke u ngritur kundër prefektit i dolën zot mësuesit shqiptar. Njëkohësisht ai pa se si nxënësit e asaj shkolle fillore shqipe bashkë me studentët e gjysmë gjimnazit turk të qytetit ishin ngritur në revoltë kundër autoriteteve turke. Në një ditë vjeshte të vitit 1909, Avniu duke biseduar me shokun e vet, në dhomën e bibliotekës së klubit «Drita», rreth qëndrimit armiqësor të autoriteteve të prefekturës ndaj patriotëve, të cilët i kërcënonin me tortura, burgim e raprezalje të tjera shfaqti mendimin se «këta tiranë nuk mund të hiqen nga mesi vetëm me metingje e me protesta, por se duhet gjishti i një Hitoje dhe i një Bajrami

1) Gazeta «Liria». Selanik, 11 vjeshtë e I, 1908



tjetër, që të shpëtojmë nga Prefekti, si shpëtuam dy vjet përpara nga bimbashi».1)

Avniu tregonte interes të madh për lëvizjen kulturore-teatrale të studentëve të rinj shqiptarë në Janinë. Atje vepronte rrethi letrar «Toskëria», një pjesë e të cilit, më vonë formoi «Ligën iliriane» në Berat, e cila hapi një fushatë të gjerë, për të ndihmuar në çeljen e Normales shqipe në Elbasan. Avniu vinte shpesh nga Libohova në Janinë. Në verë të vitit 1910 ai mori pjesë në përpjekjet që bënë patriotët shqiptarë të Janinës për organizimin e një kongresi që do të shprehte solidaritetin lidhur me ngjarjet e Shqipërisë së Veriut. Atje mendohej të ngrihej një «Bandë e Lirisë», e cila të buçiste si «bandë e shqiptarëve».2)

Në Janinë ai u njoh më mirë me përpjekjet për çeljen e shkollës Normale në Elbasan. I këshilluar me mësuesin Nuçi Naçi u nis për atje.3)

1) Botim i Muzeut Historik të Gjirokastrës, 5.11.1973.

2) «Lidhja ortodokse». Korçë, 31 maj 1910.

3) «Zgjimi i Shqipërisë», 17.12.1909.

«NJË TJETËR PUSHKË MAUZER» NË NORMALEN E ELBASANIT

«Në një ditë të errët të motit 1909, m'u paraqit një djalë i ri, i urtë, i dobët, nga shëndeti, me një fytyrë si të frikshme e të mallëngjyeshme. Ky djalë, në kohën e mësimit e të pushimit, ia kushtoi të gjithë fuqinë e vet, cenën e vet arsimin e sidomos shprehjeve të ndjenjave kombëtare e idhesë kombëtare. Në të vërtetë ky djalë kje e u ba shembull i rrallë për shqiptarët».

LUIGJ GURAKUQI

Në sajë të luftës dhe përpjekjeve të parreshtura të popullit tonë arsimdashës, i cili krahas shkollave fillore shqipe kërkonte edhe një normale shqipe, u bë e mundur të çelej në dhjetor të vitit 1909 Normalja e Elbasanit. Çelja e shkollës u prit me një gëzim të papërshekruar nga jugu gjer në veri. Qeveritarët turq u munduan me çdo mënyrë t'i pengonin nxënësit që dëshironin të vinin atje. Patriotët shqiptarë anëmbanë vendit si Jani Minga në Vlorë, Bab Dud Karbunara në Berat, Andrea Konomi e Thoma Papapano në Gjirokastër, Mihal Gramenua në Kor-

çë, etj. punuan për të dërguar sa më shumë nxënës në shkollën e parë normale shqipe. Për atë shkollë punuan veçanërisht mësuesit patriotë të Elbasanit, midis të cilëve u shquan Luigj Gurakuqi, Sotir Peci etj. Me gjithë vuajtjet, ndjekjet dhe mjerimet e mërgimit, mësues si Thoma Avrami e të tjerë, vinin nga Egjipti me besim të madh në të ardhmen e Shqipërisë për të punuar në shkollat e para shqipe. Duke folur për gjendjen ekonomike të asaj kohe, Thoma Avrami tregon se në Kajro po vdiste për bukë, se rroba s'kishte, se pantallonat prapa i qenë bërë copë, se kishte 7 vjet që vuante në kurbet duke punuar për të «shenjtin qëllim» dhe se dëshira e tij e madhe ishte të vinte në Shqipëri e të bëhej mësues». Si Thoma Avrami menduan e punuan edhe shumë e shumë të tjerë, që mbetën ndër themeluesit e shkollave dhe të klubeve të para shqipe.

Kështu vepruan Luigj Gurakuqi, Bajram Curri, Bajo Topulli e Sotir Peci, Aleksandër Xhuvani e Simon Shuteriqi. Në saje të përpjekjeve të tyre e përkrahjes së masave popullore shqiptare e arsimdashëse u arrit të hapej Normalja e Elbasanit, që u bë një vatër e rëndësishme e përhapjes së dritës e të diturisë.

Studentët që erdhën në Normalen e Elbasanit me qeleshet e tyre të bardha në kokë, si një mbulesë kombëtare,¹⁾ u rreshtuan në oborrin e shkollës. Të tillë qeleshe vuri dhe Avni Rustemi, i cili duhet të ketë ardhur me disa ditë vonesë në Elbasan. Nxënësit dëgjuan fjalën e mbajtur nga drejtori i parë i shkollës Luigj Gurakuqi, i cili midis të tjerave tha: «Këtu katundari me qytetarin, malësori me fushara-

1) «Ura e Shkumbinit». Elbasan, 4/17 maj 1910.

kun do të bashkëtrajtojnë e do të bëhen një, se Toska me Gegën do të derdhen, do të treten, do të përzihen bashkë, do të përnjeshmohen e do të harrojnë emrat e tyre; se këtu gjuha shqipe, tue u përkulun pas kësaj ligjërate t'ambëlë, do të marrë një trajtë e një fytyrë të përbashkët, se këndeje do të dalin shqiptarë, vetëm shqiptarë!»¹⁾

Me frymën e këtij fjalimi u foli vazhdimisht studentëve Luigj Gjurakuqi. Aty erdhën studentë nga të katër anët e vendit, nga Kosova martire, nga Libohova e Shkodra, Vlora e Durrësi: Fjala e Luigj Gjurakuqit la mbresa për gjithë jetën në zemrat e atyre studentëve, të cilët nga ana e qeveritarëve turq dhe nga ushtarakët e tërbuar të Turqisë, u quajtën «mauzerë», dhe me të vërtetë çdo student i kësaj shkolle ishte një pushkë në zemrat e pushtuesve otomanë.»

Një nga studentët që u shqua në mësimet e në aktivitetet patriotike ishte edhe Avniu. Luigj Gjurakuqi na e përshkruan Avninë si një «djalë që gjithë fuqinë e vet ia kushtoi arsimit e sidomos shprehjeve të ndjenjave kombëtare e idhesë kombëtare» dhe me të cilin ai, pas katërmëdhjetë vjetëve, do të bashkëpunonte në gji të opozitës qeveritare, për demokratizimin e jetës së vendit, për pavarësinë politike dhe ekonomike të atdheut të vet. Atëhere studentit dhe pedagogu bashkëpunuan së toku për të njëjtat ideale, bashkërisht luftuan regjimin anadollak, më vonë feudalët dhe Zogun, duke rënë të vrarë, njeri pas tjetrit, afërsisht brenda një viti, nga plumbat e tradhtarëve.

Avni Rustemi duket se në Normalen e Elbasanit

1) Normalisti — numër përkujtimor — 1909-1959. Elbasan f. 16.

2) Po aty.

ka shkuar tok me shokun e vet Gani Libohovën¹⁾. Ky i fundit ishte një djalë energjik, patriot, që kishte kryer një veprimtari të gjerë, për hapjen e normales shqipe e për teatrin e parë shqip në Janinë²⁾. Avniu i ndiqte mësimet me zell të madh. Sikurse e tregojnë bashkënxënësit dhe mësuesit e tij Sotir Peci dhe Aleksandër Xhuvani, ai dallohej përmbi shokët. Nga ana tjetër Avniu ishte në dijeni të ngjarjeve politike që zhvilloheshin në vendin tonë. Ai dinte hollësisht rreth vuajtjeve të malësorëve të veriut, dinte si u zhvilluan kryengritjet e fshatarëve si dhe persekutimet që ranë mbi ta nga operacionet e trupave osmane të dërguara nga Shefqet Turgut pasha, i cili synonte të mbyllte edhe Normalen, sepse e konsideronte atë një vatër të rrezikshme. Këtë e vërtetojnë nxënës të asaj shkolle, të cilët tregojnë se ekzistenca e Normales ishte shkaku që «bani të jetë ma i ashpër në Elbasan operacioni i Shefqet Turgut pashës. Atje u burgosën dhe u torturuan ma shumë se vendet e tjera». ³⁾ Forcat turke persekutuan më keq ato familje, që kishin djemtë e tyre në atë shkollë». ⁴⁾

/ Kohën e studimeve në Normale Avni Rustemi e kujtonte me mall. E kujtonte në bisedat e organizuara nëpër shkollë, kur sapo ishte kthyer nga Parisi. Sikurse del nga deklaratat e bëra përpara zhurisë, ai e kujtoi atë edhe kur ishte në hetuesi e në gjyq.

Si student i Normales ai u njoh me traditat patriotike të Elbasanit, me veprimtarinë e shquar të

1) «Zgjimi i Shqipërisë». Janinë, 5 korrik 1910.

2) «Koha». Korçë, 13.1.1912.

3) Normalisti, — numër përkujtimor — 1909-1959, f. 24.

4) Po aty.

arsimtarëve të qytetit. Mori pjesë në gëzimin që ndjenin ata kur çelën shkollat e para fillore, duke organizuar qitje topash e duke nxjerrë «fleta cigari patriotike» nergut, për të ndihmuar në fushatën e çelur për shkollat shqipe të qytetit. Këtu Avniu u njoh me përpjekjet e mësuesit, që jepte mësimin e shqipes me revole në brez. Ai pa se si punonin arsimtarët e palodhur si Hysen Ceka, Simon Shuteriqi, Petraq Popa, Muç Shqiptari etj. Ai lexoi thirrjen e shoqërisë «Përparimi» të Korçës, e cila bënte apel për të ndihmuar në mbarëvajtjen e Normales së Elbasanit, dhe menjëherë pas kësaj u mblodhën të holla nga të katër anët e vendit nëpërmjet klubeve të Shkodrës, Gjirokastrës, Vlorës etj.

Më vonë, Avniu fliste me krenari për mësuesit e tij: Aleksandër Xhuvanin, që i ndjekur nga ushtarët e Shefqet Turgut pashës mërgoi ca kohë në Egjipt, për Simon Shuteriqin që u dergj me muaj në shtrat, nga të rrahurat e xhandarëve të Turqisë, dhe për mësues të tjerë, që çalonin nëpër burgjet e Manastirit, sepse u ishin thyer këmbët nga shkopinjtë e halldupëve.

Ai fliste shpesh për Nuçi Naçin, të cilin pushtuesit e kishin përplasur në burgun e kriminelëve në Manastir. Kujtonte shokët e Normales, që «u rrahën pa mëshirë me dru nëpër xhamijat» dhe që ishin burgosur në kohë të pushtimit turk.¹⁾ Ai kujtonte gjithashtu edhe shokët e ardhur nga Kosova në Elbasan. Këta të fundit, më vonë, në vitin 1923, duke njohur karakterin burrëror e frymën revolucionare të Avniut e përkrahën atë dhe kërkuan të zgjidhej deputet i Lumës, gjatë fushatës elektorale të vitit

1) AQSH. FMA, dok. 9.9.1924.

1923. Përkrah tyre Avniu kishte marrë pjesë në kryengritjen e vitit 1910, në krah të Bajram Currit.

Deri më sot nuk është folur për pjesëmarrjen e Avniut, në kryengritjen e vitit 1910, kohë kur ai ishte student i Normales. Është përmendur vetëm vajtja e tij në Shkodër për atentatin kundër Shefqet Turgut pashës, që do ta shikojmë më pas. Me sa del nga një dokument, dërguar nga Vlora, Avniu ishte pjesëmarrës në këtë kryengritje. Ai vetë na tregon se për të «marrë pjesë në kryengritjen me famë të Kosovës, më 1910, që kryesonte lartësisht Bajram Curri, kishte ikur nga shkolla e Elbasanit».

Kjo letër hedh dritë edhe për ngjarjet e vitit 1921, kur Avniu krah për krah me Bajram Curri luftoi kundër bandave shoviniste serbe, «nën komandën e tij me vleftë»¹⁾. Ai vë në dukje shembullin e patriotizmit, me të cilin Bajram Curri frymëzonte atë dhe shokët e tij, «për të forcuar bashkimin, vëllazërimin» që, «Arbëria të mos ishte shesh i ngatrrësive për dobi të armiqtve tanë».²⁾

Duke qenë dy herë në kontakt të ngushtë me të rinj kosovarë, si student dhe veçanërisht si pjesëmarrës në kryengritje Avniu forcoi lidhjet me Kosovën.

Është thënë se Avniu shkoi në Shkodër, për vrasjen e gjeneralit turk dhe se këtu kur arriti afër shtabit u kap nga roja, një rreshter me trup të madh e i armatosur rëndë, i cili e pyet se ç'besim kishte e sa janë shartet e myslimanizmit. Kur Avniu ia tha këto mirë e bukur, rreshteri e liroi, pasi hoqi çdo

1) Letër e Avniut datë 29.12.1921.

2) Po aty.

dyshim të keq për të. Pastaj Avniu u kthye përsëri në Elbasan.¹⁾

Mendojmë se Avniu edhe në qoftë se ka shkuar në Shkodër nuk ka vajtur pa një qëllim të caktuar. Ai, në Shkodër, ose gjetkë, ka shkuar me qëllim të paramenduar, për një atentat kundër gjeneralit turk dhe se nuk mund të ikte pa bërë asnjë përpjekje.

Roja nuk kishte për detyrë vetëm ta pyeste se ç'besim kishte, as në i dinte apo jo shartet e Mysli-manizmit. Nga ana tjetër kundër Shefqet Turgut pashës mund të vinte çdo patriot, i çdo besimi dhe detyra e parë e rojes mendojmë, ishte të pyeste nga vinte ky djalë i ri, a kishte armë ose jo; më vonë ai do t'i përgjigjej vizitorit, nëse do të pranohesh të hynte në sarajin e gjeneralit, ose jo.

Na duket se këtë pikë e sqaron fare mirë një shok tjetër i Avniut, edhe ky libohovit, i cili kish të bënte me Avniun dhe ka ruajtur dokumenta e kujtime, që ka shkruar për Avniun qysh më 1920, duke i kushtuar atij edhe ndonjë vjershë.²⁾

Ky është telegrafisti Mahmut Xhafo Libohova, i cili tregon se një ditë marsi të vitit 1910 u zhvillua ky dialog, midis Avniut, që erdhi në një banesë të Tiranës dhe rojes të shtëpisë së Shefqet Turgut pashës:

- Nga vjen?
- Nga Elbasani.
- Me se merresh atje dhe ç'kërkon?
- Mësoj në shkollë, dua të flas me gjeneralin.
- A ke armë?
- Kam.

1) Eqrem Çano. «Drita», 22.4.1962.

2) Mahmut Xhafo Libohova. «Gazeta e Korçës». Korriku 1920.

Atëhere roja njoftoi oficerin, se kish ardhur një djalosh, i pajisur me armë, të cilën ia mbajti, dhe që kërkonte të fliste me gjeneralin.

E lajmërojnë Avniun, të hyjë në zyrën e Shefqet Turgut pashës. Kur gjenerali e pyeti përse kishte ardhur, Avniu iu përgjigj: «Jam në shkollën Normale të Elbasanit, erdha t'ju them të urdhëroni të mos mbyllet Normalja, ku studioj edhe unë, se nga ajo do të dalin mësuesit për përhapjen e mësimit shqip dhe alfabetin e saj».

Pashai e dëgjoi studentin me buzëqeshje dhe pastaj iu përgjigj: «Ç'i doni shkollat, kur kemi kaq e kaq shkolla turqisht, edhe të plota?» Pastaj shtoi: «Ju shqiptarët jeni shumë të zgjuar dhe gjithnjë këni përparuar nëpër shkollat e Perandorisë».

Avniu: Mësimet e para në gjuhën amtare bëhen urë që njeriu të kalojë lehtësisht në çdo gjuhë tjetër të huaj.

Gjenerali pas një heshtje të shkurtër pyeti: «Po ti, më thanë, se kishe edhe revolver me vete, përse e mban, duke qenë se je shkollar?»

Avniu: E mbaj se e shoh që janë ditë anarkie. Duke u nisur më këmbë nga Elbasani, për këtu në Tiranë, pata frikë se më del ndonjë keqbërës rrugës për të më xhveshur. Me revolverin do të mbrohësja.

Gjenerali: A do ta vrisje? — pyeti me të qeshur.

Avniu: Po pasha, do ta zbrazja, do të qëlloja një herë pa le të bëhej si të bëhej.

Gjenerali: Mos u tremb, për rrugës do të të jap dy rreshterë.

Dhe Avniu largohet, po shumë i dëshpëruar, që nuk e arriti dot qëllimin¹⁾, i dëshpëruar se nuk mori

1) Fondi i Muzeut Historik — Gjirokastrë

dot hakën e sa e sa shqiptarëve, që gjenerali turk i kishte vrarë. Avniu, duke biseduar me një shokun e vet, për këtë çështje, tregonte se vrasja e gjeneralit do t'i bënte shumë përshtypje qeverisë dhe kështu xhonturqit do të kuptonin më mirë se shqiptari nuk i duron mundimet dhe se ai, pëllëmbën e dackën më të vogël në fytyrë, e lan me gjak».1) Avniu tregonte gjithashtu se duke hyrë në banesën e pashait, për të kryer atentatin e «kishte marrë në sy vdekjen»,2) se për të mjaftonte që t'i jepej fund jetës së atij mizori, të cilin qeveria turke e pati njeri të vlefshëm».3)

Mendojmë se versioni i dytë, qëndron më mirë sepse tregon rrethanat në të cilat veproi Avniu. Ai ishte i armatosur, dhe nuk e kreu dot atentatin, sepse iu mbajt arma. Ky tregon gjithashtu se takimi me gjeneralin u bë në Tiranë.

-
- 1) Fondi i Muzeut Historik — Gjirokastrë.
 - 2) Po aty
 - 3) Po aty

NË ZVICËR — SHOQËRIA «BURIMI»

«Esat pashë!... Jo, mos pandeh se Shqipëria është çifliku tënd... përpara atdheut, përpara Shqipërisë ti dhe njëmijë shokë si ty, edhe më të mirë, janë zero.

AVNI RUSTEMI

(12, vjeshtë e dytë 1913)

Familja arsimdashëse e Avniut, kërkonte ta edukonte djalin e saj «plot qejf të madh për libra», si kurse tregonte mëma e Avniut, Laleja. Nga ana tjetër, mësuesi i Rilindjes Nuçi Naçi, që dikur e këshilloi të vinte në Normalen e Elbasanit, i propozoi familjes së tij ta çonte Avniun në Zvicër, për studime. Për këtë qëllim djaloshi Avni Rustemi në vjeshtë të vitit 1912 shkoi në Lozanë të Zvicrës.

Ishte koha kur nga përtej Atlantikut, Fan Noli propozonte¹⁾ për të riçelur përsëri një shkollë normale, me ndihmën e patriotëve të mërgimit dhe të arsimdashësve shqiptarë.

1) Fjalim i Nolit më 23 tetor 1910, në mitingun e Hold At Lawrence Hall të Bostonit. Gazeta «Dielli e Flamuri», Nr. 70, 4 nëntor 1910.

Dy vjet pas kësaj, Avni Rustemin e gjejmë në Lozanë, ku sipas një letre të Kristo Luarasit, i cili atëherë botonte gazetën «Liri e Shqipërisë», Avniu duhet të ketë qenë këtu qysh nga muaji shtator 1912.¹⁾

Në Lozanë Avniu formoi të parën shoqëri shqiptare. Ai u bë frymëzues i themelimit të një bërthame, e cila në fillim u ngrit si «Shoqëri literare» e studentëve të Lozanës, e që më vonë u quajt «Burimi». Ajo u pasua nga disa shoqëri e klube jashtë e brenda atdheut.

Në punën për formimin e shoqërisë «Burimi» Avniu me shokë të tjerë nga Përmeti, Korça etj. patën si shembull frymëzimi veprën e patriotëve shqiptarë, që vepronin në Egjipt, në Bukuresht e gjetkë, të cilët kishin formuar klube e shoqëri të ndryshme patriotike. Shoqëria «Burimi», sipas një shënimi dërguar Kristo Luarasit nga Avniu, «do të bëhej një burim për shoqëri të tjera të studentëve për zgjimin e kombit».

Në materiale të botuara në gazetën «Liria e Shqipërisë» dhe në materiale të ruajtura nga Kristo Luarasi²⁾, në këtë periudhë, studenti Avni Rustemi «polemizoi me disa gazeta turke» të cilat «lavdëroheshin se gjoja u kishin dhënë shqiptarëve shkolla». Në të vërtetë ato ishin shkolla turke ose greke, shkolla fetare, që i mohonin krejtësisht shkollat shqipe, për të cilat punonin patriotët shqiptarë.

/ Avniu demaskoi demagogjinë e qeveritarëve

1) Kristo Luarasi e përshëndeste Avniun me anën e gazetës edhe për dërgimin e pajtimit në gazetën që ai drejtonte.

2) QK Gjirokastrë.

turq, të cilët patën premtuar se edhe shërbimin ushtarak shqiptarët do ta bënin brenda vendit, kurse në të vërtetë ata dërgoheshin në Stamboll e në Edrene.

Qysh në atë kohë Avni Rustemi u ngrit në mbrojtje të luftëtarëve Bajram Curri e Isa Boletini, të cilët i kishte njohur kur kishte shkuar vullnetar në Luftën e Kosovës. Ai shkruante se «burra si Bajram Curri, Isa Boletini e të tjerë heronj të Arbërisë plakë nuk do të heshtin, po të shikojnë se qeveria s'plotëson kërkesat e tyre, por do të kapin armët e t'i japin fund një herë e mirë, që të jenë të gjithë me një, Gegë e Toskë, Malësia dhe Mirdita dhe të bëjnë kuvet (durim) si pleqtë e moçim, për të punuar bashkarisht me ment dhe vetëm për Shqipërinë».1)

Formimi i shoqërisë «Burimi» ishte një hap i rëndësishëm i djemurisë shqiptare që i gëzoi shumë patriotët.

Qëllimet e krijimit dhe objektivat e punës të shoqërisë u pasqyruan në statutin e saj, të përbërë nga nëntë pika. Në të parën jepet data e themelimit të shoqërisë, ku spjegohet se qëllimi kryesor i ngritjes së saj ishte:

- a) të bashkonte anëtarë në rrethin e vëllazërisë;
- b) të përpiquej të sillte nga Shqipëria studentë në Lozanë; të jepte lajme në Shqipëri përmbi çështjen e shkollave etj.
- c) të punonte për përparimin e gjuhës shqipe.

Në pikat e tjera tregohet se shoqëria kishte dy lloj anëtarësh: 1) ata që ishin në Lozanë dhe që quheshin anëtarë të rregullt, dhe 2) ata që ishin larg

1) QK Gjirokastër.

këtij qyteti, që ishin anëtarë vetëdashës, ata që i ndihmonin shoqërisë me çdo gjë.

Shoqëria, për t'i shpëtuar ndjekjeve e për të siguruar legalitetin e saj shpallte se gjoja «nuk merrej me politikë». Në mars të vitit 1913 ajo përgatiti një memorandum, iniciativë e cila u cilësua si një «punë e shenjtë» nga patriotët e kohës. Nga informacione gojore¹⁾ kemi mësuar se në atë dokument flitej edhe për shkollat dhe kërkohej nga studentët shqiptarë që të braktisnin shkollat e Stambollit e të Athinës, se me anën e tyre mjaft u ndryshkën mendjet e djelmohave shqiptarë. Aty dënohej veprimtaria e shkollave të huaja «se këto përveç dëmit s'i kanë prurë ndonjë dobi kombit dhe Shqipërisë».

Shoqëria propagandoi luftën kundër shkollave turke. Ajo u bëri thirrje studentëve shqiptarë, që ndodheshin në shkollat e larta të Stambollit që të braktisnin shkollat turke pa program, pa ndonjë rregull e të kalonin në Zvicër. Ajo i siguronte se shoqëria «Burimi» do të ndihmonte çdo student shqiptar «gjer ku t'i harrinte çapi». I ftonte të mbledheshin në Zvicër, të rrëmbenin mësimet dhe t'i mbillnin në Shqipëri, në atë vend, që ishte ujitur me gjak shqiptari.

/// Njëpërmjet shoqërisë letrare dhe artikujve në shtypin e kohës, Avniu punonte jo vetëm për arsimin por edhe për kulturën kombëtare.

Avniu besonte te forca e popullit dhe tek e ardhmja e ndritur e tij. Pikëpamjet e tij demokratike dhe bindjet e thella kundër Esat pashës dhe bejle-

1) Deklarata të Avniut dhënë në darkën e shtruar nga qyteti i Gjirokastrës, në janar 1921, në godinën e katundarisë, ku ai kujtoi çaste nga jeta e tij.

rëve çifligarë ai i shfaqti nëpërmjet një ultimatumit lakonik, por plot urrejtje antif feudale.

Qysh më 1913, shtatë vjet përpara veprës heroike të Parisit, Avniu shfaqti hapur urrejtjen e popullit për Esat Toptanin, duke e cilësuar atë «një njeri që kish ngritur duart dhe kërkonte që mëmën që e rriti, mëmën që i dha nder, ta varroste».1)

Me besim te populli, te fuqia e tij, Avniu shtonte, duke iu drejtuar çifligarit dhe kryetradhtarit: «Po jo, s'të kemi për të lënë. Se ajo mëmë është edhe jona; në ty të pëlqen Serbia, Greqia ose Turqia, në ti i pandej këto më të lartëra nga Shqipëria, neve mejtojmë ndryshe dhe të themi Esat qëndro!».

«Në do të bëhesh Korolianus²⁾ i Shqipërisë, neve kemi të drejtë të thomi qëndro!... Jo, mos pandeh se Shqipëria është çifliku tënd... Përpara Atdheut, përpara Shqipërisë ti dhe njëmijë shokë si ty, dhe më të mirë janë zero».

Siç shihet këtu del hapur mendimi revolucionar e fryma patriotike e Avni Rustemit. Ultimatumit ka gjithashtu një karakter të theksuar klasor. Avniu jo vetëm e paralajmëron Esatin si person, por ai paralajmëron edhe klasën së cilës ai i përket. Pa u lëkundur, pa marrë parasysh se ata kishin në dorë fuqinë shtetërore dhe fuqinë ekonomike, me besim te forca e masave dhe e popullit Avniu shkruan «se edhe njëmijë Esatër» nuk i bëjnë dot gjë popullit, se edhe «një mijë pashallarë si Esati, më të mirë se ky (nënkuptohet të egër e gjakpirës e satrapë si ai . —

1) Fondi QKGJ.

2) Korolianus, gjeneral romak i shek. V para erës sonë, që tradhtoi interesat e Romës.

(L.D.) — nuk ia dalin dot Shqipërisë, nuk ia dalin dot popullit».

Pa dyshim këtu Avniu kishte parasysh rolin armiqësor, antikombëtar që luajti në këtë kohë Esat pasha kundër Qeverisë së Vlorës, tradhtinë e lidhjet e ngushta që kishte ai qysh në atë kohë me Mufit Libohovën. Studentët, që studionin jashtë atdheut, si Avniu me shokë, ishin të informuar për tradhtinë e Esatit, si vegël e qeverisë së Vjenës dhe të politikës austriake, si agjent të Berhtoldit¹⁾, i cili, sikurse trekojnë dokumentet e kohës, nuk gjente tjetër mënyrë për të ndikuar mbi Esat Toptanin veç dhënies të një shume të hollash, që Vjena me Romën, bashkarisht, i propozonin pashait në formën e «shpërblimeve të dëmeve» që gjoja kishin pësuar çifliqet e tij nga lufta.

Patriotët tanë duke parë veprat antikombëtare të bllokut të bejlerëve të mbledhur rreth Esatit dhe «pleqësisë» së tij në Shqipërinë e Mesme, e urrenin atë dhe gjithë klikën e tij.

Kjo u shpreh edhe në shkrimin e studentit Avni Rustemi që doli në mbrojtje të Qeverisë së Vlorës, të zgjedhur nga Kuvendi Kombëtar historik, që shpalli pavarësinë e Shqipërisë.

Studenti shikonte nga ana tjetër se kishte akoma disa njerëz që i kishin sytë të zënë, dhe Avniu i drejtohej me këto shprehje kryetradhtarit Esat pashë Toptani:

«Kur ata të pakët që gënjen, që i kanë sytë të zënë, do zgjohen, do kërkojnë fjalë përsa po bën,

1) Ministër i Jashtëm i Austro-Hungarisë në Luftën Ballkanike.

edhe atëhere dridhu, se s'ke më shpëtim, nga duart e popullit».

Mirëpo Esati dhe klasa e tij, dita-ditës hynin më thellë në llumin e tradhtisë. Esati, si dhe më parë vazhdonte shërbimet në favor të shovinistëve ballkanas dhe të shteteve imperialiste. Esati vazhdoi ta konsideronte Shqipërinë çiflik të tij, ta konsideronte veten si qeveritarin e ardhshëm të saj. Ai nuk përfilli as thirrjet e ultimatimit të patriotëve.

Esat pashë Toptani, që e përbuzi fjalën e vjesh-tës të 1913-ës të djaloshit patriot, vazhdonte veprim-tarinë e tij armiqësore kundër atdheut. Ai ishte agjent i Baron Aliottit, i cili lëvdolesh se ishte «kri-juesi i Esatit»¹⁾, «vegël e Venizellos»,²⁾ nga i cili «mo-ri në dorëzim dekoratën më të madhe të Greqisë», ortak i Pashiçit të Serbisë.

Bindjet demokratike-revolucionare, antifeudale e antiimperialiste, ishin ato që pesë vjet pas ultima-tumit të Zvicrës e nxitën Avniun të merrte iniciati-vën e manifestimit antiimperialist të Vlorës, më 28 nëntor 1918, ku Avniu ligjëroi «rreptësisht në shesh të madh përpara Komandës italiane»³⁾ dhe fjalët e tij të nxehta bënë «që të shkrihen dejtë e gjakut të manifestuesve».

Gjithnjë duke mbrojtur të drejtat e popullit shqiptar, ai bënte akuzat më të rënda për imperializ-min italian, që përpiquej të mbante të pushtuar Shqi-përinë.

1) Gazeta «Zani i ri», Tiranë, 2 gusht 1920.

2) Omonia. Gjirokastrë. 4/17 qershor 1920 Nr. 242/89.

3) S. Hallkokondi. Histori e Shqipërisë së re. Vlorë 1923. f. 240-241.

NË MALET E KURVELESHIT

Me shpalljen e Luftës Ballkanike, Avniu mbeti ngushtë nga ana ekonomike. Familja nuk e ndihmonte dot më. Studenti u kthye në Libohovë. Në atë periudhë Shqipëria ishte e pushtuar nga ushtria greke. Avniu u sëmur disa kohë e megjithatë nuk qëndroi pa punuar. Punonte si mësues, gjoja i frëngjishtes, por në të vërtetë mblidhte disa të rinj në kodrën e Marinës ose në ndonjë shesh të qytetit të lindjes për t'u dhënë mësim shqip, dhe për t'u folur atyre për gjendjen politike. «Mësuesi ynë — tregon një ish nxënës i tij — ishte rreth të njëzetave, i bardhë në fytyrë, i pakë nga shtati, i veshur thjeshtë, i ëmbël shumë në të fjalosur, i përpiktë në punë, rigoroz në detyrë, iniciator e i papërtuar dhe në punët shtëpiake, që i këshillonte gjithnjë nxënësit. Mësimet i zhvillonte në orët e paraditës sikur të ishte mësues zrytar, i kontrolluar dhe i inspektuar». ¹⁾

✓ Tok me shumë të rinj patriotë, në verë të vitit 1914 edhe Avni Rustemi mori pjesë në luftimet kundra bandave shoviniste greke në malet e Kurveleshit. Ai shkoi në krah të Çerçiz Topullit në Kolonjë, në Skërficë, në Cepo. Duke kujtuar ato ditë luf-

1) Fondi QK — Gjirokastrë.

timesh, e duke folur për veprimtarinë e tij gjatë Luftës së Parë Botërore, Avniu para gjyqit të Parisit tha se atëhere u formuan trupa vullnetarësh e se midis tyre ishte dhe ai vetë.¹⁾ Në këto luftime shkuan shumë studentë, të cilët u bashkuan me fshatarët patriotë. Por kundër lëvizjes çlirimtare shqiptare, krahas qarqeve shoviniste fqinje qëndronin edhe forcat antipopullore të bejlerëve e çifligarëve.

Luftëtarët patriotë, megjithëse nuk furnizohehin me armë sepse ishin tradhtuar nga Esat pasha, i cili në atë kohë ishte ministër i Luftës i qeverisë së princ Vedit, luftuan me vetmohim. Për të stigmatizuar këtë ngjarje, rapsodi këndoi:

*Fajnë e pati Esati
Topa, xhepane na mbajti.*

Esat pasha organizoi edhe çeta mercenarësh, të cilat iu kundërvunë patriotëve, që luftonin në malet e Kurveleshit kundër pushtuesve.

Si strateg i talentuar luftoi në këto vende Çerçiz Topulli me shokë. I trembur, peshkop Vasilios i Gjirokastrës, rendi në Janinë, për të kërkuar që të dërgoheshin në Shqipëri forca të reja ushtarake greke. Përpjekjet e peshkopit u shtuan sidomos kur mori vesh se Çerçiz Topulli pasi theu vijën e frontit në Cepo po marshonte me shpejtësi drejt Gjirokastrës duke ndjekur këmba-këmbës okupatorët grekë. I alarmuar peshkopi i ra në këmbë gjeneralit grek dhe kërkoi prej tij përforcime ushtarake. Vullnetarët tanë dhanë shembuj heroizmi në luftë kundër forcave tradhtarë, të vëna në shërbim të imperialistëve,

1) AQSH — Deklarata të Avniut në gjyqin e Parisit.

që kërkonin të realizonin coptimin e vendit. Me plot urrejtje e shikonte populli ynë veprimtarinë kriminale të tradhtarëve Esat pashë Toptani, Jorgji Zografi, Spiro Milo. Dhe ja si i dënon me vargjet e tij:

*Zografi nga Qestorati
Spiro Milo kokëthati
Tradhtarë si Esati.*

Që të tre agentë të monarkive shoviniste të Ballkanit, për hir të interesave të tyre të ngushta, iu kundërvunë vendit të tyre. Në këtë kohë Esati dërgoi të shoqen në Delvinë, Gjirokastër e në Sarandë për të koordinuar veprime në dëm të interesave të vendit së bashku me pashanë e Delvinës dhe me Javer bej Hurshitin.¹⁾

1) Fondi i Muzeut Historik — Gjirokastër.

MËSUES NË TEPELENË DHE NË VLORË

«Kisha ndërmend me të vërtetë të merrem me arsim, të bëhem një ditë profesor në Shqipëri».

AVNI RUSTEMI

Pas luftimeve në malet e Kurveleshit, Avniu kaloi përsëri në Janinë, për studime. Këtë herë në një kolezh me qëllim «që të mos harronte frëngjishten, që dinte»¹⁾. Pasi vazhdoi disa kohë aty, më 1915 u kthye në Vlorë, ku u lidh ngushtë me popullin dhe patriotët, që shikonin me shqetësim shkollat në gjuhën e huaj, dhe që mundoheshin të hapnin shkolla në gjuhën amtare. Kur armiqtë mundoheshin të hapnin shkolla të tjera në gjuhët italisht, turqisht ose greqisht, patriotët ishin të vendosur t'u vinin nga pesë derhem dinamit atyre shkollave të huaja për t'i hedhur në erë.²⁾

Patriotët e këshilluan Avniun që të punonte si mësues në Tepelenë. Avniu shkoi të punonte në qy-

1) Fondi Muzeut Historik — Gjirokastër.

2) AQSH. Cile Vreto. Letër J. Vrukos — Nr. 505.23, datë 22.1.1914.

tetin buzë Vjosës në një kohë që ushtria italiane ishte shtrirë në prefekturën e Vlorës dhe të Gjirokastrës. Ishte viti shkollor 1916-1917. Mësuesi filloi punën në një kohë kur gjuha shqipe, në kuadrin e veprimtarisë antishqiptare të okupatorëve që kishin pushtuar vendin, luftohej si asnjëherë. Pushtuesit përpiqeshin me të gjitha forcat ta linin gjuhën tonë si një gjuhë të dytë të humbur.¹⁾ Mësuesi patriot, sapo filloi nga puna, e vuri gjuhën shqipe në krye të mësimeve të tjera që bëheshin në shkollë. Ndonëse ai hasi kundërshtimin e vendosur të mësuesve ushtarakë italianë, Avniu nuk hoqi dorë nga rruga e tij.

Tani mësuesin patriot e gjeje tek bisedonte shtruar me shumë tepelenas, prindër të nxënësve të tij. të mërkurave mbrëma atë e gjeje midis fshatarëve të Salarisë, që vinin për ditën e pazarit. Fliste me ta me zemër të hapur, duke u treguar se sa e dobishme ishte për interesat e kombit që fëmijët e tyre të mësonin gjuhën amtare. Shpesh takohej me mësues të Lekëlit, Hormovës, që vinin në Tepelenë për punë. Takimet me ta ai i shfrytëzonte për përhapjen e propagandimit e ideve të lëvizjes çlirimtare antiimperialiste dhe të ndjenjave patriotike. Gjatë bisedave Avniu fliste hapur kundër synimeve të fuqive imperialiste dhe kërkonte që në shkollat të mësohej vetëm gjuha shqipe.²⁾ Dhe në këtë drejtim ai bënte një punë këmbëngulëse. Gjatë punës si mësues rëndësi të veçantë ai i jepte këngës shqipe, poezisë patriotike, e cila nuk kishte nevojë, as për libra, as për fletore, pasi ai ua shkruante nxënësve në dërrasë të zezë

1) «Shpresa e Atdheut». Romë 1922, Nr. 1.

2) Po aty.

dhe ata shpesh herë e mësonin që aty, ose e shkruanin atë në ndonjë letër shtupelle.

Fryma patriotike, puna këmbëngulëse për përhapjen e mëtejshme të gjuhës e të arsimit shqip e bëri mësuesin e ri të binte ndesh me direktivat e mësuesve italianë, aq sa ai, në një letër të veçantë, proteston, duke kërkuar «që të lejohej mësimi shqip ashtu si e kërkonte populli». Më së fundi, për arsye se ai nuk iu bind urdhrave të drejtorit ushtarak italian, e shkarkuan nga puna. Atëherë Avniu shkoi në Vlorë, ku u fut si mësues i një shkolle vajzash. Atje ai u njoh me shumë të rinj patriotë dhe bashkë me ta ja nisi një aktiviteti të gjerë antiitalian në radhët e nxënësve. Në këtë kohë ai u njoh me mësues të vjetër të gjuhës shqipe, midis të cilëve me Jani Mingën etj., që kishin çelur shkollat e para shqipe në Vlorë e Kaninë, dhe kishin punuar si anëtarë të klubit «Labëria» dhe që për këto arsye ishin internuar e burgosur nga autoritetet turke. Veprimtaria patriotike e Avniut në Vlorë gjeti kundërshtimin e mësuesve italianë, që gjendeshin në prefekturën e Vlorës. Sipas raportit të komisarit civil italian të prefekturës së Gjirokastrës, të datës 5 gusht 1918 parashikohej të vinin nga Italia 30 mësues për filllore dhe 5 arsimtaret e para për qepje e qëndisje, për italianizimin e vajzave shqiptare.¹⁾

Por arsimtarët dhe populli ynë patriot asnjëherë nuk u mashtruan nga propaganda dhe demagogjia e tyre. Ata u dhanë të kuptojnë pushtuesve se një popull artist në qëndisje e në qepje, veçanërisht për kostumet e tij kombëtare, nuk kishte nevojë të mësonte qëndisje nga mësuese të ardhura nga përtej

1) «Studime Historike», Nr. 4, 1970, f. 96.

Adriatikut. Avni Rustemi nuk ishte vetëm mësues, por në radhë të parë një propagandist i flaktë i lëvizjes kombëtare. Kur një mësues italian, i quajtur Rikos, e pyeti një ditë se përse nxënësit e tij nuk i mësonin këngët italiane ashtu siç mësonin këngët shqipe, Avniu iu përgjigj i revoltuar se përgjigjen për këtë «ta kërkojë nga gjyshi i tij; mjafton ta pyeste atë për të kuptuar përse italianët i këndonin këngët italiane më mirë, nga ato austriake, para Rilindjes italiane». ¹⁾

Duke qenë mësues, ndonëse ndodhej nën kërcënimin e autoriteteve italiane, të cilat mbanin të pushtuar Vlorën, Avniu punoi e luftoi pa pushim për forcimin e ndjenjave patriotike në radhët e rinisë.

➤ Mësuesi revolucionar punoi jo vetëm brenda shkollës, por edhe jashtë saj. Edhe pse shkollën e drejtonin mësues italianë, Avniu së bashku me patriotë të tjerë, në vjeshtë të vitit 1918 iu vunë punës dhe themeluan shoqërinë «Lidhja djelmoshe». Kjo shoqëri paraqitej sikur kishte vetëm synime kulturore, ndërsa qëllimi i saj i vërtetë ishte të bashkonte rininë në luftën që e priste për lirinë e përparimin e mëmëdhezes. ²⁾

➤ Shoqëria «Lidhja djelmoshe» kishte si piksynim kryesor të saj, të bashkonte forcat e arsimitarëve të rinj të fshatit dhe të qytetit të Vlorës.

Në krye të «Lidhjes djelmoshe», e cila kishte karakter demokrat-revolucionar antifeudal e antiimperialist ishte Avni Rustemi. Avniu u bë frymëzuesi dhe organizatori i demonstratës antiimperialiste e

1) Fondi i Muzeut Historik — Gjirokastrë.

2) «Studime historike» Nr. 2, 1969 dhe fondi i Institutit të Studimeve Pedagogjike.

antiitaliane të 28 Nëntorit të vitit 1918, e cila mund të themi se ishte një prolog i Luftës së Vlorës. Më 28 Nëntor 1918, nëpër sheshet e Vlorës, masat popullore vlonjate të drejtuara nga patriotët, me flamurin shqiptar e këngët patriotike në gojë, sulmuan karabinierët italianë. Ndeshja e 28 Nëntorit 1918 ishte një demonstratë e fuqishme antiimperialiste. Në këtë demonstratë merrnin pjesë edhe të rinj patriotë e revolucionarë nga fshatrat si dhe burra të shkuar nga mosha, që pas dy vjetëve u bënë luftëtarë të betejave në Luftën e Vlorës. Demonstruesit lëshuan thirrjet e fuqishme se «toka e bekuar e Vlorës dhe e tërë Shqipërisë është e jona» dhe se në të ne «duhet të rrojmë të lirë». Demonstruesit theksuan se «asnjë fuqi nuk mund t'i ndalonte dot nga ai qëllim». Vendosmëria e guximi i demonstruesve rritën besimin e tërë popullit. Ato kontribuan në rritjen e mëtejshme të ndërgjegjes politike të masave popullore dhe nxitën ndjenjat patriotike.¹⁾ Vlora e kishte dëgjuar edhe herë të tiera Avniun të fliste në lokalin e «*Lidhjes djelmoshe*» për detyrat e djalërisë, por më 28 Nëntor 1918, ajo e dëgjoji në një shesh të hapët dhe e shikoi në përleshje me karabinierët. Forca e fjalës së tij ngriti peshë zemrat e manifestuesve.

Avniu dhe patriotët e tjerë treguan edhe një herë se lufta për të shpërrur pushtuesit e huaj kërkonte nga njerëzit vendosmëri revolucionare, kërkonte luftë të armatosur dhe kjo ishte e vetmja mënyrë që atdheu të mund të merrte frymë lirisht.

Në këtë kohë Avniun e preokupoi edhe përfundimi i studimeve të tij të cilat i kishte lënë përgjysmë. Pa u ndarë asnjë çast nga lëvizja çlirimtare re-

1) Gazeta «Kuvendi» Nr. 23, 1918, Romë.

volucionare ai mendonte edhe për aftësimin e tij të mëtejshëm. Atij nuk i bënte zemra të largohej nga Vlora e pushtuar. Megjithatë u detyrua të nisej për studime. Para se të nisej ai u la shokëve të tij të punës disa porosi për punën e ardhshme. Midis të tjerave ai shkruante «se largohej për studime, si një shkëndijë e këputur nga gjiri i atdheut, duke kërkuar nga djalëria shqiptare, që të mbajë lidhje me të». Në fund ai shprehte gadishmërinë e tij me fjalët «kur të të duhem, thirrme». Njëkohësisht aty ai premtonte «se do të punonte në mes të arbëreshëve, në Kalabri, duke i dhënë edhe asaj djalërie kushtrimin e fundit».

Dhe ashtu si shkroi, ashtu veprroi. Ai nuk e ndante fjalën nga veprat. Pas afro tetë muajve, kur e thirri atdheu, ai la përgjysmë studimet e larta për pedagogji, që ishte duke vazhduar në Romë, dhe u nis të shtrinte përdhe pashanë e Toptanit, mu në zemër të Parisit, me plumbat e armës së tij, që ishin një kushtrim i atij revolucioni të popullit shqiptar, që po ngrihej kundër feudalizmit.

NË SHËN MITËR KORONË DHE NË ROMË

...«Me gjithë shokët e tjerë që ndodhen atje në mëmëdhe të Alfonsit, do të përsëritë kujtime të mallëshme të Kastriotit».

AVNI RUSTEMI

Megjithëse i përjashtuar dy herë nga shkolla e mesme për aktivitet revolucionar, me urdhër të autoriteteve turke dhe dy herë i pushuar nga detyra si mësues nga karabinieria italiane, për qëndrim të vendosur kundër pushtuesve italianë, Avni Rustemi, për asnjë çast nuk e ndërpreu dashurinë e përpjekjet për mësim e për kulturë. Këtë radhë ai shkoi në Kolegjin ku kishte dhënë mësim De Rada e ku kishte marrë mësim prej tij Luigj Gurakuqi e të tjerë studentë shqiptarë. Atje shkoi edhe Avni Rustemi.

Shën Mitër Korona ndodhej i shtrirë në disa kodrina të thata e gjysmë të xhveshura, disa kilometra larg nga stacioni hekurudhor i Koriliano Kalabres. Një ditë shtatori të vitit 1919, ai u nis me këmbë nga stacioni, i shoqëruar nga disa fshatarë arbëreshë dhe shkoi gjer në Makje, një fshat i vogël nja tri kilometra larg, e prej këtej arriti në Shën Mitër.

Në Kolegj Avniu arriti në ora një pas mesnate, shumë i lodhur e i këputur. Portieri e pranoi menjëherë, pa asnjë formalitet, dhe në mëngjes lajmëroi studentët e tjerë shqiptarë për ardhjen e tij nga Vlora. Shokët e rrethuan Avniun me dashuri, duke i bërë pyetje të njëpasnjëshme rreth gjendjes në Shqipëri. Avniu megjithëse i lodhur u mundua t'u përgjigjej të gjithëve. Qysh të nesërmen ai hyri në klasë dhe shpejt u shqua si student me kulturë, me vullnet të madh dhe me një përgatitje të shëndoshë.

Avniu tani ndodhej në mes të disa shokëve shqiptarë dhe në mes të banorëve të një fshati të madh arbëresh, rrethuar përsëri me katunde arbëreshe. Ishte në mes të një popullsie fshatarësh të varfër, që kishin a s'kishin një pëllëmbë tokë, një vreshtë ose një pemishte të vogël në faqen e ndonjë kodre.

Shumë shpejt Avniu u bë tepër i dashur me shokët, me të cilët ai fliste hapur. Ishte i thjeshtë, i çiltër, i urrente dallkaukët, lajkatarët, njerëzit me dy faqe e sidomos bejlerët.¹⁾ Me gjithë varfërinë e tij, që ia tregonte edhe veshja mjaft e thjeshtë e sidomos pelerina e përdorur që ai mbante si dhe shpenzimet shumë të kufizuara që bënte, Avniu tregohej bujar me shokët. Ai filloi të ndihmonte në mësim shokë shqiptarë që kishin ardhur që nga Turqia në Tiranë e prej këndej në Kolegj e që akoma nuk e zotëronin shqipen mirë. Avniu i ndihmonte ata të shkruanin gjuhën amtare, u recitonte vargje nga Naimi, Çajupi, Asdreni me një afsh të madh. Kur recitonte «dukej sikur këndonte pjesë muzike të bu-

1) Revista «Afrimi». Tiranë, 1924, Nr. 5 f. 67.

kura, që dëgjuesin e rrëmbenin dhe e ngrinin lart në qiell». ¹⁾

Avniu u fliste arbëreshëve, për Shqipërinë, për shqiptarët, për ato vende, për ata vetë, që i cilësonte «bij të një nëne». ²⁾

Shokët e tij tregojnë se në atë periudhë të jetës së tij ai paraqitej gjithnjë i menduar, «sytë e tij dukeshin sikur digjeshin përbrënda». Ai mendonte për atdheun që e kishte lënë nën pushtimin e huaj. Ndonëse provimet i jepte shumë mirë, gjithnjë dukej i kredhur në mendime, aq sa një ditë, kur e pyeti një shoku i tij, të cilit Avniu i mësonte gramatikën e shqipes, u përgjigj se rrinte ashtu nga që «akoma nuk kam dhënë provimin e madh, që një ditë do ta jap dhe atëhere do të gëzohen që të gjithë». ³⁾ Ky provim i madh, a mos ishte vallë zhdukja e Esat pashës, për të cilën ai mendonte qysh tani?

Avniu lexonte rregullisht shtypin e kohës. Ai ishte në dijeni të të gjitha ngjarjeve që ndodhnin në botë: u fliste shokëve për revolucionin proletar dhe luftën civile në Rusi, që shpuri në përmbysjen e regjimit të carit, për gjendjen në Shqipëri, për intrigat e Esat pashës, për tradhtinë e tij. Avniu njëkohësisht mendonte për organizimin e një veprimtarie patriotike, tok me arbëreshët. Qysh më 16 mars të vitit 1919 ai propozoi formimin e një shoqërie kulturore-politike me emrin «Lidhja djelmoshe».

Sipas mendimit të Avniut kjo shoqëri «do të ngrinte opinionin e arbëreshëve dhe të italianëve në favor të Shqipërisë, me anë thirrjesh e memorandum-

1) R. Këlliçi. «Djemtë e Bashkimit». Tiranë.

2) Po aty.

3) Po aty.

mesh.¹⁾ Avniu e shihte me simpati bashkëpunimin me arbëreshët. Në këtë kohë midis arbëreshëve bënte pjesë edhe një nip i De Radës. Këtu ai u njoh me një farë Terenc Toçi, po shpejt u zhgënjye prej tij sepse në një bisedë me të, Toçi e mendonte jo vetëm të vështirë, por edhe të «pamundur një bashkëpunim me arbëreshët», se gjoja ata nuk e kishin frymën shqiptare. Por Avniu në shumë takime me arbëreshë kishte ndjerë afshin dhe mallin e tyre për Shqipërinë. Në shumë takime me arbëreshë të thjeshtë, fshatarë, të rinj e të reja, ai pa e provoi mallin që kishin ata për mëmëdhenë e lashtë.

Avni Rustemi, bashkë me studentët e tjerë shqiptarë, njohën në Spenzano mjekun arbëresh Ribeko, dhoma e të cilit ishte veshur në të katër anët me një fotoekspozitë shqiptare. Ai mbante në allçi bustin e Skënderbeut. Arbëreshi uroi që shoqëria e formuar nga studentët shqiptarë të dilte faqebardhë dhe u tha se ajo shoqëri «duhej të ishte iniciativa e arbëreshëve dhe jo e studentëve shqiptarë»²⁾ për të treguar kështu se barra u binte vetë vendësve. Me atë patriot arbëresh Avniu pati edhe korrespondencë. Lidhur me vizitën që i bëri Avniu me shokë, Ribekua i shkruan N. Ivanajt se ai i kishte shkuar në banesën e vet në muajin korrik 1919, ku kishte folur për gjendjen politike dhe për frymën patriotike, që dominonte në Shqipëri. Në një letër që Avni Rustemi i shkruante mjekut arbëresh, ai thoshte se «Qeveria e Turhan pashës... nuk duhet të punojë fshehurazi, sikurse ka punuar gjer sot». Me anën e kësaj letre

1) Rassegna italo-albanese Nr. 3, 15.6.1919, dhe Nr. 4, 15. 7. 1919.

2) Fondi N. Ivanaj. AQSH, Nr. 600, 370, D. 2.

Avniu donte të thoshte se qeveria nuk do të njihej në qoftë se nuk i zbulonte popullit gjithë punërat zyrtare e sekrete, që kish bërë gjer atëhere. Pjesa më interesante e letrës është ajo kur ai i tregon «se rrethet popullore në Shqipëri ishin ngritur, se shqiptari ishte zgjuar në sheshin e idealit kombëtar, se ai vetëm kish nevojë për disa Maxinë e Garibaldë, për Naimë e Isa Boletinë. kështu që këta t'i bëhen udhëheqës».

Avniu vinte në dukje nevojën e një qendre drejtuese udhëheqëse për lëvizjen e masave popullore shqiptare.

Këtu shfaqet edhe një herë mprehtësia politike e Avniut, njohja e tij me problemet shqiptare, qëndrimi opozitar ndaj politikës së qeverisë të bejlerëve, si dhe nderimi e respekti që kishte për figurat që kanë udhëhequr popujt në luftrat për liri.

Mbi të gjitha në këtë letër të Avniut, shikojmë vlerësimin që i bën Naimit, si dhe Isa Boletinit, që ishte shfaqur në kaq beteja frontale kundër ushtrisë osmane. Figura e Isa Boletinit dhe vepra e tij ishin një model për Avniun. Ai e çmonte Isa Boletinin si ushtar të madh, që edhe kur paraqitej nëpër oborret e kabineteve të kryeministrave të Anglisë, dinte të dorëzonte vetëm njerën nga të dy armët që mbante me vete.

Avniu mernte pjesë në demonstratat e organizuara nga proletariati e masat popullore italiane. Pjesëmarrjet në to ishin mësim të mira e të dobishme për Avniun, që do të kthehej në atdhe. Kur kthehej në konvikt ai shpesh pyeste veten dhe shokët: «Ç'duhet të bëjmë ne, që kemi nën thundrën e armikut më tepër se gjysmën e Shqipërisë?» Kjo i bënte studentët të thërrisnin me një gojë «Të rrojë

Vlora shqiptare!»¹⁾ Shfaqja haptas e ndjenjave anti-imperialiste e bëri Avniun një nga elementët më aktiv në konvikt. Por nga ana tjetër ai ra në sy të autoriteteve italiane. Thirrjet e studentëve në sallën e konviktit ishin një demonstratë proteste kundër pushtuesve italianë për Vlorën e Shqipërisë. Me këtë rast Avniu u thirr e u kërcënua nga drejtori i kolegjit për ndjekje nga shkolla, sepse «kishte nxitur shokët e tij kundër qeverisë italiane».²⁾ Por edhe atë radhë Avniu nuk u shqetësua. Me guxim e vendosmëri ai tha se Vlora do të rrojë, duan s'duan imperialistët italianë dhe bashkëpunëtorët e tjerë, që har-tojnë traktate të fshehta në dëm të interesave të popullit e të atdheut të tij.³⁾

Duke u nisur nga rreziqet që kërcënonin atdheun tonë në këto çaste e duke marrë shkas edhe nga protestat e proletariatit dhe të elementëve përparimtarë italianë kundër qëllimeve të imperialistëve të Evropës, të SHBA etj., Avniu hartoi një memorandum, nëpërmjet të cilit demaskonte imperialistët dhe dënonte ashpër ata që donin të coptonin Shqipërinë.⁴⁾ Në fillim të memorandumit Avniu flet për ditët kritike që po kalonte Shqipëria nën pushtimin e huaj. Ai tregon se detyrë e rëndësishme e shqiptarëve në atë situatë ishte ngritja e zërit të përgjithshëm për bashkimin e zemrave dhe të veprave, sikurse në epokën e Kastriotit, e cila siç thoshte Avniu «formonte kurorën e artë të jetës sonë nacionale».⁵⁾

1) Fondi Muzeut Historik Gjirokastrë.

2) Po aty.

3) Memorandum. Maj 1919.

4) Po aty.

5) Po aty.

Avniu vinte në dukje se gjatë gjithë shekujve, shqiptari ishte treguar krenar, me virtyte të rralla, që edhe pse nën pushtimin e rëndë aziatik, nuk e kishte humbur kurrë flakën e lirisë, për të jetuar denjësisht dhe për t'u hedhur drejt përparimit.

Ai përmend si shembull patriotët Abdyl Frashëri, Vaso Pasha, Papa Kristo Negovani, Oso Kuka, Isa Boletini, Çerçiz Topulli e djem të tjerë të vendit tonë, të cilët i quante heronj dhe «burra të cilët u mbuluan me famë në fushat e betejave të lirisë dhe nderit». 1) Dhe me këtë rast përmend «Lidhjen Shqiptare të Prizrenit» të cilën e quan «kthimi i Skënderbeut dhe një herë tjetër në jetë» dhe pastaj ai pyet: «Po çfarë mund të bënte heroizmi njerëzor, kur kundra kësaj Lidhjeje, veç malazezve, serbëve e grekëve, shpërthyen edhe Dervish pasha me hordhitë e tij të tërbuara Otomane?»

Duke kujtuar periudhën e Gjergj Kastriotit, Avniu vë re se «nuk mund të shuhet vullkani i Lezhës, se çdo herë ai lëshon flakë e zjarr, për të nderur zemrën shqiptare, sikurse në kryengritjet e Kosovës, të Malësisë e të Toskërisë!» 2) Pastaj ai pyet: «Ku vallë është parë të derdhet kaq gjak njerëzor për dashurinë e shenjtë të lirisë dhe të qytetërimit?». Më poshtë Avniu përmend luftërat heroike të kryengritësve shqiptarë gjatë epokës së Rilindjes, si betejat kundër Mahmut Shefqet pashës, betejat e Kaçanikut, ku u luftua me vetmohim për çlirim e pavarësi. Avniu kritikon tendencat ekspansioniste të monarkive shoviniste ballkanike, që u intensifikuan sidomos pas

1) Memorandum. Maj 1919.

2) Po aty

shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Këtë frymë shoviniste ai e quan përtëritje të inkuizicionit.

Avniu në memorandum ndalet edhe në analizën e gjendjes së Shqipërisë pas Luftës së Parë Botërore. Memorandumi i Avniut përshkohet nga ideja se shqiptari gjithnjë ka qenë kryelartë, se kurdoherë e ka kryer detyrën jo vetëm përballë vetes dhe nderit po edhe ndaj botës së qytetëruar.¹⁾

Pastaj Avniu, me një shprehje të fuqishme patriotike, vazhdon: «Kudo që të ndodhemi, le të derdhim, të derdhim, o burra gjakun tonë, për të fituar lirinë e humbur!»²⁾

Avniu bën thirrje që populli «të bëjë çudinë e fundit, pas kësaj lufte botërore, për shpëtimin e atdheut, i cili ka qenë gjithnjë toka klasike e heroizmit, e inteligjencies dhe e lirisë». Ai tregon «se familja e Kastriotit e meriton lirinë e saj, se nuk mund të bëhet plaçkë e Malit të Zi, e Serbisë dhe e Greqisë... se kjo familje — shkruan ai më së fundi me zemërim — nuk mund të bëhet viktimë e politikës së kohës».³⁾

Në fund, ai i drejtohet me një apostrofë qytetërrimit modern që «me paturpësinë dënonte popujt, sikurse vepronte në kohët e mjergullta të kohës së mesme». Avniu dënon demagogjinë e politikanëve borgjezë për të cilët e drejta e vetëvendosjes nuk ka vlerë!»⁴⁾

Memorandumin e vet, Avniu e përfundon me një apostrofë tjetër për Fuqitë e Mëdha kapitaliste, duke thënë se «në këtë botë nuk zotëron e drejta dhe drejtësia veçse sa për sy e për faqe!»

1) Memorandum. Maj 1919.

2) Po aty.

3) Po aty.

4) Po aty.

Memorandumi i datës 4 maj 1919 është një provë tjetër e mendimeve revolucionare të heroit, i cili në atë fshat arbëresh punoi për zgjerimin e thellimin e veprimtarisë së «Shoqërisë së djelmoshave».

Për të zgjeruar më tej veprimtarinë e saj «Shoqëria e djelmoshave» të këtij fshati arbëresh u lidh me Komitetet arbëreshe të Palermos e të Napolit. Për këtë qëllim Avniu u nis të formonte degë të shoqërisë nëpër të gjithë ato qytete ku gjendeshin studentë shqiptarë.¹⁾

Gjatë tërë jetës së tij Avniu ruajti kujtimet më të mira nga ai fshat arbëresh, aq sa edhe kur u largua për të studiuar në Romë, ai u shkruante shokëve dhe miqve të tij të dashur: «Po i qaj me lot të zemrës ditët e kaluara në mes tuaj, po ju siguroj se unë kurrë s'ju kam për t'ju harruar. Banimi im në Romë pa ju, po më ngjan si një mërgim tepër i rëndë, nuk mendoj tjetër, vetëm sa të kthehem në mes tuaj».²⁾

Duke menduar të kthehej pranë shokëve në Shën Mitër Koronë, Avniu synonte të vazhdonte më tej punën në dobi të interesave të atdheut të vet e të forcimit të lëvizjes patriotike, në mënyrë që «kur atdheu të ishte në rrezik, edhe arbëreshët të ngrinin zërin për të drejtat e vendit tonë, që rrezikohej nga planet dhe synimet grabitqare të fuqive imperia-liste».

Në këtë fshat Avniu u njoh me profesorin arbëresh Kadi Kamo, koleg i vjetër i De Radës, i cili «ishte marrë shumë me çështjet shqiptare, e që ruante me kujdes një flamur të Shqipërisë» dhuruar

1) «Afrimi», Nr. 5, viti 1924, f. 67.

2) Fondi i klubit të opingarëve «Shpesa» — Gjirokastrë.

nga studentët shqiptarë. Çdo vit, në festat e 28 Nëntorit, ai e vendoste flamurin shqiptar në krye të banesës së vet. Profesori Kadi Kamo i fliste Avniut për luftrat e Garibaldit, me të cilin kishte luftuar bashkë për pavarësinë e Italisë. Avniu e takonte shpesh profesorin patriot arbëresh. Ishte koha kur në vendin tonë po bëheshin përgatitje për të goditur forcat e pushtuesve italianë në Vlorë.

Një ditë, në fillim të qershorit të vitit 1920, profesori Kadi Kamo mblodhi në sallën e kolezhit një numër studentësh. Me qëllim që të kuptohej edhe nga kolegët e tij italianë, ai foli italisht «duke sulmuar qeverinë italiane që po i binte më qafë, sikurse turqit pesë shekuj me radhë, një popull i të vogël, i cili e do vendin e vet dhe ka të drejtë e detyrë ta mbrojë atë, ashtu sikurse stërgjyshërit e tij». Drejtori dhe pedagogët italianë u zemëruan për këtë fjalim, mirëpo profesori Kadi Kamo, nuk u trondit aspak. Ai me guxim e gjakftohtësi uroi përpara tyre «fitoren e vëllezërve të gjakut», fjalë të cilat i theksoi duke tundur grushtin, që po i dridhej nga mosha e shkuar dhe nga dashuria për vendin e të parëve të tij.

Në të njëjtën mënyrë protestonte edhe proletariati italian, që u ngrit kundër luftës së padrejtë, që po bënte Italia imperialiste në Vlorë. Masat popullore përparimtare dhe proletariati italian u përpoqën ta sabotonin luftën. Ato nuk iu përgjigjën thirrjes së kryeministrit Bonomi, për të nxjerrë forca vullnetarësh, që t'i hidhte në frontin e Vlorës.

Është thënë e shkruar gjer më sot, se Avniu pasi kreu me sukses mësimet në normalen e Shën Mitër Koronës, nga fillimi i vitit 1920 shkoi në Romë, për të ndjekur studimet në fakultetin e peda-

gogjisë dhe për të përgatitur një provim që mendonte ta jepte në tetor.

Por ne, duke u mbështetur në letra të shokëve dhe në tregimet e tyre, mësojmë se Avniu në Romë nuk ka shkuar vetëm për studime/Ai në Romë nisi të punonte me revolucionarë italianë./Kjo vërtetohet edhe nga shkrime të dala në shtyp. Një shok i Avniut, na tregon se «nuk dihej shkaku i vërtetë, që e kishte shtyrë fatosin të vinte atje dhe të bridhte pa pushim»¹⁾. Nga ana tjetër ai tregon se Avniu nuk qëndronte në një vend, se mbante lidhje me shumë shokë, se bridhte kudo dhe nuk i linte pas mësimet».²⁾ Nga shkrime të shokëve të Avniut mësojmë gjithashtu se ai ka jetuar në kushte të vështira, në ngushtësi ekonomike sepse i «mungonin mjetet parimtare» dmth të hollat³⁾ por megjithatë ai nuk pushoi së punuari e së studiuarit. Megjithë vështirësitë që kishte mësimet i vazhdoi. Edhe kur ishte në Romë ai vazhdoi «të protestonte shpeshherë kundër të padrejtës, ashtu sipas mënyrës së mejtimit e të parimeve të tij».⁴⁾

Megjithatë ne akoma nuk dimë se në ç'mënyrë ka protestuar. Dihet që ai vijonte rregullisht mësimet, ndiqte nga afër ngjarjet politike të vendit, dhe në të njejtën kohë punonte me studentët shqiptarë, në aktivitete në dobi të atdheut. Avniu bënte takime me shumë patriotë, që kalonin në atë periudhë nga Roma në Paris dhe anasjelltas, meqenëse siç dihet

1) Revista «Afrimi», Nr. 5 — 1924.

2) Po aty.

3) Po aty.

4) Po aty.

në atë kohë zhvilloheshin bisedimet e Konferencës së Paqës.

Ai u takua disa herë me Nolin, Gurakuqin, Sotir Pecin etj. Këto pasqyrohen në letrat e shkëmbyera. Më 14 maj 1920 Avniu bëri një takim me Sotir Pecin, me të cilin foli për «gjendjen e studentëve në Romë». 1) Por në atë bisedë duhet të jetë folur për gjendjen e Shqipërisë, për rreziqet që kalonte vendi ynë, për synimet e armiqve, ngjarje këto që janë pasqyruar edhe në letrat e Gurakuqit, të Pecit, Nolit, që mjerisht na kanë arritur të dëmtuara. Nga goja e Avniut, disa patriotë gjirokastritë kanë dëgjuar për lidhjet që kishte ai me S. Pecin, Bajram Currin, L. Gurakuqin etj. Kur ishte duke vazhduar mësimet në Itali, Avniu mori vesh për vendimet e Kongresit të Lushnjës, i cili shpalli se shqiptarët, «ishin gati të derdhnin pikën e fundit të gjakut të tyre, kundër çdo veprimtarie, që vinte në rrezik pavarësinë dhe tërësinë e saj tokësore».

Avniu ndiqte me vëmendje ngjarjet në Shqipëri, veçanërisht atëhere kur Bajram Curri u caktua nga Qeveria e Tiranës Komandant i Përgjithshëm i Operacioneve për të shtypur bandat rebele-mercenare, të kurdisura nga armiqtë e vendit, të cilat në marrëveshje me Esat pashën, vepronin në favor të tij, brenda në Shqipëri.

Pikërisht në prag të shpërthimit të luftës çlirimtare antiimperialiste të Vlorës, nën nxitjen e Esat pashës, elementë esadistë të organizuar në banda nisën lëvizjen antikombëtare. Ato synonin të shkatërronin veprën e konsolidimit shtetëror dhe kombëtar dhe bënin lodrën e të huajve. Ata filluan sulmin kundër qeverisë pikërisht në pragun e Luftës së

1) Letër e datës 14.3.1920, nga Roma.

Vlorës, kur populli shqiptar po përgatitej të përleshje me imperializmin italian. Bandat esadiste ishin nxitur nga agjentët e politikës italiane dhe vepronin nën parullën e kthimit të Esat Toptanit në Shqipëri dhe të vënies së tij në krye të qeverisë shqiptare.¹⁾

Qeveria italiane duke mbjellë anarkinë në Shqipëri, kërkonte të tregonte me këto veprime gjoja «paaftësinë» e Qeverisë së Tiranës për të qeverisur vendin se ajo nuk ishte e zonja të vendoste qetësinë në Shqipëri etj.

Qeveria e Sulemjan Delvinës për të larguar rrezikun nga rebelët esadistë dhe me qëllim që të fitonte kohë për të grumbulluar forca të armatosura, përfundoi me rebelët një marrëveshje, sipas së cilës i siguronte ata se do të dërgonte një komision qeveritar në Paris për bisedime me Esat Toptanin, ndërsa bandat e armatosura të rebelëve ndërkohë të shpërndareshin.²⁾ Kundër tyre u ngrit populli. Qeveria e dalë nga Kongresi Kombëtar i Lushnjës detyrën e shtypjes dhe të asgjësimit të bandave esadiste e të lëvizjes së tyre antikombëtare, ia besoi heroit të maleve Bajram Currit, i cili në krye të forcave ushtarake, si kurdoherë e kreu me nder detyrën ndaj atdheut e popullit.

Politikanët e diplomatët italianë e panë qartë se vala e vrulli patriotik popullor dhe rritja e vazhdueshme e lëvizjes çlirimtare ishte një provë tjetër që tregonte se populli ynë ishte në prag të një lëvizjeje masive kundër politikës së bejlerëve, e të agjentëve të imperializmit italian. Vetë diplomati dhe ministri i Jashtëm i Italisë, Konti Sforca, detyrohej

1) Histori e Shqipërisë, vëll II, f. 483.

2) Histori e Shqipërisë, vëllimi II, f. 483.

Nje vizite interesante dhe
shumë e mallngjerë

Njera nga të gjitha kete vizita, që më
harrrohet kurrsë, i ishte ~~dh~~ bërë Avniut nga E.
Kanan Maze prej Shkodhës. Ishte mëngjesi e
ditës së tretë që Avniut që qëndroi në Spital. Atë
ditë Avniut e nisi çaktivuar të shkante në Prefek-
turë e në Beledije për t'iu kthyer vizitë të shkante
të tyre. Kur po vrimim në Zyrën e administratës
Avniut në vëndin e Kryesorit, që m'atë orë ai bënte
vizitën e të sëmurevet në pavione, duke shikuar
nga dritarja, dhe unë në tavolinën t'ime dhe
përmuar në qetësi, degjova zërin e dërdhur të
Avniut që tha: "po na vjen një mik" dhe i çelë një
bërë kurshetar ia të lëshoj penën e të shikoj se kush
ishite mikun që vinte. Tek portën e Spitalit u ndal
një kalëris dhe zbriti nga kafsha për të hyrë në
obor. Portieri i tregoi vëndin se ku duhej të lëte
te kafshën, atje jashtë telave rrotull të Spitalit
Pastaj mikun, Kananin, hyri në obor dhe u përshëndet
me Portierin, mbi lejën e të cilët Kananin hyri në
Pallatinë, trokiti në derë dhe u fut në dhomë. Atë
një herë iu hodh Avniut dhe e përzgafte të...

Kujtime bashkëkohësish për takimin e Avniut me
luftëtarin Kanan Maze në Vlorë, dhjetor 1920.

përthen buze për buze, një ashtu siç e ka pasur për
 zhanon popullit i ynë në Jugë. Mbasi u ulën
 nëpër kurriket karshi për karshi e u përshëndet-
 lën me gjërësiht, Arnu e pyeti në të plagës (1) që
 kishte marrë në luftë kundër italianëve dhe për-
 sigjë një psherëtimë të thellë nga zemra këthev
 kokën nga mua e më tha "Ja këta janë trimat
 e Vlorës Kreshnikë, dytë e popullit div e heronjë
 e Arbenisë që me gjak e sakrificë shporen nga
 mëmëdheu Italinë 40 milionëshë" dhe përçeri për-
 këllëti. Më pas, Seanani, në njëri e zgjuar e buzë
 këthev që ishte, ia previ gjalën dhe u përçjgj të
 kërisht këshutë: "Në qoftë, se lufta e jonë për
 shpëtimin e Vlorës i vuri këmbën e dytë për vrisht
 se independencës s'one, pas arsy se Lushtijes, kë-
 këthev e treti të arsy për vrishtje, ku qëndron vet kë-
 këthev".

(1) Seanani që plagosur në luftën e sipër. Plumbi e
 këthev, marrë me nëfull, afër këpës së veshit. Gjyoma e
 nëfullës i ishte thyer copë më copë. Në operacion u
 këthev edhe pak nga pyrra e mbetur. Nga këpë plazi
 Seanani që deformuar nga zurrat dhe shoket i këthev
 këthev e për të mëmëdheu. Këthev parazitje e këthev
 këthev e për këthev thellë Arnu se ai të përshëndetë kë-
 këthev nga zemra.

të pranonte se «ndjenjat nacionale kanë arritur gjer në shtresat e vetë popullit dhe po i nxitin këto shtresa, aq sa nuk dëgjohet më «autoriteti shekullor i bejlerëve».1)

✓ Megjithëse larg atdheut, Avni Rustemi i ndiqte hap pas hapi ngjarjet në Shqipëri. Ai u gëzua kur mori vesh asgjësimin e lëvizjes esadiste, dhe lajmin mbi masat që po merrte qeveria për stabilizimin e situatës. Ai u gëzua kur mori vesh se kullat e Esat pashës i dogji ushtria kombëtare, po ashtu edhe ato të Qamil bej Mulletit, se nga Kruja, Kavaja, Peqini dhe nga katundet u ndoqën elementë esadistë, se u kapën të gjallë nga forcat kombëtare Ymer begu e Jonuz Vrioni, Veli bej Kruja e dhëndri i tij Hamit bej Toptani. Ata u dërguan në Shijak, për t'u bashkuar në burg me shokët.2)

✓ Esat pasha, duke e parë qartë se shpresa e përpjekja e tij për të përmbysur Qeverinë e Tiranës e për të ardhur vetë në fuqi dështoi, nuk i mbeti tjetër veçse të kthehej e të shitej përsëri tek një fuqi e huaj. Kundër interesave të atdheut ai hyri në marrëveshje me shovinistët serbomëdhenj.

Shtypi evropian i ditëve të para të qershorit të vitit 1920 publikoi marrëveshjen e tradhtarit Esat me Pasiçin. Gazetat «Courrier de Geneve» e datës 12 qershor 1920, «Il Tempo» etj. tregojnë përmbajtjen kryesore të neneve të marrëveshjes të nënshkruar midis tyre sipas së cilës:

«1. Esati ishte në krah të tyre, për të vepruar brenda në Shqipëri,

1) Konte Sforza. Les batisseurs de l'Europe moderne. Paris.

2) Fondi i klubit të opingarëve «Shpresa» — Gjirokastrë.

2. se qeveria jugosllave do të mbështeste Pavarësinë e Shqipërisë me Esatin, si princ në Shqipëri,

3. të drejtat përmbi fronin e Shqipërisë t'i kalojnë mbretërisë serbo-kroate-slllovene, pas vdekjes së Esatit.

Këtë marrëveshje Esat pasha e bënte të njohur edhe me anën e një shpallje të veçantë, në të cilën, për qëllime demagogjike, shprehej gjoja kundër Italisë dhe pro Luftës së Vlorës. Atje ai shprehej njëkohësisht kundër Qeverisë së Tiranës, si e padenjë për të qeverisur dhe për të bashkuar vendin.»¹

Qeveria e Beogradit duke shfrytëzuar vështirësitë ekonomike që kalonte Shqipëria në vitin 1920 mendohej ta hidhte në thes Qeverinë e Tiranës. Me qëllime të paracaktuara ajo i akordoi qeverisë shqiptare një hua prej pesë milionë frangash, por kur erdhi puna për t'i dhënë këstin e parë, shovinistët jugosllavë vunë si kusht të parë të lejohej të vinte në Shqipëri Esati dhe të vendosej si anëtar i qeverisë.

Kur Qeveria e Tiranës e flaku tutje këtë kusht, marrëveshja nuk ekzistonte më dhe u quajt e pavlefshme.

Ndërsa Esat pasha kërkonte padronë të tjerë, populli ynë përkundrazi, nisi rrugën e luftës për të vënë në jetë aspiratat e tij.

✓ Kur në Vlorë u ndez lufta e në llogoret e saj luftohej me dyfeqe me gjalmë, djaloshi patriot Avni Rustemi plot guxim e trimëri u nis për të kryer aktin e lartë heroik në dobi të interesave të popullit e të atdheut. Ai u nis në Paris kundër agjentit të imperializmit, kundër Esat pashës. Në emër të interesave të atdheut ai do të kryente detyrën e Shenjtë që i ngarkonte populli. ✓

1) S. Shpuza. «Bajram Curri» — Tiranë, 1959.

NË PARIS

«Akti i Avni Rustemit kishte një kuptim politik dhe ideologjik. Plumbat e tij, që shtrinë përdhe pashën e Toptanit, ishin sinjali, kushtrimi i revolucionit demokratiko-borgjez, i një revolucioni të popullit tonë që do të ngrihej kundër feudalizmit».1)

Në verën e vitit 1920 pashai toptanas, që ishte agjent ndërkombëtar dhe afarist politik me damkë, vepronte në Paris si «Kryetar i qeverisë shqiptare» të Selanikut, i shoqëruar nga sharlatanë e të ashtuquajtur ministra të jashtëm si Pal Terka e të tjerë ortakë të tij duke bërë pazarllëqe me qeveritarë, politikanë e diplomatë jugosllavë, grekë e italianë. Si vegël e Pasiçit, Esati dhe kompania e tij, për të siguruar mbështetjen e përkrahjen e diplomacisë serbe, greke e italiane, në Konferencën e Paqës, u premtuan këtyre qeverive pjesë nga tokat shqiptare. Në këto çaste Esatit i doli përpara revolucionari Avni Rustemi, i cili, sikurse shkruan shoku Enver: «... nuk e zgjodhi kot personin mbi të cilin duhej të shpërthente urrejtjen e popullit shqiptar, ai zgjodhi Esat Pashë

1) Enver Hoxha. Fjalim në Libohovë. «Zëri i popullit», 29 maj 1969.

Toptanin, pikërisht atë që kishte shitur Shqipërinë tek otomanët, atë që u shërbeu gjermanëve të Vidit, që ishte shitur tek italianët dhe që në Paris përgatiste kurthe për Shqipërinë e re.¹⁾

Tetë ditë pas fillimit të Luftës heroike të Vlorës, Avni Rustemi, veprimtar si një pjesëtar sypatrembur i asaj epopeje legjendare të masave tona popullore, ashtu si këndoi vetë rapsodi i fshatit Ftterrë, kur tha:

*Ata edhe një shok e kanë
një luan Avni Rustemë
në Paris vrau Esanë,
që të shpëton mëmëdhenë.²⁾*

Në këtë periudhë kritike për vendin tonë, Esat pasha ishte armiku numër një i popullit. Atë e kishte dënuar vetë populli, por dora që do ta ekzekutonte ishte ajo e djaloshit Avni Rustemi.

Për Avniun ai ishte një tiran e një diktator, që kishte kryer shumë krime kundër popullit e atdheut, qysh nga viti 1912 e këndeje. Esati u përpoq me të gjitha forcat ta shkatërronte Qeverinë e zgjedhur nga Kuvendi Kombëtar i Vlorës, gjë që e vazhdoi edhe kur ishte ministër i Luftës në Qeverinë e Princ Vidit. Ai organizoi banda rrebelësh, që ndihmohehin nga trupat italiane e nga shovinistët ballkanas, me anë të të cilave masakroi shumë fshatarë. Për të kënaqur ambiciet personale, në vitin 1920 ai kërkoi shembjen e Qeverisë së Tiranës, që kishte dalë nga

1) Enver Hoxha. Fjalim në Libohovë, «Zëri i Popullit», 29 maj 1969.

2) QK Gjirokastrë.

Kongresi i Lushnjës/Ai ishte autor kryesor i shumë mjerimeve të vendit. Për këto arsye urrejtja e popullit ndaj tij ishte shumë e madhe. Vetë populli, fshatarë, vjershëtorë, shkrimtarë, malësorë, rapsodë nga veriu në jug e kanë dënuar Esat pashën me epitetet më të urryera, ashtu si e meritonte. Përmbi pesëdhjetë janë epitetet e mbiemrat që i dha populli asaj fytyre tradhtarë me damkë. Dikush e cilësonte kriminel e mizor, tiran të Shqipërisë, afarist politik, agjent ndërkombëtar, vagabond; të tjerë e cilësonin faqezi që shitej e blihej nga të gjithë, «Turgut pasha i dytë», vegël e osmanllisë, njeriu i marrëveshjeve të fshehta, kryevepër dinakërie, njeri pa princip, pa moral, pa nder, personifikim i tradhtisë, kallauz i vrasjes së Çerçiz Topullit, intrigant, ambicioz, karrierist, lubi, vampir e kuçedër etj. /

Esat pashë Toptani zotëronte mbi 10.000 ha tokë në zonën e Krujës, Tiranës dhe Durrësit. Ai ishte i lidhur ngushtë me bejlerët vrionas, dhe me ata të Këlcyrës. Esati u kish marrë shpirtin pak e nga pak gjithë bujkrobërve të tij. Kundra tij ishte ngritur Mati, Luma, Dibra, Golloborda, Çermenika etj. Ai ishte përfaqësuesi tipik i feudalizmit grabitqar, që e ropi popullin, si dhjetar e si çifligar i madh. Nga të varfërit ai nuk merrte atë taksë që u kish caktuar, por 5-6 fish më tepër, aq sa më në fund, kur fshatari nuk ishte i zoti të paguante, do të hynte borxh te ai. Kështu tokat e shtëpitë e të varfërve me kohë bëheshin pasuri e tij.

Bashkëkohësit e tij shkruajnë në shtypin e mërgimit se «ai kënaqej të rritej, pa le të shkelte në gjoks të mëmëdheut». Ai ishte afaristi dhe tregtari që në shkëmbime divizash të huaja fitonte gjer në

dy milion franga në një dorë. Bandat e tij kishin djegur 856 fshatra. Esati ishte shëmbëlltë e qeveritarit dallkaur. Kur holandezët i shkëlën zyrat e tij në Durrës i gjetën rreth 500 telegrame të paçelura fare. Ai ishte një qeveritar antikombëtar, pa parime e pa skrupull që kishte ndaluar pullat e postës me shqiponjën dykrenore. Kur ishte në Mirditë më 1915, bashkë me agjentët e tij përbuzte gjuhën amtare. Ai u bë bashkëpunëtori i ngushtë i kryemyftiut të Tiranës, i peshkop Jakovit të Durrësit, e që më vonë me nxitjen e tij e në bashkëpunim me malazetët vranë Çerçiz Topullin e Muço Qullin. Esat Toptani u ngrit kundër Qeverisë së Vlorës. Ai thoshte se Qeveria e Ismail Qemalit «kërkonte t'i bënte njerëzit kaurë, se do t'u humbasë xhamitë», prandaj shtonte ai «kush ishte me fenë islame të bëhej me Esat pashën, kurse ata që s'kanë fe të venë në Vlorë!...» Me të njëjtat profka ai kërkonte të përçante Gegërinë nga Toskëria, duke i paraqitur toskët «gjysmë kaurë» etj.

Por populli ynë nuk u gënjye asnjëherë nga demagogjia e tij tradhtare. Populli i drejtuar nga patriotët e vërtetë bashkohej gjithnjë e më shumë rreth Qeverisë së Vlorës. Patriotët luftonin për bashkimin e kombit duke i shpjeguar popullit fytyrën prej tradhtari të këtij pashai. Në shtypin e kohës ata shkruanin se «një ditë do vijë që bota do ta ketë për turp t'u verë djemëve të tyre emrin Esat». Esati ishte bashkëpunëtor dhe përkrahej nga figurat më të urryera të popullit tonë, si feudali Xhelal be Mati e pashai i Delvinës, me karrocën e të cilit më 1918 udhëtonte gruaja e Esatit nga Delvina në Gjirokastrë, e dërguar nga Esati me mision pranë autoriteteve të pushtimit grek. Esati ishte gjithashtu vegla e kryeministrit serb Pasiç dhe e kryeministrit grek

Venizellos. Ata i jepnin çdo përkrahje në dëm të interesave të vendit tonë, për ta bërë sundimtar në Shqipëri. Për shërbimet në dobi të shovinizmit grek, Venizelloja i dha Esatit dekoratën më të lartë të Greqisë. Shtypi i Gjirokastrës shkruante në atë rast se diplomatë si Venizelloja nuk duhet të shkojnë me ëndrra»¹⁾. Atdheu ynë e gjente gjithnjë përpara këtë tradhtar me damkë «me kamë (thikë) në dorë drejtuar zemrës së Shqipërisë».²⁾

Kundër veprës së tij që kishte pikësynim shkaktërrimin e kombit u ngritën studentët e Vlorës, të cilët bënë një telegram, nëpërmjet të cilit demaskonin orvajtjet e Esatit, që kundërshtonte Qeverinë e Ismail Qemalit, kur atdheu ishte në rrezik. Edhe shtypi patriotik, demaskoi me ashpërsi punën armiqësore të pashait, që deklaronte se nuk e njihte Qeverinë e Përkohshme të Vlorës, pasi ai vetë kishte ngritur një qeveri të re nga lumi i Matit, në Shkumbin. Shoqëria «Burimi» e Zvicrës, frymëzuesi i së cilës ishte Avni Rustemi, atëhere student në Zvicër, shkruante se Esati «do të ketë gjithë djalërinë dhe patriotët kundër tij, në qoftë se nuk vete në Vlorë» dhe se «partia e djelmohave dhe e patriotëve nuk do të pranojë kurrë punët dhe veprimet e kryetradhtarit». Duke u mbështetur te reaksioni klerikal, Esati bashkë me myftiun e Durrësit në krye, peshkopin Jakov, kryetarin e Bashkisë Mihal Gurashoviçin, organizoi në Durrës në vjeshtë të vitit 1913 mitingun kundër Qeverisë së Vlorës, ku u kërkua që mëkëmbës i përgjithshëm në Shqipëri të ishte Esat pasha.

I nxitur nga shovinistët e huaj dhe me përkrah-

1) Qendra Kulturore Gjirokastrë


2) Po aty.

jen e tyre e të agjentëve të rrezikshëm si Arif Hiqmeti, peshkopi Jakov i Durrësit etj./Esati shpalli në Durrës «Pleqësinë e Shqipërisë së Mesme». Ai mblo dhi rreth saj të gjithë çifligarët e mëdhenj shqiptarë, që u ngritën kundër programit të Qeverisë së Vlorës, e cila më 22 tetor 1913 premonte se «Shqiptari nuk do të mbetet kurrë pa qenë zot i dheut (i tokës)». Duhet thënë se lufta midis Qeverisë së Vlorës dhe asaj të Esat pashë Toptanit ishte shprehje e luftës së klasave midis forcave popullore patriotike dhe forcave feudale reaksionare. Esati përfaqësonte interesat e pronarëve të mëdhenj të tokës, të cilët në marrëdhëniet e tyre me fshatarët kishin vendosur parimet feudale. Esatin e përkrahnin përfaqësuesit e oxhaqeve të Shqipërisë, të cilët i shikonin me frikë rezultatet e mundshme të politikës tepër demokratike të Ismail Qemalit.¹⁾ Për të rrëzuar Qeverinë e Vlorës Esati bashkëpunoi edhe me agjentë turq. Nga viti 1914 e më tej ai veproi nën urdhërat e Romës e të Athinës./Qysh në qershor 1915, patrioti revolucionar Themistokli Gërmenji, në një letër drejtuar Pandeli Calit, shkruante se «të qëruarit e Esat pashë Toptanit do të bënte që të ndryshohej gjendja në Shqipëri»/

Por vetë populli, ky gjyqtar i drejtë dhe i pagabueshëm, që e urrente me gjithë shpirt pashanë toptanas, ka ditur dhe ka parashikuar që një ditë ai duhej dënuar nga dora e popullit për krimet, tradhtitë e dëmet e pallogaritshme që i kishte shkaktuar atdheut. Populli ynë u shpreh se llogaritë me Esat pashën «do t'i lante shkopi, ose më mirë konopi».

▲ Për t'i dhënë fund veprimtarisë tradhtare e an-

1) Histori e Shqipërisë, vëll. II. f. 399.



Revolveri me të cilën heroi ynë qëlloi për vdekje pashanë e Tiranës.
(gjendet në muzeun e Gjirokastrës)

PHOTOGRAPHIÉS DES FÊTES
CÉLÉBRÉES HIER A ROUEN
EN L'HONNEUR DE JEANNE D'ARC

LES CRISES MINISTÉRIELLES A ROME, A BR EXCELS

11^e Année. — N° 3.472.
Pierre Laffitte, fondateur.

PARIS, LE 13 JUIN 1925. 20 cent.
Moyennement, 4 pages. Vendeur de la circulation. Prix de vente au public. 25 cent.
Imprimerie : 30 cent. (sur prix de circulation, article 109)

* Le plus court croquis en 10 minutes
Ecl. : Couv. no 73 - 10 cent.

ESSAD PACHA, PRÉSIDENT DU GOUVERNEMENT D'ALBANIE



LE GÉNÉRAL ESSAD PACHA. — COMMENT AVNI RUSTAN TIRA SUR LE GÉNÉRAL ESSAD PACHA, RUE DE
l'attentat a été commis, hier à 13 h. 30, sur la personne du général Essad pacha Toptani, président du
gouvernement d'Albanie. Le général sortait de l'Hôtel Continental, où il habitait depuis un an. Il se
dirigeait vers le bord du trottoir afin de monter en automobile, quand un homme, qui se dissimulait

derrière un pilier des
portant. Le général a
un étudiant albanais

Avni Rustemi në hetue-
si, i goditur nga shko-
pinjtë e policisë.



BERLIN ET A VIENNE *
IOR

LUNDI
14
JUN
1920

Ceux qui n'ont que
de l'habileté ne trou-
vent en aucun lieu
le premier rang.

YANTENARQUES

... long ou un long rapport. * — NAPOLEON
A.D. 74. : Etant Paris. — en, rue d'Anglem, Paris.

A ÉTÉ ASSASSINÉ, HIER, A PARIS



CASTIGLIONE. — LE MEURTRIER AVANT ET APRES LE CRIME
... de la rue Castiglione, tira sur lui deux coups de revolver presque à bout
... foudroyé. Il avait été touché au cœur par l'un des projectiles. Le meurtrier,
... Avni Rustan, a été arrêté par des assistants, qui l'ont fortement malmené.

Signalement des prévenus



Après de la ... de do
... de do
... de do

[Handwritten signature]

L'Humanité

JOURNAL SOCIALISTE

POUR LES VICTIMES
DE LA GREVE
DES VIOLENCES
MATERIALES

Essad Pacha assassiné à Paris

LE SERVICE DES COMPAGNES

LE PRÉSIDENT DE LA DÉLÉGATION ALBANAISE
EST TUÉ DE DEUX COUPS DE REVOLVER
PAR UN ÉTUDIANT DE SON PAYS

Le syndicat d'Alger
va publier elle-même
le gas et l'abandon

LE GOUVERNEMENT ET L'OPINION

ÉDITION DE PARIS

Le Petit Parisien

(LE PLUS FORT TIRAGE DES JOURNAUX DU MONDE ENTIER)

général turc Essad pacha
assassiné par un étudiant albanais
moment où il sortait de l'hôtel Continental

LE CHARIOT ALPHEUS
à la gloire de l'été-été

Sourbier, à M. James He
gagne le prix du Jockey

Le Petit Journal

L'INTRUSE

ON TROUVE
ALLES
CHRISTEN

Essad Pacha, le chef albanais,
assassiné rue de Castiglione
par un étudiant albanais qui arrive de Rome

Contre-révolution
en Russie?

LES "TOURS DE FRANCE"
des visiteurs étrangers



tikombëtare të Esatit që kërkonte të ecte gjithnjë «përmbi eshtra e përmbi gërmadha», populli ynë kish menduar me kohë. Biri revolucionar i popullit tonë, Avni Rustemi, akoma student jashtë atdheut, në shkrimet e tij të zjarra, e paralajmëronte Esat pashën «të ndalej, të qëndronte në vend, se ndryshe një ditë populli do ta bënte të dridhej».

Në muajin prill ose maj 1920 në Vlorë u zhvillua një mbledhje ilegale, në të cilën Avniu bisedoi me shokun e tij të ngushtë Duro Dinon, student në Shën Mitër Koronë, e me të rinj nga fshati Velçë etj, me të cilët shtroi çështjen se do të gjendej një njeri i përshtatshëm për të zhdukur Esatin, pa u dhënë të kuptonin, se ai person do të ishte vetë.¹⁾ Më shumë fjalë ai nuk tha në atë mbledhje. Pas disa javësh, i shoqëruar nga dy anëtarë të «Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare», u nis nga Tirana për në Durrës e prej andej për në Itali, i përshëndetur gjer në anije nga dy shokët, që i uruan udhë të mbarë e punë të mbarë.²⁾

Për përgatitjet e atentatit të Parisit ai mbajti sekretin më të madh. Në një bisedë, në mbrëmjen e 3 janarit të vitit 1921 në katundarinë e Gjirokastrës, duke iu përgjigjur një pyetje, u mjaftua të deklaronte: «para gotave me verë ose me raki, këto biseda nuk këshillohen tani për tani; më vonë do të flasim, këtu do të jemi dhe do t'i tregojmë.»³⁾

Fakt është se Avniu veproi si një patriot i lidhur me disa pjesëtarë të Qeverisë së Tiranës, pjesëtarë

1) Fondi i QKGJ.

2) Fondi i QKGJ.

3) Pjesë nga biseda në darkën e dhënë nga qyteti i Gjirokastrës për nder të tij. Janar 1921.

të opozitës, të cilët dikur kishin qenë mësuesit e tij. Ai veproi i lidhur ngushtë me patriotët më të mirë, si një demokrat revolucionar, që kërkonte të siguronte prapavijat e kryengritësve shqiptarë në Vlorë.

Lufta në Vlorë dhe vepra e Parisit ishin një dhe të pandarë. E para ishte përlëshje me pushtuesit imperialistë italianë; aksioni i Parisit ishte pjesë përbërëse e kësaj lufte, ishte goditje kundër agjentit kryesor të imperializmit italian dhe i shovinistëve fqinjë.

Avniu nuk ishte i vetëm e i veçuar në Paris. Me të ishte një popull që kërkonte ndëshkimin e Esatit. Me të ishin mijëra vullnetarë, që ishin hedhur në luftë, që përlësheshin me pushtuesit italianë në brigjet e Vlorës. Dhe Avni Rustemi ndonëse larg atdheut, ishte pranë luftëtarëve. Aksioni i tij do ta ndizte edhe më shumë flakën e patriotizmit tek ata fshatarë trima e patriotë të mbledhur nga të katër anët e atdheut për të mbrojtur një nga qytetet e vendit tonë, Vlorën heroike.

Në të njëjtën kohë veprimaria e kolonive shqiptare të mërgimit ishte e lidhur dhe e koordinuar me punën që bënin patriotët tanë brenda vendit. Në periudhën 1918-20 në koloninë shqiptare të Egjiptit një aktivitet të shquar zhvilloi Çajupi, i cili kishte edhe «kokë» edhe kohë të vepronte për të mirën e Atdheut.¹⁾ Patriotët tanë të emigracionit, fizikisht ishin larg, por mendërisht e shpirtërisht ishin në Shqipëri. Këtë e tregon aktiviteti i shoqërisë «Bashkimi» të Egjiptit, që ka ushtruar ndikim në ngjarjet brenda në Shqipëri. Ka të dhëna se kjo Shqipëri ka menduar për zhdukjen e faqeziut Esat pashë Toptanit,

1) QK Gjirokastër. KOSH.

zhdukjen e të cilit, në një letër të tij, Çajupi e cilësonte si një shuarje të farës së tradhtarëve në Shqipëri. Ajo që ka rëndësi të veçantë është se në fondin e kësaj shoqërie ndodhet një letër pa datë, shkruar frëngjisht, ku qysh në fillim, tregohet «nevoja për të hequr qafe... Esatin».

Janë bërë mbledhje në shtëpinë e Andon Zakos «për do sende që i përkisnin Shqipërisë» etj.¹⁾

Duke u mbështetur në një letër të drejtuar Andon Z. Çajupit, më 23.8.1919, vërejmë se «Bashkimi», vëllazëria e shqiptarëve të Misirit protestonte për veprimet e Esat zi Toptanit».²⁾ Duket se në atë periudhë ishte formuar një lidhje.

Avniu do të vepronte në një çast kritik, kur ishte në rrezik fati i atdheut, kur patriotët ishin ngritur kundër diplomacisë evropiane, e cila kërkonte «ta shtinte popullin në varr për së gjalli». Ishte koha kur ata «kërkonin të qëndronin për një dekadë të ndershme, duke i mbetë besnikë njasaj Shqipërie, që na rriti e na burroi»³⁾, kur Konferenca e Paqes në Paris po ngjallte Traktatin e fshehtë të Londrës, për copëtimin e Shqipërisë, kur «Esati nxitohej të paraqitesh si i vetmi përfaqësues i Shqipërisë», për të shkaktuar turbullira në vendin tonë. Pikërisht në këtë situatë Avniu shpejtonte të zhdukte rrënjën e vërtetë të tradhtisë.⁴⁾

Veprimet e Avniut si student në Shën Mitër Koronë, tregojnë se ai që këtu po përgatitej për atentatin kundër Esat pashë Toptanit. Shokë të Avni

1) AQSH. Fondi i Shoqërisë «Bashkimi» Egjipt.

2) Dosja nr. 32, datë 15.5.1919.

3) H. Veterniku «Studime Historike» Nr. 4-1970, f. 73.

4) Po aty.

Rustemit që ishin në një kolegji me të, tregojnë se gjatë një mbledhjeje, u zu në gojë nevoja e vrasjes së Esat Toptanit. Ishte fillimi i vitit 1919. Por, meqenëse në këtë mbledhje protestoi një anëtar i shoqërisë dhe pikërisht Ymer Fortuzi, i ati të cilit ishte vegël e vjetër e Esat pashës, «Avniu si kryetar i mbledhjes, e preu menjëherë diskutimin». Dhe kronisti i kësaj mbledhje shton: «Por për sa dukej, kjo ide u ngulit në shpirt të Avniut...¹⁾. Që atë ditë — shton shoku i Avniut — nuk u bisedua më përreth Esatit edhe atëherë kur nuk ishte Ymer Fortuzi në mbledhje».²⁾

Se kush e propozoi atentatin kundër pashait nuk del, por është e qartë se Avniu e bëri vetë këtë propozim, pastaj e blloi atë në mendjen e vet, duke treguar kujdes të madh, që të mos bëhej më fjalë për të.

Ai, sikurse tregojnë shokët e tij intimë, ishte një njeri që më shumë blente sesa shiste, e që vepronte kurdoherë me mend e me gjakftohtësi... «Arritja e qëllimit ideal ka qenë kurdoherë për të gjëja më e lartë dhe më e shenjtë» — tregon një shok i tij.³⁾

Në prag të Luftës së Vlorës, Avniu la atdheun e u nis për në Paris. E la Vlorën disa ditë para shpërthimit të epopesë së saj. La Durrësin më 21 maj. Më 31 maj ndodhej në Francë. Më 2 qershor 1920 u takua me delegacionin e Qeverisë Shqiptare në Konferencën e Paqes, dhe më 4 qershor ishte në një ekspozitë shqiptare, për t'u takuar nergut me Gjergj Gogen, sekretarin e pashait të Tiranës, duke mos folur asgjë për çështje politike.

1) Fondi QKGJ.

2) Po aty.

3) Po aty.

Avniu në Paris qëndroi në një hotel, të cilin e parapagoi për një muaj. Këtë e bëri që të tregonte më vonë, pas atentatit, përpara hetuesisë, se nuk kishte ardhur në Paris për një qëndrim të shkurtër, por për një kohë të gjatë, për studime; se nuk erdhi për disa ditë, por për ca muaj, që të praktikonte gjuhën frenge...» etj.

Më 8 qershor nëpërmjet shtypit Avniu u informua për fitoret e para të vullnetarëve në Vlorë. Ai i vuri detyrë vetes të luftonte si ata me armikun, në një terren tjetër; ata në llogore, ai në bulevardet e Parisit, para hoteleve luksoze, ku qëndronte e jetonte kuçedra e regjur. Vërente me kujdes ku banonte pashai, dhe mori vesh se ai do të largohej nga hoteli, e se do të shkonte së afërmi të banonte në një vilë që do të lironte ministri i Serbisë në Paris. Këtë vilë e kishte blerë Esati, për të banuar aty.¹⁾

Avniu nuk iu nda asnjë çast qëllimit të tij të lartë. Ai kontrollonte çdo ditë orën kur hynte e kur dilte nga hoteli pashai, kur hante drekën dhe darkën. Tani qëndronte në një hotel më afër lokalit, ku banonte Esati, me qëllim që ta vërente më lehtë. Njëkohësisht bënte prova qitje me armë në një park, larg Parisit.

Ditën e 13 qershorit në kohën e drekës, ai u largua më shpejt se herët e tjera nga restoranti, pa u hedhur sy librave e gazetave, që rregullisht i vinte në tryezën e bukës. Në orën 13.00 ai qëndroi para hotelit. Në këtë çast Esat pasha po dilte me krenari nga hoteli. Djaloshi sypatrembur nxori revolverin nga xhepi i djathtë dhe qëlloi dy herë. Me njerin plumb e goditi tradhtarin në zemër dhe me tjetrin

1) QK Gjirokastrë — KOSH.

në mushkëri. Vetëm kur pashai ra për tokë, Avniu e flaku armën duke e parë veten të rrethuar nga policët.

Si vetëtimë veproi Avniu, si vetëtimë u hap lajmi gazmor në krejt vendin tonë e në gjithë shqiptarët në mërgim. Populli aty për aty, nga jugu në veri, përjetësoi ngjarjen duke gdhendur në vargjet plot frymëzim veprën që kreu revolucionari i ri. Në dy vargje populli dha qartë qëllimin e atentatit të 13 qershorit:

*«se Esatin na e vrau Avnia
Të shpëtojë Shqipëria».*

Sa e sa vargje u thurën për të. Për të këndoi fshatari, malësori. U frymëzua bariu, qytetari, intelektual. «Lule prilli e lule maji» e cilësoi Libohova djalin e saj «zog petriti» e quajti Veriu i Shqipërisë. Me epitetet më të hijshme e stolisi figurën e heroit populli. Ai e quajti atë trim të Shqipërisë e trim mbi trima, simbol të trimërisë, shtyllë të demokracisë e lulja e djalërisë, revolucionar zemërçelik, zemra e kombit, trëndafil me vesë, idealist pa njollë, që i ndërroi faqen historisë shqiptare, student duarartë dhe burrë i denjë për statujë.

Duke e ditur se ç'gëzim do të shkaktonte në Shqipëri zhdukja nga faqja e dheut e këtij tradhtari, Avniu deklaronte me krenari se «veproi vullnetarisht, me dashje dhe se nuk i vinte aspak keq, se erdhi nergut në Paris, për të sosur tiranin, përgjegjës i mjerimeve të Shqipërisë, se nuk mund të duronte që Esati të ishte në Paris i lumtur dhe i kënaqur,

ndërsa kushedi sa e sa bashkatdhetarë të tij vuanin»; Avniu shtoi se dita e 13 qershorit 1920 «do të ishte për ngaherë një ditë gëzimi për popullin shqiptar».1)

Kështu e përfundoi fjalën Avni Rustemi, kështu u shpreh edhe vjershëtori për këtë ditë, kur shkroi:

*Kjo do t'festohet kurr s'do t'harrohet
kangë do t'këndohet gjithmonë pa da.*

Me gjakftohtësi dhe me dinjitet u foli Avniu gazetarëve, ndërsa po e shpinin në burg. Ja një pjesë e dialogut midis tij dhe gazetarit të fletores së përditshme: «Lë petit zhurnal»:

— Për ç'arsye e qëlluat gjeneral Esat pashën?

— Ishte një tiran. Ai i ka bërë shumë të këqia vendit tim.

— Si mundët ta gjenit?

— Prisja të takohesha me sekretarin e tij, të cilin e kisha njohur gjatë një shetitjeje; kur pashë Esat pashën të dilte nga hoteli me plot fodullëk, m'u kujtuan menjëherë të gjitha krimet, për të cilat ky diktator ishte fajtor. Dora ime kapi revolverin që mbaja me vete dhe qëllova.

— A ju vjen keq për aktin që kryet?

— Përse të më vijë keq? Mua më foli ndërgjegjia ime. Dhe ju që rroni në Republikë duhet të më kuptoni.

— A ka shumë kohë që ndodhëni në Paris?

— Jo, vetëm tetë ditë. Kam ardhur për të mbaruar studimet që kisha filluar në Romë.

— Ju e flisni shumë mirë frengjishten. Ku e keni mësuar?

1) QKGJ, KOSH, Gjirokastër.

— Kam banuar për një kohë të gjatë në Zvicrën franceze».

Dhe përpara hetuesit, Avniu, deklaroi midis të tjerave:

«Duhet të them para së gjithash që, personalisht nuk kam pasur kurrgjë me veprimet e Esat pashës. Ai nuk ka burgosur dhe masakruar asnjë nga pjesëtarët e familjes sime dhe as nuk ka konfiskuar pasurinë tonë as krejt, as pjesërisht. Por si patriot shqiptar, kam arsye të bollshme për aktin që kreu.

Qysh prej vitit 1912 e 1913, atëhere kur, pas shekujsh robërie, Shqipëria, më në fund shpalli pavarësinë, Esat pasha në vend që të forconte ndjenjat kombëtare shqiptare, përpigjej të bënte të kundërtën duke proklamuar qeverinë shqiptare në Shqipëri të Mesme, si rezultat i së cilës ngjau shkatërrimi i Qeverisë së pavarur në Vlorë.

Në pranverën e vitit 1914, shqiptarët patriotë deshën ta shkoqin një pjesë të Shqipërisë së Jugut nga dominacioni grek dhe formuan trupa vullnetare për luftë. U rreshtova dhe unë, midis tyre. Nuk vounam të konstatojmë se Esat pasha, ministër i Luftës në Qeverinë e Princ Vidit, aso kohe, në vend që të na përkrahte ne, organizonte e armatoste banda të çrregullta malësorësh, që luftonin kundër nesh, aq sa, të mbetur në mes dy zjarresh vullnetarët patriotë nuk mundën ta vazhdonin luftën. Për më tepër në fund të këtyre ngjarjeve Esat pasha u akuzua prej popullit, por u mbrojt e u shpëtua prej trupave italiane.

Në mbarim të vitit 1914 u ndodha në Shqipërinë e Jugut. Mësova që Esat pasha kishte masakruar në Shqipëri të Mesme një shumicë patriotësh shqiptarë, atëherë kur Shqipëria Veriore ishte nën push-

timin e malazezëve e të serbëve. Masakrat, tregimin e të cilave e kam dëgjuar nga goja e refugjatëve duke qarë, ishin vepra të bandave të organizuara e të pajisura direkt prej Esat pashës. Ky ka vepruar kështu për të kënaqur ambicionin e tij personal, pse ishte lidhur me të gjitha vendet radhë pas radhe, duke ndjekur nevojat e çastit të interesit të vet.

...ka nja katër ose pesë muaj, që Esat pasha është përpjekur, por pa ia arritur, të shembë Qeverinë e pavarur të Tiranës. Për të gjitha këto arsye e konsiderova Esat pashën si autorin kryesor të mjerimeve të vendit tim dhe ushqeva për të një urrejtje të tillë.»¹⁾

Përgjigje plot dinjitet e kryelartësi karakterizojnë qëndrimin e revolucionarit tonë, i cili, sikurse thotë shoku Enver Hoxha — «...brenda në Paris u tha parizianëve se, ashtu si francezët i prenë kokën mbretit të tyre në kohën e revolucionit demokratiko-borgjez, ashtu edhe ai, për të shpëtuar popullin shqiptar, i zbrazi në gjoks të gjithë fishekët, gjithë urrejtjen e popullit shqiptar këtij qeni tradhtar».²⁾

Aksionin e tij në kryeqytetin e Francës e përshëndetën revolucionarë si Halim Xhelua, që «tregojnë se pushka e Avniut dëftoi se shqiptarët nuk e duronin më zgjedhën feudale».³⁾

Atë e përshëndetën publicistë patriotë, duke shkruar se «shfarosja e pashait ishte një provë se

1) Fondi i Muzeut Historik — Gjirokastrë.

2) Enver Hoxha, Fjalim në Libohovë. «Zëri i Popullit», 29 maj 1969.

3) QKGJ. Fondi KOSH.

Shqipëria nuk ishte çiflig i aristokracisë dhe molla e grindjes midis tyre, por përkundrazi një vend, që në gjirin e tij përbën një popull, të cilit i është zhvilluar mjaft ndërgjegjja kombëtare dhe guximi, sa të mos kursehej të shfaroste çdo feudal dhe çdo klikë, që mund të shfaqej për të rrezikuar interesat e At-dheut». 1) E përshëndetnin Avniun qytetarët me vargjet e tyre për aksionin e 13 qershorit, i kryer «që të shpëtojë Shqipëria, t'ngeli pa da, t'marrë fund ngatrrimi, t'soset mjerimi — t'mbretnojë bashkimi, t'rrojë vlla me vlla». 2)

Armiqtë e vendit tonë e pritën me hidhërim vrasjen e Esat pashës. Monarkët e Ballkanit, sovranë e peshkopë e vajtuan tradhtarin. Serbët që ndodheshin në Dibër, si shenjë zie për vdekjen e Esat pashës 3) e mbajtën flamurin të ulur tri ditë. Njëkohësisht Pasiçi, kryeministri i Serbisë, i deklaroi agjencisë së radios franceze: «Kjo zhdukje është për të ardhur keq, së pari, sepse Esat pasha ishte miku ynë, dhe gjithashtu miku juaj, (i francezëve)». 4) Jehonën që pati vrasja e Esatit në qarqet monarkiste të Ballkanit e pasqyron fare mirë poezia popullore në vargjet:

*mban zie Serbia, erret Greqia
qan Italia për at që u vra.* 5)

-
- 1) «Drita». Gjirokastër, 21.8.1920.
 - 2) «Gazeta e Korçës». Korçës, 2 korrik 1920.
 - 3) Gazeta «Drita» Gjirokastër.
 - 4) Gazeta «Le Temps».
 - 5) «Gazeta e Korçës», 20 korrik 1920.

Mbarë populli i uroi jetë të gjatë heroit të ri. Mbarë Atdheu ishte kryelartë, sepse vera e vitit 1920 i solli vendit «dy kurora radhazi: fitoren e Vlorës dhe aksionin heroik të Parisit»¹⁾. Me poezitë më të ngrohta e përshëndetën shokët Avniun e burgosur. E përshëndeti atë shoku i tij Ramiz Harxhi, që shkruante:

*u rrëzua Esat djalli, kriminel i aq
mjerimit
u dërmua qen i kombit, prej një
plumbi të një trimit²⁾*

E përshëndetën malësorët, vjershëtori nga Shkreli, që shkruan se «*e lumtun do të jetë gjithmonë Shqypnia, sa t'ketë ksi trimash, djem si Avnia*». Populli shprehu gjithashtu hidhërimin për burgosjen e Avniut. Ai shpallte se «do t'ngrinte statuqe, për kujtim». ³⁾ Shokët e fëmijërisë, bashkëpunëtorë të tij të mëvonshëm shkruanin se Avniu «nderoi Skënderbenë dhe se për atdheun ai u bë theror». ⁴⁾

Vlerësimi që i bëhej veprës së Avniut nga malësorët tregohet në fjalët e vjershëtorit që shkruante:

*«për deri sa të vlojë gjaku i Avnisë
ndër dej t'tjerëve djem të Shqypnisë
s'mund ta bajnë çiflig të venë
sado dhelpni e të holla të kenë».*

1) Gazeta «Koha». Korçë, 17.9.1921.

2) Fondi KOSH, Gjirokastër.

3) «Gazeta e Korçës». Korçë, 14 gusht 1920.

4) Qendra Kulturore — Gjirokastër.

Populli dënoi kështu tradhtinë në mënyrë lakonike dhe shpresonte e besonte në një të ardhme të lumtur gjersa Shqipëria do të kishte «Ksi trimash, djem si Avnia»!¹⁾

Kryelartë qëndroi Avniu në burg. Me optimizëm i shkruante ai familjes dhe të afërmeve nga burgu. Atij «nuk i vjen keq për vuajtjet, që janë gjërat e para të jetës së burgut, po i vjen keq vetëm që në Paris personi i tij ishte fare i panjohur kurse ai i Esat pashës njihej nga qarqet e larta të borgjezisë imperialiste franceze si «bujar» dhe i «lartë».²⁾ Avniu kërkonte që në të gjitha qytetet kryesore të Shqipërisë të bëheshin manifestime për t'i treguar botës pariziane se «ai ishte pa njolla e pa kleçka, që nuk i prishej puna për tradhtarët».³⁾

Atë e revoltonte fakti që shtypi dhe gjyqtarët, si shtresa të larta të shoqërisë franceze, vlerësonin gjeneralin, agjentin e imperializmit.

Heroi kërkonte nga djemuria:

- a) të mbushte detyrën,
- b) të veprohej që personi i tij të mos konsiderohej vrasës në botën pariziane.
- c) që në qytetet e Shqipërisë të bëheshin manifestime, për të treguar qëllimin e vrasjes së tradhtarit Esat pashë Toptanit.

Protestat që kishin filluar që në ditët e para të burgimit të tij tani u dëndësuan më shumë. Si stuhi u ngrit lart zëri i tyre për lirimin e studentit të ri.

1) «Gazeta e Korçës» Korçë, 20 korrik 1920.

2) Letër e Avniut nga burgu 19 korrik 1920. «Mbrotjtja Kombëtare», 20.10.1920. Nr. 2.

3) Letër e Avniut nga burgu 19 korrik 1920.

Gra e burra u ngritën në këmbë. Punëtorë, fshatarë, intelektualë të ndershëm, patriotë, mësues e bashkëpunëtorë të tij, malësorë nga çdo skaj i atdheut, shqiptarë nga çdo kontinent i kërkuan gjykatës franceze dhe Evropës të lironte Avniun.

Familja e Avniut protestoi nga Libohova pranë gjykatës së lartë, në Paris, me këtë telegram:

«Me fjalët, me mburojë, o mbi mburojë, i përcillnin një herë spartanët djemtë e tyre në luftë. Po me këto fjalë e nisëm ne, prindërit e tij djalin tonë në Parisin e revolucionarëve për liri. Si prindër të tij presim djalin, kurse Shqipëria, atdheu i djalit tonë, pret patriotin e ri».1)

Brenda një dite 44 telegrame u dërguan në Paris vetëm nga Vlora, atëherë kur para një mitingu foli patrioti Jani Minga, i cili thirri «që të kërkohej përkujdesimi i popullit freng, shembulli i lirisdashurisë». Protestuan shokët e Avniut, studentët shqiptarë nga Roma, të cilët ju drejtuan kryeministrit francez me këto fjalë:

«...kërkojmë prej zemërgjerës Republikë Franceze, e cila për të ruajtur nderin dhe lirinë kombëtare, e dërgoi në gijotinë edhe një mbret, jo butësi, por drejtësi për studentin shqiptar Avni Rustemi, i cili e ndjeu dëmin e sherrin që Esat pasha i ka shkaktuar atdheut me fijen e pakëputur ngatërresash e tradhtish kriminale dhe në emër të atdheut të vet u bë ekzekutor».

Po kështu protestoi artisti me famë botërore, me origjinë shqiptare, Aleksandër Moisiu. Protestoi më-

1) QK Gjirokastër.

ishte pleksur dhëlpëria orientale, bashkë me nuhatjen për të përfituar nga kundërshtimet në mes të fuqive imperialiste». ¹⁾

Vetëm parlamenti shqiptar, nën ndikimin e elementëve çifligarë e reaksionarë, megjithëse hartoi një telegram proteste për parlamentin e Francës, nuk e dërgoi atë, gjoja që të mos tregojë «se në këtë goditje kundër pashait tiranas, kishte gisht Qeveria e Tiranës». ²⁾

Megjithatë populli ynë, elementët përparimtarë, pjesa më e shëndoshë e patriotëve, nuk u ndal së protestuari dhe as u kursye të ndihmojë me të dy duart. Aq sa ishin protestat, aq ishin — shkruan një gazetë e kohës, edhe ndihmat materiale.

Një fushatë ndihmash u çel në qershor të vitit 1920, e cila vazhdoi gjer më 6 nëntor, «për të patur gati armët tona për shpëtimin e Avniut», sikurse thuhej në dokumentin e komisionit të posaçëm për mbrojtjen e tij. Një ndihmë të madhe materiale dhanë shqiptarët brenda atdheut. Ata kursyen nga goja, për t'i dërguar Avniut ato që kishin. Punëtorët e mërguar mendonin për atdheun e tyre, duke shkruar: «Punojmë nat' e ditë, si për ushqimin, ashtu edhe për jetën e Atdheut të shtrenjtë». ³⁾ Për fushatën e çelur në favor të Avniut ata dhanë 2000 dollarë, sikurse e tregon letra e datës 5.12.1920⁴⁾, një

1) Gazzete des Tribune, Paris, dhjetor 1920.

2) AQSH. Fondi A. Rustemi, dosja nr. 19, f. 2.

3) AQSH. Fondi shoqëria «Bashkimi» — Egjipt, Aleksandri. — Letër nga Manolesteri i SHBA. Andon Z. Çajupit, dt. 13.2.1919, dosja nr. 3,

4) AQSH. Dosja Nr. 38 letër e datës 5.12.1920. Fondi i Shoqërisë «Bashkimi» — Aleksandri, Egjipt.

Lors de son arrestation, l'accusé était porteur du revolver dont il venait de faire usage: c'est une arme de fabrication américaine du calibre d'onze millimètres; le barillet contenait six cartouches; deux étaient vides (c'étaient celles dont le feu avait atteint la victime); deux étaient intactes; les deux dernières, marquées de l'empreinte du percuteur, n'étaient point parties par suite d'une défectuosité de l'arme. Cette particularité révèle que c'est à quatre reprises que l'accusé a tiré sur le général; et ainsi s'explique la déposition de Djemil Vlora qui se tenait dans l'automobile où allait monter son oncle: Djemil Vlora, de la place où il était, ne pouvait pas voir Saad Pacha; mais, il affirme qu'après avoir entendu les deux détonations il a aperçu le meurtrier qui continuait à diriger son arme vers le sol "comme s'il tirait sur un corps étendu à terre"; interrogé à ce sujet, Mustem a déclaré qu'il ne saurait préciser le nombre de coups de revolver qu'il a tirés.

Aucun renseignement précis, en dehors de ceux qu'il a donnés lui-même, n'a pu être recueilli sur le passé de l'accusé.

Originaire de Libohovo (Albanie) il s'était destiné, dit-il déclaré, à la carrière de l'enseignement; il aurait été maître d'école, d'abord dans l'Albanie du Sud, puis à Vellona; à la suite de difficultés avec ses supérieurs, il aurait quitté l'Albanie au commencement de l'année 1911, pour venir à Rome pour suivre des cours de pédagogie; il aurait ensuite demandé à venir en France pour compléter ses études; il serait arrivé à Paris; quatorze jours après, il commença à travailler; il est actuellement réproché.

Dokument i hetuesisë franceze.



vniu para jurisë së gjyqit dhe avokati i tij mbrojtës.



Avokati mbrojtës
Anatol dë Monzi.



AVNI RUSTEMI

z. Sotir Gerko

Dhuroj \$ $\frac{300}{100}$

per mprojtjen e Avni Rustemit

Ark. K. Dsaak

Fushata për të ndihmuar heroin e burgosur. Me qindra patriotë të mërguar japin kontributin e tyre për Avni Rustemin.

NUMER 12 JUNI 1920.

Desse messeignés, étudians et patriotes aimés,
tant en notre propre nom, qu'en celui de nos compatriotes
résidant en Roumanie, nous prenons la liberté de vous
adresser la présente, pour vous prier de bien vouloir
porter ostensiblement à notre enseignage, que - nous venons
vous solliciter dans les affaires de la Justice, et plus
de confiance en celle de la grande France - l'étudiant
AVNI RUSTEMI, qui a surpris M. de Bucin le 15 juin 1920,
à Paris est connu par nous tous comme un jeune homme
honnête et idéaliste et que le meurtre de son acte vio-
lent M. de Bucin n'a pu être dicté que par son patrio-
tisme dans le but de défendre sa patrie - et peut-être
l'humanité entière - d'un homme connu par nous tous
tantre à son propre pays et comme une personne dange-
reuse par son immobilité.

Veuillez agréer, Monsieur le Ministre, l'assurance
de notre parfaite considération.

Ho J. Zade - Etudians
M. Jiro Etudians
Tomou Iovanovic Etudians
Effim Jovanovic Etudians
Emil Cigan
Andreea
Andreea
Andreea
Andreea
Andreea
Andreea

FALËNDERIE

Studentë e patriotë shqiptarë të
Rumanisë protestojnë pranë Mi-
nistrisë së Drejtësisë, në Paris.

Ufalëm nderit Ka:u-
ndarivët. Shoqërivët
dhe Shqiptarvët (Brë-
nda dhe jashtë Shqi-
përisë që u-përpoqnë
për shpëtimin t'im
dhe që më uruan liri-
min.

AVNI RUSTEMI

Avniu falënderon popullin e vet
pasi lirohet nga burgu.

pjesë e së cilës ishte dërguar në Paris për Avniun dhe gjyqin e tij.¹⁾

Në ato ditë të vështira Avniu pati pranë vëllain e vet, Fejzon, që braktisi punën si punëtor në mërgim dhe shkoi në Paris, për t'iu ndodhur pranë të vëllait e për t'i ardhur në ndihmë. Bashkë me të në ndihmë të Avniut shkuan shumë punëtorë të tjerë shqiptarë të mërguar në Francë.

1) AQSH, Dosja Nr. 38, letër e datës 5.12.1920.

TRIBUN I POPULLIT

«Pas atentatit historik, gjykata e Parisit u gjend përpara një opinionit të madh botëror në mbrojtje të këtij djali të ri».1

Gjyqin e Parisit Avni Rustemi e ktheu në një tribunë për të mbrojtur të drejtat e popullit tonë duke qëndruar kryelartë përpara çdo faze të procesit hetimor e gjyqësor. Ai diji të rrëzojë akuzën e vrasjes me paramendim, sepse, në mbështetje të nenit 302 të kodit penal të Francës, ai duhej të dënohej me vdekje. Për të shpëtuar nga kjo, i bindur në drejtësinë e çështjes e në përkrahjen e gjithanshme të popullit e të mbarë elementëve të opinionit publik përparimtar, me zgjuarësi dhe llogjikë ai provoi se vrasja ishte kryer në çastin e një tronditjeje shpirtërore.

Me energjinë e guximin e një revolucionari të paepur, Avniu edhe përpara gjykatës, ashtu si kishte dënuar tradhtarin diji të mbronte veten, dhe të dëronte tradhtinë.

Përpara jurisë Avniu bëri një debat të ashpër

1) Enver Hoxha. Fjalim në Libohovë. «Zëri i popullit», 29 maj 1969.

me esadistët, me pseudoministrat e Esatit, që bënin pjesë në «qeverinë shqiptare të Selanikut», në atë «të Durrësit», «të princit të Mirditës», e të tradhtarëve të tjerë. Mjaft me interes janë deponimet, shënime me dorë të Avniut në krah të thënieve të dëshmitarëve të akuzës. Kur Pal Terka, që paraqitej si ministër i Esat pashës, depononte se pas varrimit të Esatit do të shkonte në Selanik për një kohë të pacaktuar, «për të të marrë masat që do të sillte gjendja», Avniu nga ana e tij shkruante: «Po përpiqet të shkaktojë çrregullime në Shqipëri, po kjo do të jetë pak si e vështirë, sepse nuk do ta lejonin patriotët e populli shqiptar».1)

Kur Pal Terka mendohej të fliste akoma, Avniu shënonte se «esadistëve u dridhen këmbët dhe nuk guxojnë të shkojnë në Shqipëri». Shënime ai i mbante që të ishte i përgatitur të godiste ata që ndiqnin akoma rrugën e pashait. Populli kërkonte masa energjike kundër tradhtarëve dhe shprehej se «Shqipëria nuk ishte Turqi, se nuk duhet të bëhej fushë e intrigave, se i ligu duhet të gjente vendin e tij ku e kish në burg, ose në tërkuzë».2)

Në deponimet e Pal Terkës, i cili vazhdonte ta quante veten ministër, Avniu shënonte se kjo «është ngjarje e çuditshme, se ai pa pikën e turpit i jep vetes titullin ministër». — «Kjo shënonte Avniu — është kundër vullnetit të popullit dhe është një përrallë si ato të Mesjetës barbare». Në anë të deklaratës të Pal Terkës, se «në Tiranë ndodhej një qeveri shqiptare e përkrahur nga Italia», Avniu shë-

1) Aqsh. Fondi A. Rustemi, pjesa nga procesverbali i gjykatës penale të Senit kundër Avniut, nr. 791.

2) QK Gjirokastër. Klubi i opingarëve «Shpresa».

nonte se kjo ishte një gënjeshtër. Në deponimet e nipit të Esatit, Xhemil Vlorës, që pohonte se qeveria e Esat pashës ishte një qeveri faktike, e krijuar nga ungji i vet, Avniu shtonte: «Po, krijuar nga ai vetë për të kënaqur trillet e tij kundër dëshirës së popullit të mjerë, që vuan përherë nga njerëz të tillë». Avniu shtonte: «Xhemili (Vlora) i bënte përkëdhelje pushtimit italian, ashtu si ungji i tij të tjerëve».1)

Avniu, në një debat me gjykatësin, tha se nuk kishte kërkuar të takohej me Esatin sepse «njeriu ikën larg nga një send i neveritshëm»2). Pastaj Avniu tregon se gjoja «vetëm rasti, mbreti i botës, deshi edhe një herë që ai të ndodhej ballëpërballë me Esatin», dhe shtonte se porsa e pa atë tradhtar, zemra e tij prej patrioti u çua peshë, dhe shtiu mbi të. Ky ishte një gjest instinktiv dhe se duheshin kuptuar ndjenjat e një zemre shqiptare dhe krahu i tij u ngrit nga një ndjenjë e lartë.3)

Debati vazhdoi me kryetarin e gjykatës. Avniu pohonte se erdhi në Paris në fund të muajit, për të praktikuar frengjishten. Kryetari, që e dëgjonte se ai e fliste mirë këtë gjuhë, e ndërpreu duke i thënë se ai nuk kishte nevojë për ushtrimin e gjuhës. Atëhere Avniu u përgjegj me ironi se gjuhën frënge e ka praktikuar edhe në burg.4)

Me mënçuri dhe krenari mbrojti përpara gjyqit veten dhe interesat e atdheut të vet, biri i popullit, Avni Rustemi.

Gjatë procesit gjyqësor ai qëndroi i gatshëm për

1) AQSH. Fondi i A. Rustemit.

2) Gazeta «Le Temps». Paris, 30.11.1920.

3) QK Gjirokastër. KOSH.

4) Po aty.

t'iu përgjigjur të 24 dëshmitarëve, veçanërisht atyre të akuzës dhe prokurorit, që kërkonin për të dënimin kapital. Akuzës së pa vend të prokurorit se «Franca nuk ishte shesh plehrash, ku duhet të hidhen grindjet e kombeve», Avniu diji t'i përgjigjej me energji, me argumenta dhe me guxim.

✓ Gjesti i heroit tonë, Avni Rustemit tërhoqi vëmendjen e opinionit botëror dhe të mbarë elementëve përparimtarë.

Gjyqi i Parisit u zhvillua në një periudhë kur masat popullore shqiptare, tre muaj më parë, në llogoret e Vlorës kishin arritur një fitore tjetër kundër imperializmit italian. Patriotët tanë dhe mbarë populli shqiptar sapo morën vesh qëndrimin e gjykatës franceze u ngritën në këmbë. Ata shprehën ndjenja simpatie për qëndrimin burrëror të Avniut dhe kërkuan lirinë e tij. Në ndihmë të Avniut ishte edhe presioni i opinionit përparimtar botëror, që ngulmonte për lirinë e tij. Patriotët tanë kërkuan që Avniun ta mbronin personaliteti i dëgjuar, avokati Anatol de Honzi, njeri me kulturë të gjërë, autor i afro njëzet veprave letraro-politike, mik i Marsel Kashenit.

Revolucionari shqiptar, Avni Rustemi i shpjegoi avokatit qëllimin e atentatit. Ai i tregoi atij mjerimet që i kishte shkaktuar ky pasha vendit të vet. Avokati Anatol de Monzi i kuptoi ashtu si duhet arsyet pse patrioti shqiptar e shtriu për tokë pashanë e Tiranës. Avokati e siguroi Avni Rustemin se do të vinte gjithë forcën për mbrojtjen e çështjes së tij të drejtë. Për avokatin, Avniu, më 19 korrik 1920, i shkruante edhe familjes së vet në Libohovë.¹⁾

1) Një mik i vendit tonë, kur vizitoi një muze në Gjirokastrë dhe pa aty se mbrojtës i Avniut ishte Anatol de

Më në fund, juria, e ndodhur nën presionin e opinionit publik shqiptar dhe të atij botëror, u detyrua t'i jepte Avniut pafajësinë. «Ky student — tregonte vendimi i jurisë — nuk mori hak për interesa personale, por qëlloi në emër të gjithë atyre që e quanin të nevojshme zhdukjen e Esat Toptanit».

Historike mbeti qëndresa, krenaria, kthjelltësia e guximi i Avniut gjatë mbrojtjes së tij në gjyq. Historike mbetën fjalët e tij kur doli nga praku i burgut. Në përgjigje të pyetjeve të disa gazetarëve francezë, të cilët e pyetën se si do të vepronte pas kthimit në atdhe, ndaj bashkëpunëtorëve të tjerë të Esatit, Avniu me kurajo iu përgjigj: «Po të jetë nevoja, të tjerë Esatër do të vriten në Shqipëri». 1)

Monzi, shkroi këto fjalë në librin e përshtypjeve: «Me krenari pashë në muze se avokati de Monzi ka mbrojtur patriotin tuaj. Gjatë kësaj vizite kisha gëzimin dhe habinë të gjeja gjurmat e Antol de Monzit, njeri i palodhur i ideve liridashëse».

1) Gazeta «Shqipëria e re». Kostancë, 1.1.1921 dhe 20.1.1921.

NË GJIRIN E POPULLIT QË E LINDI

«Si vetëtimë u hap lajmi i kthimit të Avniut në Shqipëri. Pagoi një frang gjobë për gjakun e tradhtarit që lëvriu rrugët e Parisit. Shqipëria ia pastë hua shërbimin e madh që i solli, duke rrojtur shumë vjet në Shqipëri».1)

MIHAL GRAMENO

Mbarë populli shqiptar, me emocione të papërshkruara priste me padurim në gjirin e vet birin e tij të shtrenjtë. Më 24 dhjetor 1920, në orën 7¹⁰ të mëngjesit, në skelën e Vlorës, ku do të zbriste Avniu ishte grumbulluar një shumicë e madhe njerëzish. Ata e pritën me një entuziazëm të papërshkruar heroin, e ngritën atë në duar dhe bashkë me të u drejtuan drejt zemrës së qytetit. Ata ishin patriotë e luftëtarë të vjetër, ish-nxënës e ish-nxënëse, invalidë e pjesëtarë të Luftës së Vlorës etj.

Në pritjen e organizuar për nder të tij foli Halim Xhelua. Ai shprehu dashurinë dhe mirënjohjen e thellë të popullit shqiptar për aktin heroik të pa-

1) Gazeta «Koha». Korçë, 1 janar 1921.

triotit të ri. Pas tij e mori fjalën vetë Avniu, i cili midis të tjerave tha: «Jam krenar që ndodhem midis djalërisë vlonjate, nuk bëra gjë tjetër veç detyrës që më takonte e që duhej ta bënte çdo shqiptar».1)

I tërë populli e mori në mbrojtje dhe në kujdesje patriotin që posa kishte mbritur në tokën amtare. Pasi qëndroi ndonja dy ditë në hotelin «Ballkan» patriotët e çuan atë në një dhomë të spitalit civil, tek një shoku i tij. Ushqimet që hante Avniu në restorant kontrolloheshin më parë nga shokët e tij më besnikë. Po kështu ishin marrë edhe masa të tjera sigurimi për jetën e tij.2)

Në atë dhomë të spitalit erdhi nga fshati për ta takuar menjëherë Kanan Mazja, invalid i Luftës së Vlorës. Ai zbriti nga kali, dhe Avniu, që e pa nga lart duke hyrë në oborrin e spitalit, doli menjëherë për ta pritur. Ai iu hodh në qafë për ta puthur atë *nofull copa-copa*3). Kurse Kanani i rrembeu dorën për t'i puthur *gishtin*, me të cilin kishte shkrepur armën në Paris. Takimi i luftëtarit trim të epopesë së 1920-ës me heroin e ri, ishte një skenë mjaft pre-këse që i emociononte të gjithë.

Telegrame, ftesa e letra të panumërta i erdhën Avniut ato ditë që qëndroi në Vlorë. Atë e ftonin dhe e prisnin të vinte në qytetet e fshatrat e mbarë Shqipërisë. E përshëndesnin «si heronë, si idealistin më të madh, jo vetëm për Shqipërinë, po për gjithë Evropën e botën».4)

Pasi u largua nga Vlora, Avniun e priti qyteti

1) QK Gjirokastër.

2) Po aty.

3) Po aty.

4) «Drita». Gjirokastër, 27.12.1920.

i vogël i Tepelenës, që e kishte patur në gjirin e tij si mësues; e priti Gjirokastra, ku ai arriti natën vonë më 3 janar 1921, për arsye të një aksidenti automobilistik.¹⁾ Avniu shoqërohej nga i vëllai i tij Fejzua. Në Gjirokastër kishin dalë për ta pritur shumë shokë e miq. Në sallën e katundarisë atij iu bënë përshëndetjet më të zjarra. Avniu çmallej me shokë e miq të vjetër, duke qëndruar gjer vonë në bisedë me ta. Për të shkruanin me simpati e me respekt të veçantë gazetat e qytetit, duke e cilësuar «patriot, që qëroi gjëmbin e rrezikshëm».²⁾ Atë e përshëndetnin me shkrime të veçanta shokët e tij, të cilët organizuan edhe shfaqje teatrale si «Shaja», që u dha për nder të Avniut në një sallë të qytetit. Shfaqjen e organizuan amatorët e shoqërisë teatrale «Gjirokastra». Në shfaqje mori pjesë dhe kryetari i Qeverisë së Tiranës, Sulejman Delvina etj. Avniu vizitoi shkolla, hyri nëpër klasa, bisedoi me nxënës. Kudo u prit me entuziazëm. Nxënësit e shoqëronin gjer te klubi i opingarëve «Shpresa», te stera e pazarit të qytetit. Të tjerë zbrisnin nga lagjet dhe kërkonin ta shikonin patriotin. Disa prej tyre i ruajnë kujtimet e atyre ditëve edhe sot. Mësuesit e vjetër Sokrat Kutra, Thanas Konomi, etj. akoma e kujtojnë Avniun, sjellin në mend çastet kur ai u shkoi në klasë dhe bisedoi me nxënësit.

«Sikur e kam akoma në sy — tregon një mësues pensionist — kur ne, poshtë te stera, e vërenim atë që qëndronte sipër në ballkonin e klubit «Shpresa.»»

Më 5 janar 1921 një pritje të madhe i bëri Avniut, Libohova. Ashtu si e pret mëma të birin,

1) «Drita». Gjirokastër, 27.12.1920.

2) Omonia. Gjirokastër.

ashtu e priti qyteti i lindjes revolucionarin, djalin e tij. Në ato momente beu u mbyll brenda dhe urdhëroi të mbylleshin dritare e dyer.¹⁾ Kurse mbarë vegjëlia zbriti në këmbët e qytetit. Qyteti i Libohovës ishte zbrazur pothuajse krejt, sepse kishte dalë për të pritur patriotin, që nderoi Shqipërinë. Në krye ishin prindërit, mëmë Laleja e i ati xha Neimi. Ata nuk çmalleshin dot me të, krenoheshin me të. Ishin bashkëqytetarët që e patën mësues të tyre. Ishin shokët që kishin studiuar së bashku me të në fillore, e që kishin luajtur nëpër oborret e sheshet e Libohovës.

Me përzemërsi e pritën pleqtë e plakat, që nuk mundën të zbrisnin dot poshtë. Me mall e dëgjonin të gjithë, duke e patur në mes të tyre, ashtu të thjeshtë e të dashur siç qe ai. Me modestinë e birit të thjeshtë të popullit Avniu u tregoi atyre «... se ajo që bëri ishte një pjesë e luftës së tij, se ai ndjente që i kish borxhe të mëdha popullit».²⁾

Nga Gjirokastra Avniu falënderoi me anën e shtypit demokratik «katundaritë, shoqëritë dhe shqiptarët brenda dhe jashtë Shqipërisë, që u përpoqnë për shpëtimin e tij dhe që e uruan për lirin nga burgu».³⁾

Me gëzim të madh e priti populli i Beratit, ku mësuesit dhe nxënësit e shpallën hero, duke i dhënë edhe një «kokardë» të Skënderbeut. Ata e karakterizuan aksionin e Parisit si një akt që «siguroi mën-

1) «Drita», Gjirokastër, 27.12.1920.

2) Enver Hoxha. Fjalim në Libohovë, «Zëri i popullit». 29 maj 1969.

3) «Drita». Gjirokastër, 3 prill 1921.

gjesin e Shqipërisë»¹⁾, mëngjes që lindi me plumbin që zbrazi ai para hotelit «Continental»

«Në Korçë, u derthnë të gjithë, për t'u bashkuar me Avniun tonë», shkruante patrioti Mihal Grameno²⁾, duke përshkruar momentet e ardhjes së Avniut në Korçë. Ai e cilësonte atë si djalin e Korçës plakë. Në një banket të madh që dha qyteti, Avniu, duke marrë gotën në dorë uroi shokët e «Vatrës» së Korçës me përshëndetjen tradicionale «Mirë se ju gjeta vëllezër korçarë». ³⁾ Nga ana tjetër në ato momente u shpreh edhe njëherë kujdesi i madh që tregoi Mihal Gramenua për të ardhmen e Avniut e sidomos për jetën e tij e pastaj për studimet, që ai duhej të vazhdonte. Ai e porositi Avniun duke i thënë «se nuk i vinte ta zinte ngoje, se mos ndonjë i paudhë prej farefisit të tradhtarit paguante për humbjen e Avniut, që ta humbasë nga kjo botë»⁴⁾. Gramenua tregoi se «humbja e tij do të hapë shumë plagë të mbëdha dhe të vjetra...» Më së fundi ai e këshilloi Avniun me fjalët e popullit se «uji fle, armiku s'fle». ⁵⁾

Gramenua kërkonte dhe e këshillonte që ai të mos humbiste kohë por sa më shpejt të ngrihej e të shkonte në Evropë për të mbaruar studimet e tij, që një ditë t'i shërbente shoqërisë me diturinë e tij.

Duke parë kushtet në të cilat vepronte dhe jetonte Avniu e duke kuptuar urrejtjen e klikave çif-

1) Shtëpia muze Libohovë. Letër dekorimi për Avni Rustemin nga nxënës e mësues të Beratit.

2) Gazeta «Koha».

3) KQ Gjirokastër.

4) «Koha» Korçë.

5) Po aty.

ligare dhe të esadistëve, që me Zogun e «ronxhobonxhët» në krye kërkonin të vendosnin pushtetin diktatorial, Mihal Gramenua kërkoj «largimin e Avniut përkohësisht, sepse parashikonte të goditej prej reaksionit çifligar».4) Këto ishin njëkohësisht edhe shqetësimet e patriotëve të tjerë. Këtë të keqe, ai nuk donte ta zinte as në gojë, por e parashikonte. Atentatori ishte vërtet një nga njerëzit e Esatit, nga rrethi i Zogut, i cili, nuk e vrau Avniun, sepse ky i kish vrarë dajën e vet, Esat pashë Toptanin, në kuptimin e thjeshtë të hakmarrjes, por sepse ai ishte një atentat i kryer nga Zogu dhe që kish një kuptim të madh politik dhe ideologjik.

Edhe në qytetet e tjera ku kaloi, si në Elbasan, Shkodër, etj., Avniu u prit me nderime dhe me dashuri të madhe. Gjatë qëndrimit në Përmet, ai kontribuoi në themelimin e shoqërisë «Njeriu i ri»²⁾, që synonte «të hiqte fuqinë shtetërore nga duart e klasit aristokratik dhe dorëzimin në duart e klasit popullor». Këtë shoqëri ai e përfaqësoi vetë në Kongresin e Vlorës, qëllimi i të cilit ishte bashkimi i të gjitha klubeve dhe shoqërive ekzistuese në atë kohë në Shqipëri.

Atë krahas patriotëve të tjerë të shquar të kohës do ta shohim të fillojë nga puna, për ta ngritur popullin, për ta bashkuar e për ta hedhur në luftë, për të shkuar nga rrënjët bejlerët, agallarët, pashallarët dhe gjithë gjakpirësit e popullit shqiptar. Për këtë qëllim ai kaloi në shumë qytete, në shumë krahina. Në Gjirokastrë me iniciativën e tij, u themelua «Klubi po-

1) Mihal Grameno. Gazeta «Koha» — Korçë.

2) Fondi QK Gjirokastrë.

litik Lekë Boçari»¹ për mbrojtjen e interesave politike të mëmëdhezes dhe veçanërisht të krahinës së Gjirokastrës». ²) Nën kryesinë e Avniut u formua një komision, ku merrte pjesë edhe patrioti Polo Mexsi, ish-ndërlidhës kryesor i kolonisë shqiptare të Bukureshtit me vëllezërit Frashëri³) për të përgatitur një kantonizmë të posaçme, që do t'ia paraqesnin mbledhjes së klubit politik. Më 18 qershor 1921 në një shkollë qytetëse në Gjirokastrë, u bë mbledhje për të aprovuar statutin.⁴)

Ishte periudha kur në Konferencën e Ambasadorëve vazhdonin pazarllëqet e diplomacisë së monarkive shoviniste fqinje dhe të imperialistëve në dëm të tërësisë tokësore të Shqipërisë. Ato bënë plane për coptimin e Shqipërisë. Por populli shqiptar e sidomos vegjëlja me guxim e trimëri i dolën zot fateve të atdheut. Një frymë e tillë patriotike përshkoi mitingun antiimperialist që organizoi klubi «Lekë Boçari» në 13 korrik të vitit 1921, në kopshtin e katundarisë. Aty u bë «betimi i popullit», që të mos lejohej asnjë pëllëmbë vend nga tokat e Shqipërisë». Avniu lexoi para popullit protestën drejtuar Lidhjes së Kombeve kundër planeve shoviniste të shteteve fqinje dhe deklaroi se populli shqiptar kurrrë nuk do t'i përunië një vendimi të saj»⁵) për copëtimin e Shqipërisë.

Me iniciativën e Avniut, në kuadrin e aktiviteteve të këtij klubi u përkujtua përvjetori i parë i fitores të Luftës së Vlorës. Në ceremoninë e zhvi-

1) Gjon Leka e Marko Boçari.

2) KQ Gjirokastrë.

3) Visar Dodoni. «Memoriet e mia». Kostancë, 1932.

4) Omonia, Gjirokastrë, 11.6.1921.

5) Gazeta «Drita». Gjirokastrë, 5 maj 1921.

lluar me atë rast u thirrën përfaqësues dhe nga shoqëritë e tjera, nga «Vëllazëria» e Shkodrës, anëtarët e së cilës dhanë edhe një shfaqje teatrale. Avni Rustemi vajti në Shkodër për të aktivizuar shoqëritë dhe klubet e atjeshme.¹⁾

Njëkohësisht në atë periudhë ai nisi aktivitetin për bashkimin e shoqërive të vendit. Në vitin 1921 Avni Rustemi udhëhoqi lëvizjen për bashkimin e grupeve e shoqërive të ndryshme që vazhdonin në atë kohë në Shqipëri. Këtij qëllimi i shërbyen udhëtimet e ndërmarra nga Avniu në mjaft krahina e qytete të Shqipërisë së Veriut e të Jugut.

1) Gazeta «Drita». Gjirokastër, 5 maj 1921.

KONGRESI I VLORËS

«Në Kongres të marrin pjesë edhe atdhetarë që edhe kur u mungojnë mjetet financiare të vijnë, jo me pushkë, po me shkop në dorë, me trastë në krah, me libër në xhep, të njihen, të afrohen me tradisionet...»¹⁾

AVNI RUSTEMI

Pas fitores në Luftën e Vlorës lëvizja patriotike e masave të gjera popullore mori një hov të ri. Një ndihmë të veçantë në gjallërimin e vazhdueshëm të këtij procesi dhanë edhe shoqëritë e klubet e ndryshme politike-kulturore. Për ngritjen e shoqërive arsimore e kulturore rol të rëndësishëm luajtën intelektualët përparimtarë e demokratët revolucionarë, midis të cilëve edhe Avni Rustemi. Ai që një nga kërkerët kryesorë të luftës për bashkimin e këtyre shoqërive. Nëpërmjet shkrimeve në gazetatat përparimtare «Politika», e «Drita» të Gjirokastrës ai dha mjaft mendime të vlefshme për afrimin e bashkimin e shoqërive rreth një qendre të vetme. Themelimi i shoqërisë «Vatra» në Korçë u prit si një fillim i

1) Gazeta «Drita». Gjirokastrë, 18.2.1921.

mirë për bashkimin e shoqërive; por atë që nuk bëri dot shoqëria korçare, e kreu shoqëria «Drita» e Gjirokastrës, e cila hodhi çapin e parë të bashkimit» dhe «vendosi të tretej me «Vatrën» e me shoqëritë e tjera. Kjo i detyrohet Avni Rustemit. i cili shkoi vetë në Korçë dhe, sipas shtypit demokratik të kohës, shfaqti besimin, se do delte me faqe të bardhë.¹⁾ Pastaj Avniu shkoi në Vlorë. Siç tregon edhe ai vetë «bashkimi i shoqërive nisi nga «Drita» e Gjirokastrës, e cila qysh në shkurtin e vitit 1920 hodhi parullën kundër egoizmit krahinor dhe shfaqti dëshirën e bashkimit»²⁾


Për të siguruar lidhjet e Vlorës me Gjirokastrën e me Korçën, etj, Avniu shkruante «se programi i të gjitha shoqërive do të jetë bashkimi, zgjimi, përparimi, me qëllim kombëtar dhe këto forca kombëtare do të bashkëveprojnë si një makinë e mirë pas nevojave të shekullit XX.³⁾ Për të arritur bashkimin e shoqërive Avniu iu vu punës për organizimin e një kongresi, ku do të përfaqësoheshin gjithë shoqëritë. Avniu mendonte se në kongres ishte mirë «të marrin pjesë me vota konsultative atdhetarë, që edhe kur u mungojnë mjetet financiare të vijnë, jo me pushkë, po me shkop në dorë, me trastë në krah, me libër në xhep, të njihen, të afrohen me tradisionet, të ngjallin lodrat olimpike, për lumturinë dhe lartësinë e racës arbërore».

Avniu bëri një punë të madhe përgatitore për këtë kongres, i cili u mbledh në Vlorë më 25 prill të vitit 1921. Në të morën pjesë përfaqësues nga

1) «Drita». Gjirokastrë, 3.3.1921.

2) Fondi QK Gjirokastrë.

3) «Atdheu». Vlorë, 1921.



Populli i Gjirokastrës pret krahëhapur heroin.



Fan Noli me Avni Rustemin.



Avniu më 1921.

FEDERATA "YATRA"

Shqipëri

846

Korçë, më 22 shkurt 1921

KORÇE - SHQIPËRIE

J. Jeshnicë

C'kështu pasdronë do të shkrytë në Bibliotekë në të cilën
do të mbledhë të gjithë bashkimin me shqerë, e afër
për më shumë edhe se e njota do të paraqitet atje për të
bashkuar këtë ushtrë.

Përmbi këtë pjesë të gjatë, të cilën
do të paraqet dhe d. m. th. se do të bashkohet nga Bibliotekë
shqerë an nga një anëtar, kështu shqerë për të
një nga Honeri e Gjyrosadris edhe një tjetër edhe një nga
që kështu të mund të merret iniciativë dhe
me këto risjellje sepse qytetuar për një

Letër e Avniut për bashkimin e shoqërive.

25 shoqëri të vendit tonë. Në kongres shkuan përfaqësues të shoqërive të popullit nga Bilishti, Berati, Durrësi, Elbasani, Delvina, Fieri, Gjirokastra, Gramshi, Kavaja, Konispoli, Korça, Kruja, Kurveleshi, Libohova, Lushnja, Mallakastra, Peqini, Përmeti, Pogradeci, Saranda, Shkodra, Shijaku, Skrapari, Tepelena, Tirana, Vlora, gjithsej 47 delegatë. Kongresi vendosi të krijohet Federata «Atdheu», si qendër drejtuese e organizuese e aktivitetit të Shoqërisë.

Në mes të një gëzimi të përgjithshëm të delegatëve të Kongresit e mori fjalën Avni Rustemi, i cili theksoi se «sikurse vlonjatët, që ishin vetëm me pesë fishekë në brez» kur e filluan luftën, edhe ai vetë me shokë e filluan «organizimin e një shoqërie të gjërë me forca të pakta». Pastaj foli për të kaluarën e lavdishme të popullit, për heroin tonë kom-luarën e lavdishme të popullit, për heroin tonë kom-luarën e lavdishme të popullit, për prizrenasit, për kosovarët, për Lushnjën, për Vlorën, Dibrën dhe Shkodrën e tregoi se «bashkimi i shoqërive i shembëllente bashkimit të klubeve në kohën e Turqisë, që bëri punë». Duke mos harruar rrezikun nga imperialistët, Avniu shtoi se, «Shqipërisë nuk mund t'i vemë portë e ta thurrim për të shpëtuar nga hajdutët e huaj, që na luftojnë me pushkë». Ai vuri në dukje gjithashtu që armiqtë do të përpiqeshin edhe me mjete të tjera për të skllavëruar Shqipërinë. Ai goditi interesat personale dhe përmbi to vuri e mbrojti ideat e Shqipërisë. «Shkatërrimet e të këqijat të mos harrohen, — tha ai, — por të na bëhen mësim, që të mundemi të bëjmë atdhenë. Njerëzit nuk janë në një mendje, porse ideali do të jetë një: lartësia e atdheut, pakica do t'i bindet shumicës».1)

1) Fjalim i Avniut në Vlorë, prill 1921.

Në Kongres u fol për pavarësinë ekonomike, për forcimin e shoqërive kooperativiste, tregtare, industriale, për kujdesin e përmirësimit të gjendjes së vajtueshme të bujkut dhe për themelimin e një banke bujqësore, probleme për të cilat Avni Rustemi shkroi edhe artikuj në shtypin demokratik të kohës.

Federata «Atdheu» shpalli programin e punës. Organizatori i saj Avni Rustemi kish menduar që krahas veprimtarisë legale, federata të zhvillonte edhe veprimtari politike ilegale kundër reaksionit, për të përmbysur rendin në fuqi. Duke qenë një organizatë e tillë, që drejtohej nga një revolucionar demokrat i paepur, çifligarët me anën e Xhafer Ypit, u përpoqën ta pengonin veprimtarinë e Federatës «Atdheu». Ishte periudha kur, për shkak të dobësisë së forcave përparimtare, u gjallërua esadizmi, i cili filloi të vepronte herë nën rrogos e herë mbi rrogos. Në këtë periudhë në qeverinë e Xhafer Ypit dominonte politika e veprimtaria e A. Zogut. A. Zogu, si përfaqësuesi më i egër i feudalizmit në Shqipëri, me bejlerët rreth e rrotull tij dhe me borgjezinë që po ngrihej, shikonte te populli, që po përgatitej për kryengritje, armikun e vendosur të interesave të tyre, shikonin te Avni Rustemi e shoqëritë patriotike një rrezik të jashtëzakonshëm për ta dhe për dështimin e komplotit që ata kurdisnin.

Për themelimin e Federatës «Atdheu», krahas Avniut, që derdhi tërë fuqitë e shpirtit të vet, punuan edhe shokët e tij më të mirë, mësuesit Jani Minga, Hysni Babameto e Andrea Konomi. Thoma Paçano, doktor Sezai Çomo, drejtori i gazetës «Drita» Veli Hashorva etj.

Federata «Atdheu» u mbështet e u përkrah nga shtresat e gjera të popullit tonë. Kongresi zgjodhi

këshillin e përgjithshëm të Federatës dhe në shenjë respekti Avniun e shpallën kryetar nderi.

Statuti i Federatës përmbante 7 kapituj të ndarë në 42 nene. Në to flitej për organizimin e kuvendeve dhe kongreseve, për detyrat e anëtarëve, fondet, shenjat dhe në fund kishte një vend të veçantë për pikat e ndryshme.

Federata shpalli se do të vepronte për bashkimin kombëtar, duke punuar në radhë të parë nëpërmjet arsimit, me mësues shëtitës, nëpërmjet shkollave të natës, letërsisë, me anë konferencash dhe shtypit. Ajo synonte të ngrinte një muze kombëtar dhe një bibliotekë qendrore. Veç të tjerave Federata do të punonte për përmirësimin e gjendjes së bujkut, për të cilin Avniu kishte shkruar disa herë. Aty u vendos që kongreset të mblihdeshin çdo vit në 25 prill.

Duke çmuar traditat luftarake të popullit tonë, Avniu kërkoi që shoqëria të kishte si stemë zyrtare, një flamur kombëtar; në mes të ishte harta e Shqipërisë me kështjellën e Krujës dhe viti, muaji e dita e themelimit, kurse vula do të përmbante hartën e Shqipërisë, me një libër.¹⁾

Nën drejtimin e Avniut, Federata «Atdheu» përfaqësonte qendrën e përgjithshme, rreth së cilës u bashkuan gjithë shoqëritë e ndryshme patriotike të vendit. Në këtë mënyrë krijimi i Federatës shënonte një hap të mëtejshëm për lëvizjen e përgjithshme demokratike. Ajo nxiti dhe udhëhoqi aktivitete të shumta me karakter antifeudal. Prandaj reaksioni feudo-borgjez u shqetësua dhe filloi presionet kundër elementëve kryesorë të Federatës.

1) Revista «Atdheu». Vlorë, prill 1924.

Qeveria e Tiranës mori masa të menjëhershme. Ajo ndaloi nëpunësit të merrnin pjesë në radhët e Federatës. Ndërpreu ndihmën ekonomike, që ishte vendosur nga Këshilli Kombëtar. Në gusht të vitit 1922, ministri i Brendshëm, feudali ultrareaksionar Ahmet Zogu shpalli mbylljen e degëve kryesore të Federatës «Atdheu». Por Avniu me shokë nuk u tërhoqën nga rruga e tyre. Ata ngritën shoqërinë «Bashkimi», e cila nuk ishte gjë tjetër veç se vazhdimi i Federatës «Atdheu», me një emër tjetër.

LIDHJA E MËSUESVE TË GJIROKASTRËS

Avni Rustemi, deri më vitin 1921 kishte formuar jashtë e brenda atdheut pesë shoqëri e klube, që nga «Burimi» i Zvicrës e gjer te shoqëria «Njeriu i ri» i Përmetit. Pas një aktiviteti të dendur politik e shoqëror për bashkimin e shoqërive, që u kurorëzua me krijimin e Federatës «Atdheu» me qendër në Vlorë, Avniu së bashku me patriotët e tjerë, iu vu punës për organizimin e mësuesve në një lidhje të veçantë. Gazeta «Drita», e cila në atë periudhë u bë propaganduese e flaktë e mendimeve politike dhe pedagogjike të Avni Rustemit, qysh në maj të vitit 1921 në faqet e saj ngriti problemin e shkollave të mbrëmjes për punëtorë e zanatçinj. Vetë Avniu pasi vizitoi burgun e Gjirokastrës filloi të mendonte për ndonjë mësues edhe për të burgosurit. Ai i paraqiti Drejtorisë së Arsimit një kërkesë, me anën e së cilës «shfaqti dëshirën e tyre për të patur një mësues të sosur për këtë mision». ¹⁾

Edhe më parë ishte bërë një propozim për formimin e një lidhjeje të mësuesve. Këtë ide e kishte hedhur Kiço Konomi, në një korrespondencë të dërguar prej tij nga fshati Labovë më 8 gusht 1919.

1) Thoma Papapano. AQSH. Dosja Nr. 2, viti 1921, numri i kutisë 2, dosja 4-9.

thë hollësitë, e cila do të aprovohej prej këshillës së saj. Aty thuhej se këto çështje nuk mund të shpallëshin botërisht, pasi me sa duket statuti i Lidhjes do të ketë patur edhe klauzola të tjera të fshehta. Lidhja mendonte që pasi të zgjeronte veprimtarinë e vet dhe të siguronte një mbështetje ekonomike të mirë «do të blinte një shtypshkronjë nga më të mbaruarat». Kjo shprehte synimin e saj të mëtejshëm, për të qenë e pavarur në drejtim të botimeve, mbasi në Gjirokastër në atë periudhë, një shtypshkronjë ishte private, kurse tjetra ishte në duart e prefekturës, gjë që vështirësonte aktivitetin e Lidhjes së Mësuesve ashtu siç mendonte e si dëshironte ajo. Në Lidhje pranohej anëtar çdo mësuese dhe çdo mësues. Secili anëtar ishte i detyruar t'i bindej pikë për pikë statutit të Shoqërisë e të zbatonte urdhrat dhe programin e saj. Në statut shpallej se dita 17 korrik do të ishte dita e mbledhjes së përgjithshme, ku do të zhvilloheshin edhe zgjedhjet. Lidhja ishte e ndërgjegjshme se, me formimin e saj mësuesit mirrin përsipër një barrë tepër të rëndë. Ata duhet të luanin një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e vendit. Për këtë ata duhet të bëheshin shembull në organizimin e lëvizjes kombëtare. Vetë iniciativa dhe pjesëmarrja e Avni Rustemit ishte një faktor i rëndësishëm për mbarëvajtjen e kësaj organizate. Çdo anëtar shikonte te Avni një revolucionar demokrat të paepur, një mësues politik, që gëzonte simpatinë e inteligjencës, të elementit përparimtar dhe të mbarë popullit.

Nëpërmjet aktivitetit të kësaj Lidhjeje Avni u shtoi një faqe tjetër historisë, veprës së tij. Ai punoi për arsim të përparuar, për shkolla në Shqipëri, për forcimin e lidhjeve të arsimtarëve me njëri-

-tjetrin. Nëpërmjet Lidhjes së Mësuesve ai u përpoq për forcimin e frymës kombëtare të mësuesve. Pranë Avniut, në gji të Lidhjes së Mësuesve punuan Xhafo Poshi, arsimtar i palodhur, i cili kish punuar prej kohe edhe në fushën e teatrit, Urani Rumbo, Kalo Shaplo, të cilët në korrik 1924 u ngritën kundër synimeve të ndonjë elementi, që kërkonte përçarjen e Lidhjes së Mësuesve të Gjirokastrës. Në gjirin e kësaj shoqërie punoi gjithashtu mësuesi Kiço Konomi, i cili edhe pse në kushte të vështira botoi e shkroi një abetare për filloren «duke patur si qëllim — sikurse shkruante ai vetë — t'i sillte vegjëlisë shkollore një dobi dhe t'i shërbente arsimit botor sipas fuqive», sepse «fitimi më i madh për mësuesin, — shtonte ai, — ishte t'i shërbente atdheut me sa të mundej». Mendime të përparuara pedagogjike dha ky anëtar i Lidhjes dhe më vonë. Në vitin 1925 ai shkruante se «qëllimi i shoqërive ishte që të krijohej e ardhmja e njeriut më e mirë, më e lulëzuar, më e ëmbël».1)

Lidhjet e organizuara nga këta mësues patriotë synonin «ta bënin mësuesin burrë që të mos lypë meramet (ndihmë), por të kërkonte të drejtën, kur mbaronte detyrën»2), pra të bëhej një figurë aktive e lëvizjes demokratike, për liri e të drejta shoqërore.

Kjo ishte përgjigjja që i jepnin mësuesit përparimtarë regjimit në fuqi. Dhe kjo ndodhte në një kohë kur fshatrat tona kishin për lokale shkollore kasollet, edhe ato pa dyer, pa dritare, pa banga, ku punonin mësues pa nxënës, sepse në çdo shkollë nuk venin më tepër se 10-15 djem edhe këta pa libra.

1) «Liria». Tiranë, 15.1.1925.

2) Po aty.

Në mesin e marsit të vitit 1924 u bë riorganizimi i Lidhjes së Mësuesve të Gjirokastrës. Midis të tjerave ajo dha një kontribut të madh për ngritjen e mbrojtjen e problemit të frymës kombëtare në Liceun shqiptaro-francez të Gjirokastrës. Kjo shoqëri kërkoi që atje të mësohej historia e Shqipërisë në gjuhën shqipe dhe të regjistroheshin e të vijonin mësimet edhe vajzat, duke e kthyer këtë lice në një shkollë mikse, e para në vendin tonë.

NGA JUGU NË VERI

I lidhur ngushtë me Bajram Currin e patriotë të tjerë të vendit, gjithmonë në lëvizje e aktivitet intensiv Avniu punonte për çështjen e vegjëlisë duke shkuar sa nga një krahinë në tjetrën. Atë gjithnjë e preokuponte gjendja e mjeruar dhe shumë e prapambetur e masave popullore, të cilat shtypeshin nga çifligarët, bajraktarët e klerikët. Pas udhëtimit në disa krahina të Jugut ai shkoi në Shkodër. Atje u takua me pjesëtarët e shoqërisë «Vllaznia», e cila punonte duke u marrë kryesisht me çështje të literaturës, të teatrit, të muzikës, pa kapërcyer kurrë rrethin e Shkodrës¹⁾. Avniu u mundua t'i jepte kësaj shoqërie një karakter më luftarak. Ai synonte që edhe «intelektualët tanë të punonin për lartësimin e kombit tonë». Në atë kohë intelektualët përparimtarë kishin formuar shoqëri në tërë anët e vendit. Avniu ishte i mendimit që veprimtaria e këtyre shoqërive duhej të bashkërendohej. Ai e kuptonte mirë rëndësinë e bashkimit të forcave përparimtare të vendit; prandaj ai u bë iniciator i lëvizjes për bashkimin e gjithë shoqërive rreth një programi e ideali të përbashkët. Në çdo qytet kishte një ose më tepër

1) Fondi A. Rustemi. Telegram shoqërisë «Vllaznia». Shkodër, 15.8.1922.

shoqëri, por programet e tyre nuk ndryshonin shumë nga njëra-tjetra. Avniu ishte i mendimit se «federalizmi i shoqërive do të sillte përparimin, bashkimin dhe forcën»¹). Ishte periudha kur vendin tonë e kërcënonte rreziku i coptimit. Mark Gjon Markaj kishte shpërthyer lëvizjen separatiste feudale kundër Qeverisë qendrore të Tiranës. Në ato momente populli u ngrit sërishmi për t'i dalë zot atdheut. Për këtë qëllim shkoi edhe Avni Rustemi në Shkodër. Ai kërkonte bashkimin e popullit për të përballuar rrezikun e copëtimit. «Kur i del ndonjë gajle Shqipërisë, duhet që gjithë anët të merren vesh vëllazërisht ndër vedi për t'i bërë ballë rrezikut»²) — i shkruante Avniu, Bajram Currit në dhjetor të vitit 1921. Ai shkoi në Shkodër për të dhënë kontributin e tij në shtypjen e lëvizjes reaksionare të Mark Gjon Markajt në Mirditë. Për atë qëllim ai nxitonte të vinte veten sa më shpejt nën komandën e vlefshme të Bajram Currit³). Avniu punoi kundër reaksionit të brendshëm e armiqve të jashtëm. Ai u përpoq ta forconte më tej bashkimin e masave popullore kundër armiqve, — që po ndiqnin rrugën e esadistëve, u ngrit kundër kryengritjeve që sillnin anarkinë, luftoi kundër propagandës së huaj, e cila nxiste vëllavrasjen dhe kërkonte që «hidhërimet e gëzimet, masat popullore t'i kalonin bashkarisht»³). Për veprimet e tij në Shkodër na flet bashkëpunëtori i tij

1) Revista «Atdheu». Fjala e Avni Rustemit në Kongres, — prill 1921.

2) AQSH. Dosja Nr. 8. Letër B. Currit, dhjetor 1921.

3) AQSH. Fondi A. Rustemi. Datë 29.11.1921. Dosja nr. 32, datë 25.3.1921.

4) Po aty.

Sezai Çomo, i cili tregon se bashkë me Bajram Currin dhe me Avniun shkuan në Malësi të Shkodrës, në Pukë, në Mirditë e luftuan kundër lëvizjes së përgatitur nga shovinistët fqinjë. Para se të shkonte në Shkodër, në tetor të vitit 1921, grupi parlamentar «Bashkimi i shenjtë» e ngarkoi Avni Rustemin e Bajram Currin si anëtar të një komisioni që do të formonte qeverinë e re¹⁾. Pasi kreu këtë detyrë, ai u nis për në Shkodër e prej andej në Mirditë, në rreshtat e trupave të komanduara nga trimi Bajram Curri.

Gjatë qëndrimit në Shkodër Avniu, në një konferencë të organizuar me djalërinë shkodrane foli për misionin që duhet të kryente rinia ndaj atdheut. Për këtë ai propozoi të formohej një batalion i shenjtë prej inteligjencës së gjithë Shqipërisë, me qëllim që të dilte nëpër male dhe të vepronte për të mirën e mbrojtjen e Atdheut.²⁾ Ai foli për Mirditën, për popullsinë trime të atyre maleve me famë³⁾, që edhe pa bukë kishte bërë luftë heroike në shekuj. Avniu qëndroi aty në shumë familje. Për këtë aktivitet flasin shokët e tij Sezai Çomo e të tjerë, të cilët shkruajnë se ai «vrulloi në Mirditë» dhe se e panë me armë në dorë që ish nisur për këtu⁴⁾. Për 12 muaj u orvat me sa mundi në gjithë anët e vendit për t'i sjellë dobi të tiera Atdheut⁵⁾. Kur pa se «jeta kombëtare po përshkohej nëpër një rrezik», ai nuk mungoi të luftonte atje ku rreziku ishte më i

1) S. Çomo. Fondi i Muzeut të Gjirokastrës.

2) «Agimi». Shkodër, nëntor 1921, nr. 7.

3) Po aty.

4) «Shpresa e Atdheut» Fruer 1922.

5) Po aty.

madh. Prej shkurtit 1921 e gjer në shkurt 1922, Avniu veproi në Shqipëri. Pas kësaj date u kthye në Romë, për të vazhduar studimet në pedagogji.¹⁾

Avniu u largua për të përfunduar studimet e lëna për gjysmë vetëm atëherë kur Marka Gjoni, me forcat e tij ishte shpartalluar dhe ishte hedhur në Jugosllavi. Vendimi i Konferencës së ambasadorëve i 9 nëntorit 1921, pranimi nga qeveria jugosllave, që ajo t'i tërhiqte trupat në vijën e demarkacionit, si dhe njohja e qeverisë shqiptare nga një varg shtetesh, i forcuan deri diku pozitën e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.²⁾

Avniu, ashtu si e kishin këshilluar patriotët tanë Mihal Grameno e Luigj Gurakuqi, iu vu përsëri punës së studimeve, të cilat i kish lënë përgjysmë. Luigj Gurakuqi e Stavro Vinjau e ngritën këtë çështje edhe në parlament. Ata nuk pranuan që Avniut t'i jepej një pension i përjetshëm³⁾, sepse «heroizmin e therorinë e Avni Rustemit» — sikurse deklaronte Luigj Gurakuqi — «nuk ka të holla që mund t'ia shpërblejnë». L. Gurakuqi kërkoi që «Avniut t'i sigurohej jeta dhe ai të kryente e të plotësonte mësimet, që të bëhej i vlefshëm për kombin.»⁴⁾ I këtij mendimi ishte edhe deputeti tjetër Stavro Vinjau, i cili kërkoi që «Avniu duhej të kryente studimet dhe të mos i akordohej pension i përjetshëm». Pikëpamja e tyre shprehte konsideratën e lartë që kishin ata e populli shqiptar për veprën e Avniut dhe besimin në forcat e këtij patrioti për të ardhmen e

1) «Afrimi». Maj 1924, nr. 5.

2) Histori e Shqipërisë, f. 582, botim i parë.

3) Bisedimet e Kuvendit Kushtetues. Tiranë 1921.

4) Bisedimet e Kuvendit Kushtetues. Tiranë 1924.

vendit. Duke kuptuar drejt rolin që do të luante Avniu pas kësaj në fatet e atdheut, ata kërkuan që atij t'i jepej ndihmë që të kryente studimet jo si qëllim në vetvete, por në funksion të detyrës e të kontributit të madh që do të jipte ai në interes të atdheut.

Pas këtij debati, Avniut iu akordua një pension, sa për të vijuar studimet, me 39 vota pro e 15 kundra. Debati në parlament nxori edhe një herë në shesh sesi çifligarët e borgjezët u munduan që Avni Rustemit të mos i jepej mundësia për të vijuar studimet e larta. Këtë fakt e kujton me përbuzje edhe mëma e Avniut, Laleja, e cila në një letër të saj shkruante se «votat e aristokratëve ishin kundër Avniut edhe në këtë çështje».1)

1) QK Gjrokastër.

ORGANIZATA «BASHKIMI»

Forcimi i pozitive të reaksionit çifligar pas dëshimit të lëvizjes së marsit 1922 u shoqërua me shpërthimin e një vale të gjithanshme terrori, në qendër të të cilit u vu kufizimi dhe asgjësimi i lëvizjes përparimtare demokratike. Si pasojë e kësaj reaksioni nisi të bëjë presion duke dashur të shtypë veprimtarinë e Federatës «Atdheu». Më në fund me masat policore që mori Ahmet Zogu arriti ta mbyllte Federatën «Atdheu».

Pas mbylljes së Federatës «Atdheu», duke patur si synim krijimin e një fronti masiv politik antifeudal, Avniu punoi me ngulm për krijimin e një organizate të re demokratike. Në 13 tetor 1922, i ndihmuar nga elementë të tjerë përparimtarë, ai themeloi shoqërinë «Bashkimi», që u bë një forcë e madhe lëvizëse në lëvizjen progresive revolucionare antifeudale. Sapo krijoi shoqërinë «Bashkimi» në Tiranë, Avni Rustemi u nis për zgjerimin e radhëve të saj në tërë anët e vendit. Në nëntor 1922 ai shkoi në Vlorë për krijimin e degëve të «Bashkimit». Autoritetet e prefekturës bënë gjithçka për ta penguar, por ai, duke gjetur përkrahjen e masave të gjera popullore e demokratike arriti ta krijojë këtë degë. Këmbëngulja e tij dhe përkrahja e popullit i detyroi qeveritarët të lejonin hapjen e degës së «Bashkimit»

në Vlorë. Ja si i shkruante qeverisë prefekti i Vlorës më 25 nëntor 1922: «Mbas Rustemi na drejtohej pa reshtur për çështjen e klubit dhe ndalimi (pengimi) pamë që do të shkaktonte një përshtypje jo të favorshme për qeverinë, i thamë që janë të lirë ta hapin, Mbas kësaj çeljeje filloi të regjistrojë anëtarë¹⁾. Pas kësaj, ai vazhdoi punën për krijimin e degës së Durrësit.

Organizata demokratike «Bashkimi» mblodhi në gjirin e vet të gjithë patriotët demokratë, fshatarë, të rinj patriotë, inteligjencien përparimtare. Ajo synonte të bënte reforma demokratike në interes të popullit dhe prandaj gjeti mbështetjen e përkrahjen e masave të gjera fshatare, të punëtorëve, e të patriotëve shqiptarë. Shoqëria «Bashkimi» ashtu sikurse Federata «Atdheu» synonte të punonte për forcimin e unitetit kombëtar. Ajo luftonte për zhvillimin e përhapjen e arsimit, për hapjen e shkollave të ditës e të natës. Njëkohësisht synonte të zhvillonte muzikën, teatrin, letërsinë. Në programin e shpallur më 13 tetor 1922 ajo deklaronte se do të përpiqej për përmirësimin e kushteve të bujkut. Avniu, me anën e veprimtarisë së «Bashkimit», edukonte djalinë me ndjenjat e urrejtjes për bejlerët. Ai e bëri atë një shkollë për edukimin e anëtarëve të saj dhe bërthamë drejtuese të lëvizjes përparimtare demokratike. Nëpërmjet degëve të «Bashkimit» në qytete të ndryshme të vendit ai edukonte elementët përparimtarë për luftë kundër feudalizmit, ruante rradhët e tyre, informonte qendrën për veprimet e reaksionit feudal, luftonte kundër esadizmit, Organi-

1) AQSH i RPSSH. Fondi i Kryeministrisë, dosja I — 403, dokumenti 256, dt. 25.11.1922.

zata ishte një shoqëri e ndërtuar mbi parime të qarta organizative. Qendra drejtonte e udhëhiqte punën e degëve që ndodheshin nëpër rrethe. Degët i bindeshin urdhrave të qendrës.

Si kryetar i Shoqërisë «Bashkimi», Avniu frymëzonte shokët në luftën për demokratizimin e jetës shoqërore të vendit, për çlirimin e gruas, që ishte një problem i mprehtë shoqëror.

Organizata «Bashkimi» i kushtonte rëndësi të madhe ruajtjes jo vetëm të pavarësisë politike, por edhe ekonomike të Shqipërisë. Ajo luftoi kundër depërtimit të kapitalit të huaj, për mbrojtjen e pavarësisë së vendit si dhe për forcimin ekonomik. Avniu synonte të zgjeronte më tej bazën shoqërore të organizatës, duke i shtrirë degët e organizatës edhe në fshat. Ai u përpoq që aktiviteti i shoqërisë të ishte edhe në dobi të fshatarësisë. Kjo i shërbente forcimit të pozitave të saj. Aktiviteti i organizatës «Bashkimi» u intensifikua në pranverë të vitit 1924 dhe sidomos në periudhën e fitores së Revolucionit demokratiko-borgjez të Qershorit 1924, kur krijoi degë thujse në tërë anët e vendit. Në korrik 1924 ajo nxori edhe gazetën «Bashkimi», organ në të cilin propagandonte e përhapte idetë e saj demokratike antifeudale. Ajo mbrojti arsimin laik dhe kombëtar, kritikoi gazetën «Ora e Maleve» që kërkonte shkollë të ndarë, të veçuar, kundër shkollës së përbashkët, shkollës kombëtare. Organizata «Bashkimi» ishte për zhvillimin demokratik të kulturës shqiptare, për shkëputjen e shkollës nga kisha dhe xhamia, nga klerikët, për t'i dhënë arsimit karakter shkencor, etj. Sikurse Federata «Atdheu», e cila në programin e saj parashikonte një veprimtari të fshehtë politike, për të përmbysur, në rast nevoje,

edhe rendin në fuqi, edhe shoqëria «Bashkimi», statuti i të cilës ishte afërsisht i njëjlojtë me atë të «Atdheut», për të evituar ndjekjet e reaksionit, shpalli se nuk do të përdorte dhunën në fushën politike.

Avniu edhe kur u largua për studime, jashtë atdheut, qëndronte gjithnjë afër «Bashkimit». Në një letër drejtuar degës së «Bashkimit» në Tiranë me rastin e zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese, ai shkruante se nenin 12 të statutit, do ta formulojë vetë e vazhdonte: letrat tona ua këndon ju lutem gjithë anëtarëve. U vini veshin urdhrave, që merrni nga komisioni i përgjithshëm me anën e gazetës «Politika»¹).

Letrat e dërguara shoqërisë për së largu tregojnë shqetësimin e përhershëm të Avniut për mbarëvajtjen e organizatës. Ai porosiste që anëtarët e «Bashkimit» të shkonin «gjithmonë përpara me dëshirë, të kishin trupin të shëndoshë, të punonin dhe të studionin me rregull»²).

Avniu mbështeste pikëpamjen për ngritjen e një muzeu. Ai rekomandonte të zbatoheshin kërkesat e paraqitura nga ai në gazetën «Politika», duke treguar se është gjithmonë pa egoizëm³). Ai i këshillonte gjithashtu të rinjtë të punonin pa frikë, të bëheshin shembull në punërat e tyre dhe të kombit⁴). Avniu duke iu drejtuar të rinjve shkruante se shokët e tij të dashur, anëtarët e «Bashkimit» duhet të

1) A.Q.S.H. Letër Salih Hoxhës, dosja nr. 8.

2) Fondi Muzeut Historik, Gjirokastër. Letër e datës 24. vjeshtë e II-të 1923, nr. 39.

3) Po aty.

4) Gazeta «Politika». Vlorë, 4.10.1923.

ishin optimistë, të mos dëgjonin ata që flisnin e vepronin kundra shoqërive¹). Dhe në këtë drejtim ai dha vetë shembullin e luftëtarit të vendosur për çështjen e triumfit të lëvizjes demokratike, antif feudale e antiimperialiste.

Kërkesave të përsëritura të Avni Rustemit pranë Komiserisë së Policisë të Tiranës, me anën e të cilave ai u kërkonte leje për të lejuar shoqërinë «Bashkimi» të bënte mbledhje në Shkollën e Pazarit, Komiseria iu përgjigj negativisht. Avniu, i cili nuk hoqi dorë nga përpjekjet për forcimin e mëtejshëm të shoqërisë «Bashkimi», kur mori vesh përgjigjen e Komiserisë deklaroi me vendosmëri: «Policia le të bëjë ç'të dojë, ai me shokët e tij do të mbledhet, sepse qëllimi i asaj Shoqërie nuk është për gjë tjetër veçse për dobinë e popullit shqiptar».²)

Degët e «Bashkimit» nëpër rrethe, ishin të lidhura me qendrën dhe punonin pa ndërprerje. Ato kërkonin që anëtarët e «Bashkimit» të ishin vigjilentë kudo, të njoftonin për veprimtarinë armiqësore të zogistëve të arratisur në Korfus e gjetkë, dhe të tregoheshin njëkohësisht vigjilentë, ashtu si punonte dega e Vlorës kundër bejlerëve, që «vrisnin e digjin».³)

Shoqëria «Bashkimi» ishte organizatë politike, e cila pas qershorit 1924 u vu në krye të luftës për thellimin e karakterit të Revolucionit të Qershorit dhe u bë bërthama rreth të cilës u përqëndruan e vepruan elementët më radikalë që ishin në krye të lëvizjes demokratike, antif feudale dhe antiimperia-

1) Fondi QK Gjirokastrë, Letër nga Vlora, 19.9.1924.

2) AQSH, Fondi Avni Rustemi, Dosja 4. Dok. pa numër.

3) Fondi QK Gjirokastrë. Letër nga Vlora, 19.9.1924.

liste. Kështu «Bashkimi» punoi për të zgjidhur detyrat demokratike kundër mbeturinave të feudalizmit. Ajo ishte ndër të parat organizata që tregoi rrezikun që i vinte atdheut e revolucionit nga klikat çifligare, të arratisura jashtë atdheut, pas triumfit të revolucionit të qershorit 1924. Kongresi i jashtëzakonshëm i «Bashkimit», që u mbledh në nëntor 1924 u ngrit kundër partive të vetëquajtura nacional-radikale e radikal-demokrate, duke treguar se ato i kishin tradhtuar idealet antifeudale të Revolucionit të Qershorit, se kishin lidhur marrëveshje me «dyert e mëdha», të vendit në atë periudhë, duke u kthyer më vonë në parti, që favorizuan feudalizmin.¹⁾

Shoqëria «Bashkimi» e krijuar nga Avni Rustemi, pas vdekjes së tij, në shenjë nderimi e respekti për veprën e kryer nga ai kundër reaksionit çifligar; e shpalli Avniun kryetar nderi të përhershëm të saj. Organizata «Bashkimi» dha një kontribut të shquar për mobilizimin, organizimin e drejtimin e vegjëlisë shqiptare në luftë për zbatimin e programit të Qeverisë demokratike të Nolit, e për mbrojtjen e fitoreve të Revolucionit të Qershorit. Ajo e shtriu aktivitetin në tërë qytetet e Shqipërisë, krijoi mbi 40 degë, disa prej të cilave edhe jashtë vendit. Kështu u zgjerua baza shoqërore e saj dhe u krijua mundësia që ajo të shtrinte ndikimin në tërë krahinat e vendit.

Degët e shoqërisë «Bashkimi» udhëhoqën lëvizjen demokratike dhe u bënë luftëtarët e parë të barrikadave për zhdukjen e klikave çifligare. Nën udhëheqjen e tyre në Berat, Fier, Vlorë, Peqin etj.

1) Histori e Shqipërisë. Botim i parë. Tiranë 1965. Vëll. 2, f. 532.

masat popullore u ngritën në mitingje kundër çifligarëve dhe nuk pranuan të paguanin më detyrimet çifligare e shtetërore. «Bashkimi» i krijuar nga Avniu tërhoqi simpatinë e masave nga njera anë dhe urrejtjen e çifligarëve e të reaksionit nga ana tjetër. Për këtë arsye reaksioni zogollian kishte vendosur mbylljen e shoqërisë «Bashkimi», jeta e vepra e të cilës i shton një faqe tjetër lavdie historisë së lëvizjes antifeudale.

PIKËPAMJET POLITIKE E SHOQËRORE TË AVNIUT

«Qysh kur ishte nxënës në bangot e shkollës, ai mendonte për fatet e popullit, por qysh kur ish në këto bango mendonte të mësonte sa më shumë dhe sa më mirë, me qëllim që diturinë e fituar ta vinte në shërbim të popullit, siç e vuri»¹⁾

Avni Rustemi e çmonte shumë arsimin e kulturën. Prandaj gjithnjë përpiquej të mësonte. Për këtë qëllim ai studionte pareshtur në shkollë dhe jashtë saj.

Ky djalosh symprehtë ishte një nxënës e student me përfundime të shkëlqyera. Ai kishte një vullnet të jashtëzakonshëm. Të tillë e përshkruajnë atë pedagogët e tij si L. Gurakuqi, ose shokët e tij të klasës.

Ky djalë bujku, i cili si student ngrinte e vinte në trup një pelerinë, nuk u ndahej librave dhe studimit. Miqtë e tij më të mirë ishin liberalët. Etjen e tij për studime e për dije e çmonte shumë Mihal

1) Enver Hoxha. Fjalim në Libohovë. «Zëri i popullit», 29 maj 1969.

Gramenua, i cili ngulte këmbë që Avniu pas 1920-ës të vijonte mësimet e larta, që «të ishte e mundur një ditë t'i shërbente Shqipërisë me diturinë e tija.»¹⁾

Avni Rustemi vazhdoi studimet. Edhe pse jetonte në rrethana të vështira ai nuk iu nda librave. Shokët që jetuan me të shkruajnë se «nuk mund t'i plotësonte mësimet i mjeri Avni, meqenëse i mungojshin mjetet parimtare (dmth të hollat L.D.)²⁾ Megjithatë, me ndihmën e tyre ai ia doli mbanë.

Avniu ushqente respekt e dashuri të thellë për kulturën kombëtare. Edhe kur ishte student në Shën Mitër Korone, ai kërkoi që katedra e gjuhës shqipe të mos mbetej vakante. Ai iu ankua vazhdimisht drejtorisë së kolegjit për mungesën e mësimit të shqipes.³⁾ Studenti Avni Rustemi, edhe pse i mbiqyrrur nga policia italiane, gëzonte një simpati të veçantë tek pedagogët. Ata qëndronin gjithnjë me të dhe përherë patën bashkëbiseda.⁴⁾ Shokë të klasës tregojnë se karakteri i Avniut nuk mund të përshkruhet nga çdo pendë, me lehtësi. «Në të — shkruan një shok i tij — vërehej diçka e jashtëzakonshme. Në të ishte zhvilluar zhenia e së mirës, në një mënyrë të jashtëzakonshme, që e kishte pajisur me virtytet më të mira e më të larta.»⁵⁾

Ky djalosh me buzëqeshje të ëmbël, që i pëlqenin shakatë e shokëve, u shqua jo vetëm për dashurinë e madhe për studimet, por edhe për ndjenjat e

1) «Koha». Korçë, 8 janar 1921.

2) «Afrimi» nr. 5, viti 1924, f. 67.

3) Beqir Sinani. «Revista pedagogjike» 1974, nr. 2 f. 146.

4) Fondi QK Gjirokastër.

5) Q.K. Gjirokastër.

zjarra e mallin e madh për atdheun. Megjithëse me një bursë mujore prej 140 liretash italiane të akorduara nga Ministria e Arsimit shqiptar¹⁾ se nga familja e tij «nuk merrte as pako, as mandatposte», Avni Rustemi vazhdonte të studionte e të kursente nga goja për të blerë librat e revistat që i duheshin.

Kur ishte në kolegji, Avniu përktheu disa pjesë nga Shekspiri. Sikurse tregon një shok i tij, përkthimi ishte punuar mjaft mirë. Avniu bëri përkthime edhe nga Viktor Hygoi. Nga disa fragmente, që kishin ruajtur gjer vonë shokët e tij, bie në sy prirja e veçantë që kishte ai për të zgjedhur pjesë me vlerë nga letërsia botërore.

Vullneti i tij i hekurt e bëri Avni Rustemin të mësonte disa gjuhë. Shpeshherë ai thoshte se «edhe sikur të na mungojnë të tjera, s'është gjë e madhe, se jemi të fortë nga qëllimi». ²⁾ Tërë jetën e tij të shkurtër e karakterizoi studimi. Këtë gjë ai e kërkonte edhe nga shokët e bashkëpunëtorët e vet. Edhe kur ishte larg atdheut, ai i këshillonte shokët e «Bashkimit» në Tiranë që «të kishin trupin e shëndoshë, të punonin dhe të studionin me rregull³⁾, për t'u bërë bij të denjë e të devotshëm të çështjes së popullit e të atdheut.

Këtë frymë kultivoi ai edhe te shokët më të ngushtë. Atje në pyllin e gështenjave afër kolegjit të Shën Mitër Koronës e gjenin shpesh shokët e tij, Avniun, me revista e libra, që nuk iu ndanë kurrë nga dora. Atje bisedonte me studentët revolucionarë si me Ramis Varvaricën, Duro Dinon, me priftin e çkishëruar nga Vatikani Cico Marinin etj., të cilëve

1) AQSH, Dokumenti nr. 428/XVIII. Tiranë, 24.6.1920.

2) Informacion gojor nga prof. Kostaq Cipo.

3) AQSH. Dok Nr. 39, datë 31.10.1923.

u fliste për leximet e studimet e ditës. Atje u fliste shpesh edhe katundarëve, duke u kënaqur me bujarinë, gjuhën, kostumet e arbëreshëve, por njëkohësisht dëshpërohej kur shikonte gjithatë prapambe-tje ndër ato vende të varfëra e të braktisura.¹⁾

Për ata katundarë arbëreshë, të cilëve u fliste për ngjarjet e ditës, do ta mirrte malli më vonë. Ai thoshte se «me ikjen nga ai vend, vetëm për ata do të na marrë malli, pse njeri tjetrin do të kemi rast ta shohim së paku një herë në mot».

Ish pedagogu i tij në Normalen e Elbasanit, Sotir Peci që më 1920 ishte ministër për punët e arsimit, e cilësoi Avniun «të çmueshëm»²⁾. Duke prekur problemin e «gjendjes tepër të vështirë të studentëve shqiptarë në Itali», ai vlerësonte punën e tyre, «midis të cilëve dallohej Avni Rustemi». Ai shtonte se «qeveria duhet t'i ndihmonte ata, prej të cilëve atdheu pret dikur shërbime të mëdha».³⁾

Shumë me frut do të ishte studimi i korrespondencës së Avniut, nëpërmjet së cilës do të gjenim më konkretisht mendimet e studentit. Epistolari do të na tregonte mendimet e atij organizatori të talentuar të djalërisë, i cili luftoi e punoi qysh në moshë të re, për të mbledhur, në shoqëri të ndryshme, edhe «të rinjtë shqiptarë që kishin mbushur të pesëmbëdhjetë vjetët».⁴⁾ Shokët e tij tregojnë se Avniu i udhëzonte ata të studionin rregullisht. Ai u shkruante në mënyrë lakonike për studimin e tij të përmuajshëm

1) Q.K. Gjirokastër.

2) AQSH. Dokumenti nr. 463/XVIII, datë 3.7.1920.

3) AQSH. Dokumenti nr. 381/XVIII, datë 8.6.1920.

4) «Kuvendi», Romë, 23 prill 1919.

e për ato që kishte lexuar në gjuhën amtare, ose në gjuhë të huaja.

Një tipar tjetër i këtij studionjësi të palodhur ishte kujtesa e jashtëzakonshme. Shokët e tij të shkollës mesme, ose në fakultetin e pedagogjisë tregojnë se ai kishte mësuar përmendsh faqe të tëra në vargje dhe në prozë, vargje të rapsodëve popullorë, veçanërisht këngët historike. Ato i studioi me endje që nga mosha më e re, gjer në fund të jetës së vet.

Mendimin politik përparimtar të Avniut e gjej-më të pasqyruar në shtyp, në gazeta e revista të kohës. Duke bashkëpunuar me gazetatat përparimtare të Tiranës ose gazetatat «Politika» dhe «Fjala e lirë» të Vlorës, Avniu në artikujt e tij preku çështjet e fuqizimit politik, ekonomik e kulturor e shoqëror të vendit. Lidhur me problemin ekonomik, Avniu shkruante: «Nuk u mjaftuaka, duhet, liria. Shqipërisë nuk i mjaftoi të luftojë e të fitojë mëvehtësinë. Nuk u mbarua lufta. Jeta është një luftë... Bëmë kaq luftra, fituam. Po na hëngri lufta ekonomike...» Më tutje ai vazhdon: «hajdutët, (ka patur parasysht vendet kapitaliste) që na vinin njëherë me pushkë, sot do vinë të na luftojnë me mendim, me sistem e si të shkatërruar që jemi do të na mundin. Prandaj të forcohem...»¹⁾ Në shkrimet e tij, ndonëse të rralla, ai preku problemet e konsolidimit politik, të zhvillimit ekonomik, të forcimit të pavarësisë e mbrojtjes të pavarësisë së vendit.

Avniu duke kërkuar pavarësinë ekonomike shkruante se nuk duhej lejuar formimi i bankës me kapital të huaj.²⁾ Ai e kishte të qartë që nënshtrimi

1) «Fjala e lirë». Vlorë, 30.4.1921.

2) «Politika». Vlorë, 25.10.1923

ekonomik do të çonte në skllavërimin politik sepse këto «në një greminë na shpien» thoshte ai. Prandaj kërkonte që zhvillimi i vendit të mbështetej në shfrytëzimin e burimeve të brendshme dhe formimi i Bankës Kombëtare të arrihej me të ardhurat e vendit «pa pasur nevojë të trokëllitimit në dyert e botës».

Avni Haxhemiri mbante «...» mbështetjes të fuqia ekonomike e vendit. Ai shprehte se «të gjitha mjetet e rrojtjes janë në Arbëri, por se këto duhen përdorur». Ai kritikoi elementët kapitullantë që prisnin zhvillimin e ekonomisë nëpërmjet lidhjeve me fuqitë e jashtme. Avniu vinte në dukje se dita-ditës vendi po binte ekonomikisht. Ai demaskonte ata që shpresonin me duarlidhur tek dhënia e konçesioneve të huaja²⁾, dhe kërkonte që pasuritë e vendit të vireshin në dispozicion të atdheut.

Avniu shfaqti mendimet më të përparuara e nga më radikalet për kohën e vet, duke u bërë kështu një ndër udhëheqësit më të shquar të luftës për demokratizimin e jetës së vendit.

Gjendja e rëndë ekonomike e vendit e bëri Avniun të kërkojë formimin e disa «kasave të kursimit», për të mos e lënë punëtorin «të grabitej me ozure (fajde), të panomta (të paligjshme) dhe me mënyra të tjera». Ai ishte i mendimit «se do qytetari, do katundari s'ka marrë vesh nga gjendja e një shpirti kolektiv, veçse atëherë kur i kërkojnë pagesa e sakrifica të tjera e kur ndodhet ngushtë nuk i thotë kush: ç'ke? Pse psherëtinë? Më ke mua, ke Shqipërinë». Avniu kërkon që shoqëritë «Bashkimi»,

1) «Dajti» nr. 24, datë 11.V.1924.

2) «Politika», 25.10.1924.

«Lidhja e mësuesve», «Brezi i ri», «Djelmëria di-brane» duhet të përkrahin iniciativën për formimin e një banke nacionale». Ai shkruante se «nje-rëzit e shtetit shqiptar nuk kanë kohë të men-dojnë gjendjen ekonomike të Shqipërisë», sepse ata
~~si kështu Avniu ikin qeveritarë si ata të perando-
rës osmane, që shikonin vetëm e vetëm interesat
të shtetit të tyre të ngushtë. Një pjesë e shqiptarëve
të tjerë të ngushtë, nëse poqëndrohen dhe shprehin
popujt. Ai mbronte pikëpamjen e zhvillimit ekono-
mik të pavarur të vendit si kusht për sigurimin e
pavarësisë politike.~~

Avniu shënonte se «si ka qënë pra detyrë pa-
triotike veprimi për të shpëtuar politikisht nga ro-
bëria e të huajve, gjithë ajo detyrë na shtyn të mos
hymë në ndonjë zgjedhë ekonomike; që të dyja këto
zgjedha politike, ekonomike në një greminë na shpi-
en». Avni Rustemi, duke kuptuar qëllimet e kapita-
listëve të huaj, bënte thirrje për vigjilencë, ndaj
porosiste: «vendi ynë të ketë gjithmonë sytë çelët,
sepse jemi të paditur dhe të paorganizuar e do na
përpinë uiaërit e qytetëruar!»¹⁾

Në shkrimet e tij Avniu është ngritur disa herë
kundër imperialistëve ose «kombeve ujçër», sikurse
i quante ai.²⁾ Dhe me këtë kishte parasysh imperia-
listët. Avniu u ngrit kundër mbeturinave të peran-
dorisë osmane në Shqipëri e u shpreh për zhdukjen
e tyre. Ai shihte me dëshpërim gjendjen e krijuar
në Shqipëri nën sundimin e bejlerëve. Duke kri-
tikuar paaftësinë dhe mungesën e interesimit të tyre
për përparimin e vendit, do shprehej kështu në një
shkrim të tij: «Ç'mbarësi pritet nga i shkatërruari?»

1) Gazeta «Dajti». Tiranë, 11 prill 1924.

2) «Politika». Vlorë, 25 tetor 1923.

Ai demaskonte tendencat anarkiste e luftonte për bashkimin e unitetin. Avniu shkruante: «Jemi gjoja dhe të shkollës dhe nuk dimë ç'është puna me rregull e me sistem. Nuk duhet të dalë zë nga çdo kokë, po nga një organizmë politike dhe shoqërore: duhet të ndreqim këtë të metë, që na ka prurë në një të tillë gjendje».1)

Veç kësaj ai ngulte këmbë se krahas luftës për mbrojtjen e vendit ishte koha kur duheshin shtuar përpjekjet për zhvillimin ekonomik, kulturor, shoqëror arsimor të vendit.

Avniu i shfaqte hapur e me guxim mendimet e tij. Ai theksonte se në atë periudhë po i shërbehej ambicies, natës dhe errësirës, se vendi ynë ishte larg akoma nga dituria, kultura dhe drita,2) kërkonte që financa e shtetit të ishte mjet për t'i çelur shkolla popullit dhe për t'i gjetur punë, sepse populli hiqte e vuante nga uria»3). Një nga forcat e mëdha shoqërore, së cilës i binte barra e madhe e zhvillimit të vendit ai shihte djalërinë, rininë. Prandaj punoi me ngulm për organizimin e saj. Avniu ishte i mendimit se rinia duhej «të kishte programe të kthjellta dhe të ndritshme, për t'i shtuar prestigjin jetës shoqërore, për të rrëzuar rëndësinë e intrigës dhe vleftën e metodave të natës dhe të errësirës». Avniu, në shkrimet e tij, u ngrit kundër sistemit politik të kohës, duke e quajtur qeverinë «një qeveri tagrambledhëse». Ai kërkonte me ngulm të

1) «Dajti». 11 mars 1924.

2) «Dajti». 4 mars 1925.

3) Po aty.

mos lihej shqiptari t'i verdhej fytyra nga pa buka.¹⁾ Avni Rustemi që ishte vetë shembull pune e vetmohimi në jetën e tij, kërkonte që secili të jepte «shembull të shkëlqyer në shesh të punës me ballë hapët e me dashuri». Ai kërkonte që «secili të ishte shembull në punët vetiake dhe në punët e kombit».²⁾

Avniu ishte një politikan trim dhe kërkonte që edhe të tjerët të shfaqnin ballë hapur të metat.³⁾ Ai theksonte që dashuria për atdheun duhej të ishte pa kondita⁴⁾. Gjithashtu ai nuk la rast pa shkruar për bashkimin dhe vëllazërimin e popullit tonë. Kur uronte qytetin e tij të lindjes, Libohovën për kufitë e vitit 1913, shkruante se «zoti i Shqipërisë të shtojë kurdoherë më tepër bashkimin dhe vëllazërimin»⁵⁾. Ndërsa për besimet në Shqipëri ai shpalli se i besonte «një perëndie tjetër që kishte Shqipëria, — popullit të saj të pavdekshëm e të përjetshëm, që ka ditur ta ruajë e ta mbrojë». Ai kishte besim të madh te populli dhe këtë e kërkonte edhe tek të tjerët, kur rekomandonte që t'i besohej kësaj perëndie, e cila ka bërë që «Shqipëria të mos vdesë, të mos shuhet, të mos zhduket nga faqja e dheut dhe të rrojë përgjithmonë».⁶⁾

Ai dinte t'i çmonte drejt traditat më të mira të popullit, kur kërkonte «nga trimëresha dibrane trashëgimin e Moisi Golemit»⁷⁾. Njëkohësisht ai kër-

1) «Politika», Vlorë, 25 tetor 1923.

2) Po aty.

3) «Politika», 4 tetor 1923.

4) «Politika», 6 shtator 1923.

5) AQSH. Fondi A. Rustemi, dosja nr. 30.

6) Reshat Këlliçi. Me djemtë e «Bashkimit», Tiranë.

7) Letër për Bajram Currin nga A. Rustemi. Vlorë,

konte të nderohej Naim Frashëri, Jani Vretua e të themeloheshin shoqëri me emrin e tyre. Bajram Currin, Avniu e cilësonte «shembull të patriotizmit për patriotët e soçëm». ¹⁾ Avniu goditi zakonet prapanike, sidomos hakmarrjen, të cilën e cilësonte si zakon barbar. Ai ishte i mendimit se «shumicërisht përparimi ndër intelektualët është formal», se «nuk mjafton që ata vetëm të heqin festen e kuqe dhe të veshin qelshen, por të luftojnë me këmbëngulje për përparimin e vendit.» Avniu në shkrimet e tij vuri në dukje politikën antipopullore të regjimit në fuqi. Ai theksonte se shteti po shtypte masat popullore dhe se klikat drejtuese çifligaro-borgjeze nuk interesoheshin për pakësimin e taksave. «Shteti nuk është vetëm për të marrë taksë e ushtarë shkruante ai, se (shteti red.) ka përgjegjësi, kur popullit i verdhët fytyra nga mungesa e bukës dhe se detyra e shtetit është të zhdukë mjerimin e popullatës».

Ai këshillonte që shteti duhej të punojë si një makinë e re, sipas nevojave të shekullit të XX, e se duhej të synonte në përmirësimin e kushteve të jetës së popullit të mjeruar. Gjendjen e prapambetur të Shqipërisë Avniu e cilësonte si «një vend oriental, të prapambetur, një pjesë e Turqisë së vjetër». Dhe ai bënte thirrje për përmirësimin e kësaj gjendjeje. Mjete për zhvillimin e shoqërisë ai konsideronte shkollat e natës, konferencat, zhdukjen e të metave të shkollave, shtimin e bursistëve, që vinin për të mësuar mjeshteri (zanatet L. D.) të ndryshme. Avniu kërkonte që para interesave të vendit të mos vihej

1) AQSH. Fondi Shoqëria «Bashkimi». Dosja nr. 8. letër e A. Rustemit nga Roma, datë 27.9.1923, drejtuar Salih Hoxhës dhe gazeta «Politika», Vlorë, 6 shtator 1923.

asgjë tjetër, prandaj duke iu drejtuar rinisë ai këshillonte që ajo të mos përkëdhelte rrogat, si në kohët e sulltan Hamitit, të mos nguronte t'i prishte qejfin shkëlqesës (ministrit) ose superiorit. Rininë, forcën më aktive të popullit, ai e konsideronte të ardhmen e kombit dhe kishte besim të patundur në hovin revolucionar e në forcën e saj.

Një nga çështjet kryesore në programin e punës tij Avni Rustemi kishte djalërinë. Ai kërkonte që ajo të ishte e gjallë, revolucionare e sypatrembur. Në një artikull të tij Avniu i drejtohej rinisë me këto fjalë: «Çohuni, bre burra në këmbë e mos i kini frikë askujt!»¹⁾ Duke kuptuar politikën antipopullore të regjimit çifligaro-borgjez në atë kohë, ai kritikonte qarqet e klikat drejtuese dhe shkruante me guxim: «Kur qeveria nuk plotëson nevojat më me rëndësi që ka kombi, duhet ta bëjmë ne që (ajo L. D.) ta ndjejë këtë». Ai nuk pajtohej me mendimin e elementëve indiferentë, që kishin frikë të ngriheshin kundër qeverisë. Avniu kërkonte t'i tregojë grushti qeverisë, duke shtuar se «nuk është e lehtë të bëhesh udhëheqës i një kombi pa ato idera të qarta dhe pa atë vullnet të duhur, që kërkojnë nevojat e kohës».²⁾

Penën e vet Avni Rustemi e vuri në shërbim të atdheut të shumëvuajtur, qysh nga mosha 17 vjeçare, kur ishte student në Zvicër e gjer në çastet e fundit të jetës. Avniu nuk e ndau fjalën nga veprat. Ai u mundua t'i bënte realitet mendimet e tij, që ishin aspiratat e të rinjve. Këto gjëra ai deshi t'i reazojë nëpërmjet «organizmave politike dhe shoqëro-

1) Gazeta «Politika», 20 tetor 1923.

2) «Politika», 4 tetor 1923.

re» nëpërmjet klubeve, shoqërive që themeloi kudo në Shqipëri, ose që frymëzoi, që nga «Djelmëria dibrane» e gjer te «Njeriu i ri» i Përmetit. Për këtë qëllim ai i kushtoi një kujdes të posaçëm zhvillimit të shoqërive. Avniu u qëndroi mbi kokë këtyre klubeve e shoqërive, edhe atëhere kur ishte jashtë Atdheut, për studime. Ai udhëzonte bashkëpunëtorët e tij si Salih Hoxhën¹), që për të ngritur më lart ndjenjat patriotike e frymën luftarake të përkujtonin ngjarje historike si Luftën e Vlorës dhe kërkonte të dhëna për festimin e përvjetorit të kësaj epopeje. Njëkohësisht prej andej jepte udhëzime për forcimin organizativ e intensifikimin e aktivitetit të shoqërisë «Bashkimi». Për këtë rekomandonte të zhvillonte mbledhje të përgjithshme, duke njoftuar shokët e vet në atdhe, se «ai ishte në dispozicion të statutit gjithmonë me plot dashuri».²). Ai i shikonte klubet e shoqëritë si mjete të lidhjes me popullin, si organizma luftarake për edukimin e masave me idetë e revolucionit. Avniu e kishte të qartë se nëpërmjet shoqërive demokratike, idetë patriotike do të mund të realizoheshin e të përhapeshin në popull.

Si publicist, sidomos nga vitet 1920 e gjer në prill 1924, Avni Rustemi, shfaqti mjaft mendime të vlefshme që preknin probleme të rëndësishme të shtruuara nga zhvillimi historik i vendit në atë kohë. Ai dha një kontribut të shquar në përhapjen e propagandimin e ideve demokratike, antifeydale e anti-imperialiste. Për këtë qëllim ai përdori si tribunë shtypin përparimtar të kohës, gazetatat demokratike

1) Letër e datës 27.9.1923 dërguar nga Roma Salih Hoxhës.

2) Po aty.

të vendit: ato të kryeqytetit, të Vlorës si edhe botimet e përkohshme. Ato u bënë zëdhënëse të mendimeve më të avancuara, më përparimtare duke propaganduar gjithnjë idenë e forcimit të Atdheut, nëpërmjet mbështetjes në ekonominë e vendit, në shpirtin patriotik e revolucionar të popullit, në gadishmërinë e rinisë, e të gjithë masave popullore e sidomos të vegjëlisë.

NË QENDËR TË LËVIZJES POLITIKE

Periodha e viteve 1921-1924, kudo në vendin tonë u karakterizua nga zhvillimi i mëtejshëm i lëvizjes demokratike, antif feudale e antiimperialiste.

Opozita demokratike, me qëllim që të mos i jepte mundësi Ahmet Zogut të merrte fuqinë në dorë dhe të vendoste diktaturën feudoborgjeze, kundërshtoi projektligjin e zgjedhjeve për Asamblenë Kush-tetuese në gusht 1923. Pas diskutimesh e debatesh të fuqishme, Opozita mundi ta detyronte bllokun qeveritar reaksionar të bënte ndryshime në projektligjin. Ajo kërkoi që deputeti të zgjidhej për çdo 8 mijë frymë dhe zgjedhësi i dytë për çdo 250 frymë, që mosha e zgjedhësve të ishte mbi 18 vjeç, ndërsa e drejta që të votonin edhe gratë (ato që dinin shkrim e këndim) nuk u pranua.

Fushata e zgjedhjeve filloi pas shpërndarjes së parlamentit, më 30 shtator 1923. Me iniciativën e Opozitës u ngritën grupe politike lokale kudo. Ata kërkonin e luftonin për demokratizimin e aparatit shtetëror. Organizata «Bashkimi» nuk parashtrroi kandidatët e saj për në asamble, por përkrahu kandidatët e Opozitës demokratike dhe i mbështeti këta.¹⁾ Avni Rustemi, udhëheqësi i shoqërisë «Bashkimi» u vu

1) Historia e Shqipërisë. Vol. 2. Tiranë, 1965, f. 532.

kandidat nga popullsia e Kosovës. Në atë periudhë në vendin tonë po forcohej lëvizja për reforma e liri demokratike. U zgjerua lëvizja fshatare, protestat për bukë. Katundarët hidhnin në dorë depot e tregtarëve, ku mbanin drithëra, u rritën revoltat kundër nëpunësve të qeverisë etj. U acarua mjaft lufta politike, e cila u bë më e theksuar gjatë fushatës elektorale. Në çdo anë të vendit për drejtimin e fushatës elektorale u formuan grupe të ndryshme. Por larmia e grupeve politike brenda vendit pasqyrore dobësitë e lëkundjet e borgjezisë kombëtare, e cila nuk arriti t'i shkrinte ata në një parti të vetme demokratike, për t'u bërë ballë me sukses bllokut të çifligarëve të mëdhenj.¹⁾

Opozita, duke patur përkrahjen sociale të masave e duke kërkuar Asamblenë Kushtetuese, synonte që nëpërmjet luftës politike e fitores në zgjedhje të mënjanonte nga pushteti klikën e bejlerëve çifligarë. Krerët kryesorë të Opozitës, si Noli, gjatë fushatës së zgjedhjeve, kërkuar votim të fshehtë, direkt meqenëse forcat bashibozuke të Ahmet Zogut vepronin në Tiranë dhe përbënin një rrezik serioz për forcat demokratike. Noli propozoi që Asamblea të mbledhej në Vlorë.²⁾

Shtypi demokratik ndihmoi aktivisht në fushatën elektorale. Ai mbështeti elementët më të shëndoshë, të shquar në veprimtarinë patriotike e demokratike, e të dalluar në propagandimin e ideve për reforma ekonomike, shoqëri arsimore, politike etj.

Shembulli i prefekturës së Kosovës, që mbështeti e propozoi kandidaturën e Avni Rustemit, ishte

1) Historia e Shqipërisë. Vol. 2. Tiranë, 1965, f. 532.

2) «Shqipëria e Re». Kostancë, 2.9.1923 dhe «Politika». Vlorë, 16.8.1923.

t'i vinte përballë një grup qeveritar. Por elementët e përkrahur nga qeveria humbën në votime. Ata morën tri vota, bile ato i mori vetë kryetari i grupit, ndërsa 143 i morën anëtarët e Opozitës.¹⁾

Pa frut mbetën në prefekturën e Kosovës edhe përpjekjet e disa elementëve të veçuar, të cilët u përpoqën të pengonin fitoren e grupit të kandidatëve demokratë. Këta elementë, duke mos u mbështetur tek populli, pësuan disfatë. Në përfundim të fushatës elektorale, atje fitoi edhe kandidatura e Avni Rustemit.

Fitorja e Avniut në prefekturën e Kosovës u prit kudo me entuziazëm. Vetë Avni Rustemi falënderoi kosovarët. Në telegramin e tij, ai i siguronte se «do ta kryente detyrën, ashtu si e kërkonte nevoja e Shqipërisë, që tërë vendi të kishte urtësi, bashkim dhe vullnet».²⁾

Atë e uruan gjithashtu nga tërë anët. Sipas traditës shqiptare, disa qytete të Shqipërisë fitoren e kandidaturës së Avniut si asamblist e përshëndetën me të shtëna pushkësh. Të tilla armë u zbrazën në Vlorë, Gjirokastër etj.³⁾

Fitorja e patriotit revolucionar, që ishte cilësuar nga populli i Kosovës si «njeriu i barotit», ishte një nder i madh që i bëhej Avniut. Tani e tutje ai do të zinte një vend në sallën e Kuvendit Kushtetues, për të folur aty si një tribun kundër reaksionit çifligar, me A. Zogun në krye.

Pas përfundimit të zgjedhjeve, gjendja politike acarohet edhe më shumë, pasi raporti i forcave në

1) Gazeta Zyrtare, datë 14.3.1924.

2) QK Gjirokastër.

3) Po aty.

Asamble nuk ishte në favor të kryeministrit Ahmet Zogut. Ky dhe klika e tij filluan të bëjnë pazarllëqe me fashizmin italian, duke i dhënë koncesione Qeverisë së Musolinit, për nënshkrimin më 20 janar 1924 të një traktati tregtar, që ishte prologu i ndërhyrjes së huaj, traktat që Ahmet Zogu nuk pati guximin ta paraqiste për ratifikim.¹⁾

Nga ana tjetër, vazhdonin grevat e punëtorëve, mësuesve, nëpunësve, që tregonin se masat nuk pajtoheshin me politikën e klikës në fuqi. Ndërkaq Opozita e ndjente tani se Asambleja, me përbërjen që kishte nuk mund të jepte ndonjë gjë pozitive në favor të lëvizjes demokratike.²⁾

Megjithatë, forcat përparimtare bënë përpjekje për rrëzimin e Qeverisë së Ahmet Zogut e mënjanimin e qarqeve bejlerçoçifligare reaksionare nga pushteti.

Opozita vendosi të vepronte me forcën e armëve. Më 23 shkurt 1924 u bë atentat kundër Ahmet Zogut. Bloku qeveritar ishte i armatosur gjer në dhëmbë, kurse asamblistët e Opozitës ishin thuajse të paarmatosur. Atentati alarmoi reaksionin dhe i dha rast të hidhej kundër opozitës, anëtarët e së cilës mbetën 4 orë me radhë të rrethuar nga bashi-bozukët e Ahmet Zogut e të Shefqet bej Verlacit, «të cilët — sikurse shkruan Noli — kolovitnin në hundë të anëtarëve të Opozitës ca kobure gjysmë metra të gjata».³⁾ Megjithatë, siç shkruajnë gazetarët që u ndodhën në sallën e Asamblesë, «Noli dhe Gurakuqi, dy nga udhëheqësit e Opozitës u ngjanin se-

1) Historia e Shqipërisë. Vëll. II. Tiranë 1965, f. 536.

2) Po aty.

3) Lefter Dilo Ligjëron Fan Noli. Tiranë 1944.

natorëve romakë, as u verdhën dhe as u prishën fare në fytyrë». ¹⁾ Nga ana e tij Fan Noli shkruan, se Ahmet Zogu urdhëronte «të arrestoheshin deputetët e Opozitës». Ai shpalli gjendjen e jashtëzakonshme. U rrethua Parlamenti. Por oficerët përparimtarë nuk iu bindën urdhrave të A. Zogut për arrestimin e përfaqësuesve të Opozitës. Ata urdhëruan përkundrazi, të shpërndareshin forcat që kishin rrethuar parlamentin dhe shkuan e rrethuan godinën, ku banonte Zogu për të mënjanuar dërgimin e mercenarëve të tij kundër parlamentit. Çarmatosën bajraktarët në shërbim të Zogut, hodhën në dorë zyrat e PTT-së, bllokuan shkëmbimet telegrafike, në mënyrë që forcat e Elbasanit ose të krahinave të tjera të mos vinin në ndihmë të Zogut. Kështu forcat e Zogut u tërhoqën nga parlamenti, pa mundur të goditin krerët e Opozitës. Ata u trembën nga forcat e oficerëve të rinj, të cilët treguan se ishin gati për t'u treguar grushtin. Por Zogu nuk hoqi dorë nga synimet e tij. Edhe pasi u largua nga qeveria, ai thurte komplete e intriga antikombëtare e antipopullore.

Ahmet Zogu kurdisi plane për të vepruar prapa shpine kundër Opozitës dhe sidomos kundër Avni Rustemit. Ngjarja që ndodhi në Asamble «i dha të kuptojë Zogut se mund të pësonte ndonjë atentat tjetër dhe se i vetmi njeri, që do të organizonte këtë ishte Avni Rustemi» ²⁾ Zogu ishte i bindur se këtë atentat e kishte organizuar Avniu. Atij i ishte mbushur mendja se «Avniu duhesh të vdiste, që të shpëtonte ai vetë, se atëherë do të flinte rehat dhe se

1) Veli Hashorva. Vepër e cituar.

2) Veli Hashorva. Të shkuara, të paharruara.

nuk do të kishte njeri në shkallë të Avniut, që t'i prishte gjumin».1)

Por Zogu u gabua rëndë, tregojnë bashkëkohësit. Ai «kishte bindje se me vrasjen e Avniut nuk do të lëvizte ndokush, por u gënjye.2) Ai nuk e kishte kuptuar mirë dhe thellë personalitetin e Avniut, nuk e kishte parashikuar furtunën që do të shkaktonte në Shqipëri vrasja e heroit Avni Rustemi.

Ai besoi se qeveria e bejlerëve, e formuar nga Vërlaci, Mufit Libohova, Iliaz Vrioni etj. më 3 mars 1924, do të mund të qëndronte. Njëkohësisht ai punonte për të ardhur përsëri në krye të qeverisë. Por nuk arriti, forcat demokratike përmbysën atë dhe planet e klikës së tij.

1) V. Hashorva. Të shkuara, të paharruara.

2) Po aty.

AVNIU NË ASAMBLENË KUSHTETUESE

«Shqiptari, që ka hequr keq nuk mund të heqi më; këtu duhet qetësi e përparim».

AVNI RUSTEMI

R Në sajë të veprimtarisë së tij të gjithanshme politike-shoqërore gjatë viteve 1921-1924, Avni Rustemi ishte bërë i njohur në tërë anët e vendit. Vegjelia dhe patriotët demokratë përparimtarë ushqenin simpati të madhe për të. Avniu, ashtu si patriotët më të nderuar të popullit tonë, që nga Bajram Curri, Halim Xhelo, Mihal Grameno, etj e priti me entuziazëm përmbysjen e despotizmit të carëve të Ruisë. Patriotët tanë shkruan e folën për gjeniuin e Revolucionit të Tetorit dhe mikun e popujve të vegjël, për Vladimir Iliç Leninin.

«Edhe Avni Rustemi, qysh në kolegjin e Shën Mitër Koronës u fliste me pasion shokëve të vet për Leninin, sikur jo vetëm ta kishte njohur, por edhe diçka më tepër» tregon një bashkënxënës i tij.

Në kohën kur në vendin tonë forcat demokratike e përparimtare ishin në ndeshje të egër me reaksionin, me çifligarët dhe me armiqtë e tjerë të popullit, në Moskë, më 21 janar 1924 mbylli sytë

Lenini. Këtë herë Avni Rustemi ishte anëtar i Asamblesë Kushtetuese. Pikërisht më 4 shkurt 1924, kur asamblistët reaksionarë kundërshtuan propozimin e bërë për të mbajtur zi për Leninin, u ngrit me rrëmbim Avni Rustemi. Ai kërkoi të mbaheshin pesë minuta zi për Leninin, «që kishte mbrojtur principet e larta të njerëzisë, i pari që denoncoi traktatin e fshehtë të Londrës të 1915-ës, i cili kishte për qëllim copëtimin e Shqipërisë.» Për këtë ngjarje historike shoku Enver Hoxha ka thënë se «ëndrrat e popullit, për realizimin e të cilave luftoi edhe Avni Rustemi, i bëri realitet vetëm Partia jonë, që ecën sipas mësimave të Leninit, për vdekjen e të cilit Avniu detyroi një parlament të tërë reaksionar të ngrihet në këmbë për të nderuar kujtimin e tij».1)

Gjesti i Avniut u bë burim frymëzimi për të rinjtë e për poetët tanë, të cilët duke kujtuar atë ditë shkurti të vitit 1924, shkruajnë për Avni Rustemin «se këtu djaloshi zanin ngriti e një lot pa dasht në sy i shndriti»2). Në ato çaste asamblistët reaksionarë e klika e Zogut mbërthyen sytë te patrioti revolucionar, dhe u munduan ta ndalonin oratorin, i cili me kokën lart vështronte nëpër sallë, i qetë dhe kryelartë.

Tribuni i ri revolucionar interpretonte në ato çaste vlerësimin e mbarë popullit tonë për Leninin dhe veprën e këtij «politikani botëror dhe revolucionari më të madh të shekujve», sikurse shkruante bashkëpunëtori i ngushtë i Avni Rustemit, publicisti revolucionar Halim Xhelo në gazetën «Politika»

1) Enver Hoxha. Fjalim në Libohovë, «Zëri i popullit», 31 korrik 1956.

2) Ll. Siliqi, «Zëri i popullit», 27 nëntor 1953.

të Vlorës. Qëndrimi i vendosur e këmbëngulës i Avniut në Asamble bëri jehonë të madhe. Atë e përshëndeti mbarë opinioni publik përparimtar shqiptar. Por Avniu nuk hoqi dorë nga qëndrimet e vendosura kundër reaksionit. Për mbrojtjen e idealeve të vegjëlisë ai e shfrytëzoi me mjeshtëri tribunën e Asamblesë Kushtetuese.

Avniu e mori fjalën për herë të parë si asamblist, në mbledhjen e 25 shkurtit 1924. Tok me Luigj Gurakuqin, Fan Nolin, Ndre Mjedën, Spiro Kolekën, etj. gjashtë ditë më vonë, në mbledhjen e dytë të Asamblesë, ai u ndesh me çifligarët e mëdhenj Ilias Vrionin, Shefqet bej Vërlacin, Abdurrahman Dibrën, Ferit Vokopolën, Ali bej Këlcyrën etj, të cilët arritën gjer atje sa qeverinë e beut të Elbasanit ta vlerësonin gjoja «njëlloj me atë të Vlorës më 1912, me atë të dalë nga Kongresi i Lushnjës më 1920». ¹⁾ Në mbledhjet e para të Asamblesë, një nga të parët e mori fjalën Avni Rustemi, i cili theksoi se «armiqtë nuk janë vetëm në kufi», duke lënë të kuptohej se ata ishin dhe brenda në Shqipëri. Në debatin e zhvilluar ditën e dytë të mbledhjes së Asamblesë Kushtetuese Avniu ishte i pari që u ngrit kundër qeverisë së Shefqet bej Vërlacit, të cilës nuk ia dha votën e tij të besimit. Me të u bashkuan edhe 25 asamblistë të tjerë. ²⁾ Tribunën e Asamblesë Avniu e përdori për të kritikuar padrejtësitë shoqërore dhe ngriti probleme për çështjen e atdheut dhe të popullit. Në mbledhjen e tretë të Asamblesë, Avniu ishte i pari që demaskoi barbarizmat serbe në Kosovë etj.

1) Bisedimet e Kuvendit Kushtetues. Mbledhja e XIX, e hënë, 25 shkurt 1924, f. 219.

2) Po aty, Mbledhja e XXIV, mars 1924.

Ai theksoi se «kemi një zakon që kur vjen një lajm i bukur entuziazmohemi e kur vjen një lajm i hidhur hidhërohemi si ajo flaka e kashtës, që merr zjarr me të shpejtë dhe zhduket përnjëherë». Avniu kërkoi që flaka të ishte e ndezur e të ngrihej zëri përballë barbarizmave të shovinistëve serbë. Ai shtoi se të gjithë i dinin këto barbarizma, por «çështja është me gjetë mënyrën si me i ndalue këto».1) Avniu demaskoi hapur edhe mënyrat e emërimit të përfaqësuesve jashtë shtetit duke thënë se «ne gjejmë vende për persona e jo persona për vende», duke kritikuar me atë rast edhe përfaqësuesin shqiptar në Beograd, i cili ndodhej në sallën e Asamblesë, e «në ato çaste dukej se gogësinde e qëndronte aty me gojën hapur...». Ai kërkoi të zgjidheshin problemet e popullit kundër varfërisë, të përmirësohej gjendja.

Në mbledhjet e tjera Avni Rustemi ngriti problemin e ndihmës së malësorëve që ishin pa bukë e pa mjete për të punuar tokën. Ai kritikoi qëndrimin indiferent të qeverisë ndaj gjendjes së tyre të keqe dhe shtoi, se «në qoftë se na dhimbsen malësorët pse janë të varfër, duhet të caktohet një taksë për të gjithë ata që kanë një fitesë, e kjo taksë të jetë proporcionale, se vetëm në këtë mënyrë mund të jemi njerëzorë si duhet...»

Avniu nuk pranonte që për këtë problem asamblistët të nxiteshin nga ndjenja sentimentale, por e shikonte si detyrë të tyre, prandaj shtonte «nuk duhet vepruar si në kohën e Turqisë që këto ndihma bëheshin me anën e pullave të Hixhazit... se këto mënyra në vend që të shtojnë moralin e malësorit

1) Mbledhja e XXIV, mars 1924, f. 313.

e prishin fare. Këto e demoralizojnë popullin e mjerrë». Avniu pyet Asamblenë në «është e zonja ajo, që në vend të kërkojë një shkurtim prej 50% në rogat e nëpunësve, të krijojë një bankë nacionale, duke filluar që nga kryeministri e deri te më i vogli që është i pasur e t'u vihet një taksë për krijimin e kësaj banke. Malësorëve në vend që t'ia falim të hollat, t'ju japim nga 1000 e ca më tepër korona hua». Avniu çfaq këtu mendimin se «nuk duhet falur para, por të kërkohet punë nga ata (malësorët).»¹⁾ Ai vlerësonte me të drejtë kontributin e malësorëve në luftrat për liri, mbajtjen e traditave që u ngritën më lart me Lidhjen Shqiptare të themeluar në Prizren, kryengritjet e mëdha të viteve 1910-1912 dhe shpalljen e Pavarësisë. Ai shtonte se «atyre duhet t'u vimë me doemos në ndihmë, të jemi gjithnjë në kufi të principit e të moralit e jo të vemi në kris-më». Avniu kërkonte të mos merrej taksë vetëm nga nëpunësit, por të gjendej mënyra morale dhe e drejtë në këtë çështje.

Avniu goditi në mbledhje të tjera, bisedat boshe e të thata që zhvilloheshin në Asamble, duke arritur gjer atje sa t'i cilësonte këto «si kënga e Mukes».

Duke ngritur në Asamble përsëri problemin e masakrave serbe në Kosovë, ai kërkonte që Lidhja e Kombeve të mbahej në korent nga ana e qeverisë shqiptare përsa ngjanin në Kosovë e Çamëri. «Po të ishte bërë kjo — tregon Avniu — ne nuk do të kishim nevojë sot të bëjmë thirrje në parlamentet e botës dhe Lidhja e Kombeve nuk do ta quante element minoritet popullsinë shqiptare që banon në Kosovë e në Çamëri».

1) Mbledhja e XXXI, datë 19.3.1924.

Avniu ngriti me forcë problemin «se qeveria duhej të mbante në korent Lidhjen e Kombeve, sepse për të zënë fjala vend duheshin paraqitur statistika e argumenta». Jo njerëz — kërkonte Avniu, — por edhe një pulë të vritej padrejtësisht në Kosovë, këtu duhej të dihej».1)

Ai shfaqti mendimin se «nuk duhet të kërkojmë të vemi në Kosovë e në Belgrad, por për të ditur se ç'ngjan atje dhe se sa vuajnë vëllezërit tanë atje, duhen mbajtur statistika». Ai shtonte se «ne nga këto statistika nuk kemi kurrgjë; flasim në krismë e pa ditur asgjë send.» Avniu pastaj hodhi pyetjen: «Si janë punët atje? Kush është vrrarë e si është vrrarë? Asnjë — shton Avniu — s'mund të më thotë sigurisht e pikë për pikë».

Pastaj oratori tregoi se gjithë këto i thoshte «për të mbrojtur tezën, që duhet të kemi dokumenta dhe argumenta. Mbroj tezën — shton ai — që ne duhet të dijmë çdo gjë që bëhet në Kosovë. Është shumë lehtë të marrim pendën e të bëjmë telegrame të bukur e të protestojmë, duke harruar detyrën konkrete, nuk lëmë pa mbushur ato që na imponon detyra njerëzore».

Nga fundi i fjalës, Avniu përsëriti shprehjen «Kurrgjë nuk bëjmë», dhe shtoi: «do të bëjmë doemos». Për të treguar edhe një herë se duhet vepruar me gjallëri, ai kërkoi të mos veprohej vetëm me anën e telegrameve zyrtare. Kështu e shtroi ai problemin edhe për shqiptarët në Çamëri.

Në një mbledhje tjetër të Asamblesë, 13 ditë para se të goditej për vdekje nga vetë njerëzit e qeverisë së Shefqet bej Verlacid dhe Ahmet Zogut,

1) Mbledhja e Kuvendit Kushtetues, 2 prill 1924. f. 609.

Avniu si orator i Opozitës demokratike kritikoi me forcë kriminelët e bashibozukët, që vepronin brenda në Tiranë.

Duke patur parasysh vrasjet e patriotëve demokratë të kryera nga reaksioni çifligar në disa krahina të Shqipërisë Avniu ngriti me forcë problemin e çarmatimit të bashibozukëve, si agjentë të qeveritarëve e të klikave të bajraktarëve. Ai tha se «nuk mund të durojmë më, që të veprohet në këtë mënyrë në kurriz të popullit. Shqiptari që ka hequr keq nuk mund të heqë akoma, këtu duhet qetësi e përparim.»

Por ndërkohë klikat e bejlerëve të kryesuar nga Shefqet bej Verlaci dhe Ahmet Zogu, po kurdisnin plane djallëzore. Ata po përgatiteshin për vrasjen e Avniut, i cili ishte një ndër flamurtarët kryesorë, që luftonte për mbrojtjen e të drejtave të popullit. Avniu kërkonte çarmatimin civil, çarmatimin e njerëzve me armë, që silleshin vërdallë «këtu brenda në Tiranë», sikurse tha ai në fjalimin e vet të datës 7 prill 1924.¹⁾

Avni Rustemi demaskoi me forcë qeverinë. Ai kritikoi çifligarët duke i krahasuar ata me baronët e kontët e Evropës, dhe i quajti ata qeveritarë të lidhur ngushtë me mbeturinat e pushtetit otoman. Bejlerët, agallarët e efendilerët Avniu i kishte demaskuar në mbledhje publike, në shtyp, nëpërmjet shoqërive dhe tani po i demaskonte ata burrërisht e plot guxim, brenda në Asamble.

Në Asamble, Avniu u ngrit me forcë kundër atyre që duke mos «u mjaftuar nga një kobure ma-

1) Bisedimet e Kuvendit Kushtetues, Mbledhja XXXX, f. 654.

rrin nga dy». Prandaj ai kërkoi «çarmatimin e kazerlave civile brënda në Tiranë», siç i quajti sara-jet e bejlerëve, çerdhet e reaksionit. Në fund ai kërkoi «shpalljen e shtetrrëthimit, të shtypeshin faj-torët e jo të ketë frikë populli».1)

Me këto fjalë u mbyll jeta parlamentare e Av-niut. Në vend, pra, që të dënoheshin fajtorët e të mbrohej populli, qeveria e bejlerëve, tok me Ahmet Zogun, shtypnin popullin dhe mbronin «princat e rinj» si Ahmet Zogu. Dhe pikërisht ata kurdisën komplotin kundër Avniut, për ta zhdukur atë fi-zikisht.

1) Bisedimet e Kuvendit Kushtetues. Mbledhja XXXX,

VRASJA E AVNIUT

Reaksionarët feudalë, që ishin në fuqi, nuk e «lanë arsimtarin e vogël të vazhdonte të ngrinte dolli në vendin e vet»¹⁾ Ata kujtuan se ia arritën qëllimit, por shpejt e panë se vrasja e Avniut, ngriti popullin në këmbë dhe plasi pikërisht ai revolucion që përgatiste Avni Rustemi. Me vrasjen e tij Avniu u bë pishtari i gjithë popullit, i cili rrëmbeu pushkët dhe marshoi mbi tiranët, për të goditur edhe një herë në mënyrë masive feudalizmin, Ahmet Zogollin dhe gjithë sejmënët e tyre».²⁾

Ndaj Avniut dhe familjes së tij ushqente urrejtje klasore gjithë reaksioni e midis tyre edhe Mufit Libohova. Pas vrasjes së Esat pashë Toptanit, një ditë para kafes së Libohovës beu pati paturpësinë t'i thotë Neim Rustemit, burrë plak 79 vjeç «se Avniu ishte katil, se tani ai plak e siguroi pleqërinë, se tani e tutje do ta kalonte jetën pa halle». Neim Rustemi iu përgjigj trimërisht: «Mbaj gojën Mufit bej, se Avniu e vrau Esat pashën si armik dhe tradhtar të

1) AQSH. Fondi A. Rustemi. Dosja Nr. 17 (kopje). Përkthimi nga frëngjishtja. Pjesë nga fjala e mbajtur para gjyqit nga avokati Anatol de Monzi.

2) Enver Hoxha. Fjalim në Libohovë. «Zëri i popullit», 29 maj 1969.

vendit dhe jo për para. Ai punon për vatanin, shiko ti që po i bën varrin». ¹⁾

Mufit Libohova, i cili cilësonte «hajdutë» patriotë të tillë si Çerçiz Topullin, sikurse kemi vënë në dukje, ishte pasardhësi i një familjeje, që i kish rrjepur lëkurën fshatarësisë. Mufit beu, sidomos nga viti 1919 e këndeje, u bë vegël e politikës imperialiste. «Ai ishte — shkruan kronika e kohës — feudali me mustaqe të holla e të vogla, me të veshurit elegant e shik, me parrulla të vockëla e anekdota të shpeshta në muhabet, me frengjishten, që e kuvendonte lehtazi, me pamjen e një italiani të fismë». Ai ishte beu që e akuzonte Korça, Vlora, e afërsisht çdo vend i Shqipërisë. «Ishte beu — shkruan shtypi demokratik i Gjirokastrës — që nuk e donte njeri, pikërisht sikurse Esatin». ²⁾ Atë e urrenin, se ishte kundër vendimeve të Kongresit të Lushnjës. Ishte ai që qe sulur në Fier, për të rrethuar e burgosur, me ushtrinë e gjeneralit italian Piaçentinit, kongresistët e Lushnjës.

Kur Mufit Libohova kërkoi të fliste në Gjirokastrë si ministër i Qeverisë proitaliane, antikombëtare të Durrësit, populli i tregoi hapur urrejtjen që kishte për të dhe faktin se ishte pro vendimeve të Kongresit të Lushnjës. Kështu beu — sipas shtypit të kohës — «iku i hidhëruar në Libohovë, i zemëruar, që Gjirokastra nuk deshë ta njihte si ministër». ³⁾

Kur demokratët e cilësuan Kongresin e Lushnjës «një revolucion», Mufit Libohova me një frymë dëshpërimi tregoi mosbesim te ai Kongres. ⁴⁾

1) Fondi Q.K. Gjirokastrë.

2) Po aty.

3) Po aty.

4) Po aty.

Organizatorët e Kongresit të Lushnjës ai i quante «intrigantë e sherretë», që gjoja nuk përfaqësonin popullin¹). Ai ishte beu që lidhej ngushtë me Kapialbën në Gjirokastrë, kundër Qeverisë së Lushnjës dhe me Pjaçentinin, për një orientim pa kushte nga Italia».

Mufit beu përkrahte protektoratin e huaj. Mendimet e tij armiqësore e antikombëtare ndaj të ardhmes së vendit, duken qartë kur ai shkruante se «Shqipëria nuk kishte shpresa të lindej, sepse shqiptarët nuk kishin atë zotësi e meritë»²)

Si një afarist pa skrupull, ai vazhdimisht bisedonte e mbante lidhje me regjentë të legatës italiane në Tiranë, të cilët i raportonin Romës bisedat e fshehta me Mufit Libohovën, për depërtimin ekonomik të Italisë në Shqipëri. Për këtë ai i kërkonte atyre «që Italia duhet t'i ballkanizonte pak metodat e veprimit në vendin tonë».³)

Ky ishte pra feudali që ndiqte e vazhdonte me konsekuencë vijën politike tradhtarë antikombëtare të Esatit. Populli, që e urrente, ishte shprehur me këto fjalë për të: «Një Esat ndënë dhe, një mbi dhe».

Qëndrimi i Mufitit gjatë viteve 1920-1924 ishte vazhdim i mëtejshëm i veprimit të tij tradhtarë. Mufiti vazhdonte të mbetej vegël e politikës italiane; këtë e tregon fakti, se edhe kur ishte çështja e zgjedhjeve të deputetëve më 1921, që nga Italia, ish prefekti i Gjirokastrës, Faci, jepte këtë porosi: «të vinte

1) Fondi i Muzeut Historik të Gjirokastrës.

2) Po aty.

3) Po aty.

në qeveri Mufiti, se ndryshe Shqipërinë do ta merrte lumi...¹⁾

Mufit beu ishte vegël e qarqeve italiane dhe kreu i agallarëve, të cilët për të siguruar fitoren e tij gjatë zgjedhjeve parlamentare më 1921, kishin arritur të jepnin 10.000 lira turke; por megjithatë në bazë të vendimit, që ishte marrë nga patriotët demokratë në Gjirokastrë Mufit beu duhej të goditej «me vota të zeza», dhe në të vërtetë ashtu ndodhi. Mufit beu nuk u zgjodh deputet, as më 1921 dhe as më 1923 e kështu agallarët dështuan dhe beu i tyre pësoi disfatë të plotë²⁾. Kjo ishte pasojë e qëndrimit dhe e urrejtjes antifeudale që ushqente populli e sidomos djalëria. Ajo kish përcaktuar qartë dhe hapur qëndrimin që duhej mbajtur përballë tij, gjatë fushatës elektorale të vitit 1921. I riu Sami Dalipi shkruan kundër Mufit beut, duke thënë se «populli ynë, ashtu si ka luftuar, për mëvehtësinë e Shqipërisë ashtu duhet dhe sot t'u bjerë dhëlpërive me frymë të fuqishme, që të mos na venë kot të gjitha sa kemi punuarë, se sot është koha dhe jo mot».³⁾

Të rinjtë kërkojnë nga votuesit që përpara se të votonin «të mendonin të ardhmen që mos na dhe mbë koka, po të hapim sytë dhe t'i dimë mirë të gjithë ata zotërinj, që do na dalin deputetë nga Gjirokastra».⁴⁾

Për të dekurajuar rininë revolucionare, për të marrë pushtetin diktatorial në duar e për të forcuar pozitën, ashtu sikurse A. Zogut, edhe Mufit Liboho-

1) «Drita», Gjirokastrë, maj 1921.

2) Po aty.

3) Q. K. Gjirokastrë.

4) Po aty.

vës i duhej në radhë të parë vrasja e patriotit Avni Rustemi. A. Zogu nuk kërkonte ta zhdukte Avniun në kuptimin e thjeshtë të hakmarrjes për shkak se ai i kishte vrarë dajën e vet, Esat pashë Toptanin. Jo! Atentati i Zogut kundër këtij patrioti kishte një kuptim të madh politik e ideologjik. A. Zogu shihte tek Avni Rustemi figurën e një revolucionari konsekuent e të vendosur kundër çifligarëve e padrejtësisë. Qenia e Avniut përbënte rrezik për Zogun dhe klasën e tij reaksionare. Prandaj ai vazhdimisht bluate në mendje planin për ta asgjësuar Avniun. Këtë e shikonte si rrugën e shpëtimit të klasës që përfaqësonte e të vetes së tij.

Nga ana tjetër, zhvillimi i lëvizjes demokratike shqiptare për të cilin A. Rustemi kishte dhënë kontribut të çmuar, shqetësonte qarqet politike e diplomatike të monarkive fqinje. Ministri i Jashtëm i Jugosllavisë, Ninçiqi në pragun e zgjedhjeve për Asamblenë, kishte deklaruar «se ishte në interes të shtetit serbo-kroato-slloven ta shohë Shqipërinë (lexo: klasën e bejlerëve — L.D.) fituese përmbi vështirësitë e shkaktuara nga regjimi parlamentar»¹⁾ Asgjësimi i elementëve të vendosur të lëvizjes demokratike, një nga drejtimet themelore të të cilëve ishte ruajtja e pavarësisë kombëtare kundra synimeve të qarqeve politike imperialiste dhe qarqeve shoviniste fqinje, ishte në dobi të këtyre të fundit. Ato e shihnin me shqetësim lëvizjen demokratike shqiptare edhe për shkak të influencës e ndikimit të saj në zhvillimin e lëvizjes punëtore e revolucionare në Ballkan.

Të interesuar për shuarjen e lëvizjes demokratike, dhe të nxitur nga armiqtë e jashtëm, reaksio-

1) Muin Çami. «Studime historike» Nr. 2, 1965, f. 13.

narët me Zogun në krye e me Mufit Libohovën si ortak, organizuan vrasjen e Avni Rustemit. Ishte koha kur Avniu po përgatitej të shkonte jashtë atdheut, për t'u njohur e për të punuar me shqiptarët e mërguar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nëpër kolonitë e tjera, si në Rumani, Egjipt etj. Qëllimi i këtij udhëtimi ishte që të mbliidhte ndihma për forcimin e shoqërisë «Bashkimi»¹⁾

Ai erdhi në Tiranë, më 20 prill 1924, për të marrë pasaportën. Duke ecur bashkë me Hoxha Kadrinë në rrugën e xhamisë së vjetër në Tiranë, në krye të sheshit, që quhej «Vorreza e pashës» atje ku rruga ndahet dysh, një person i lartë nga shtati (Isuf Reçi)²⁾, me kobure malazeze në dorë, qëlloi kundër Avniut prapa krahëve. Ai e goditi vetëm një herë, por fare nga afër dhe iku me të shpejtë.³⁾ Shoku i Avniut, Hoxha Kadriu (Kadri Lutfulla Prishtina) që ishte bashkë me të, nuk u largua, sepse nuk kishte besim te polici që ndodhej afër, kurse polici tjetër, që ishte 20-30 metra larg, bënte sikur po ndiqte vrasësin me çape të breshkës. Ai ishte polici i vënë nga nënpre-fekti i Tiranës dhe komisar i policës, që të ndihmonte vrasësin të arratisëj, ose ta vriste, që të mos

1) Bisedimet e Kuvendit Kushtetues. Mbledhja e XXXIII, datë 22.3.1924, ku lexohet një lutje e A. Rustemit, që kërkonte një leje tremujore për të shkuar në mes të shqiptarëve të Amerikës. Në këtë mbledhje Avniu deklaronte «se edhe rrogën, për arsye të ngushticës familjare nuk do ta marrë».

2) Krimineli që shtiu mbi Avni Rustemin, me pushtimin fashist të Shqipërisë u bë spiun i pushtuesve të huaj. Ai u ekzekutua nga njesitë guerile të qytetit të Tiranës në shkurt 1944.

3) Gazeta «Tirana», 27 prill 1924, Nr. 1. f. 3.

tregonte se kush e kishte shtytur.¹⁾ Dora kriminale e Isuf Reçit ishte vegël qorre e Ahmet Zogut dhe e gjithë reaksionit feudal, që ishin armiq të betuar të demokracisë e të përparimit të vendit.²⁾

Avniu, ndonëse i plagosur, por i paepur, u ngrit, nxori revolverin e qëlloi mbi vrasësin 3-4 herë, po nuk e mori dot.³⁾ Ndërkohë pranë tij erdhën mjaft shokë, të cilët e ngritën dhe e nisën me të shpejtë për në spital, ku i dhanë ndihmat e para. Lajmi i plagosjes së Avniut shkaktoi një hidhërim të përgjithshëm dhe e shtoi urrejtjen e popullit për klikat çifligare. Populli turma-turma vinte në spital ta shihte, të mësonte e të pyeste për shëndetin e tij.⁴⁾ Edhe i plagosur rëndë, Avniu mbahej i fortë nga zemra dhe nga shpirti. Ai e ndjente që ishte plagosur rëndë, por nuk u turbullua dhe as e humbi kurajon. Trimëria e kurajua shpirtërore e tij «inkurajoi dhe doktorët, të cilët pandehjnë se plumbi nuk kish bërë dëm në organet, por se brendazi — shkruan shtypi — bëhesh emorazhi e fortë».⁵⁾

Me të marrë vesh plagosjen e revolucionarit të shquar qindra telegrame u dërguan nga të gjitha anët e vendit. Nëpërmjet këtyre telegrameve, populli i uronte shërim të shpejtë udhëheqësit të djalërisë. Halim Xhelua nga Vlora dërgoi në Tiranë një njeri nergut, për të mësuar «gjendjen e Avniut, masat e qeverisë dhe tërë ngjarjet e atyshme».⁶⁾

1) Gazeta «Tirana», 27 Prill 1924, Nr. 1, f. 3.

2) Po aty.

3) Po aty.

4) Po aty.

5) Po aty.

6) Fondi i Muzeut Historik Gjirokastrë.

Emin Bilibashi, shok i vjetër i Avniut, në telegramin drejtuar atij thoshte se «Fara e mbjellë prej dorës suaj mbin dhe nuk do të venitet kurrë». ¹⁾ Populli i Vlorës i shkruante: «Guditja juaj shënon pikën e nisjes së një periudhe, ku do të ngrihet e do të gjallërohet më tepër ndjenja kombëtare». Avniut, të rënë në shtrat, Gjirokastra i dërgoi këtë telegram: «Fara e luleve vaditur me djersën e gjakun tuaj mbin dhe më s'venitet. Lutemi lajmëroni shpejt gjendjen...» ²⁾ ndërsa shokët e Avniut, pjesëmarrës në shoqërinë «Bashkimi», i shkruanin: «Bashkimi» mallkon dorën tradhtarë që kërkoi Shqipërisë t'i mungojë simboli i timërisë... ³⁾

Të tjerë shokë i telegrafonin me këto shprehje: «Të helmatisur nga lajme të kobshme marrim pjesë në hidhërimin tuaj. Pa durim presim shërimin tuaj». ⁴⁾

Kruma, më 21 prill 1924, organizoi një protestë, me anën e së cilës kërkoi kapjen dhe dënimin e «gjaksorit, sidomos për të nxjerrë në shesh shtytësat e këtij atentati, me të cilin ishte qëlluar zemra e kejt kombit shqiptar». ⁵⁾

Avniut të plagosur i dërguan telegrame, duke i uruar një shërim të shpejtë shokët e tij, studentët që vazhdonin mësimet në Paris, në Romë, Bari. «Jemi gati të bashkohemi me lidhje të hekurta për shpëtimin e Atdheut dhe për nderin e atij fatosi,

1) Fondi QK Gjirokastër. Klubi i opingarëve «Shpresa»

2) Fondi i Qendrës Kulturore,

3) Po aty.

4) Po aty.

5) Po aty.

udhëheqës i djelmërisë idealiste»¹⁾ i shkruante një grup të rinjsh.

Miting të gjërë organizoi Libohova më 22 prill, ku u mbajtën fjalime. Plagosja e Avniut u cilësua «një grusht kundër idealizmës shqiptare». Pjesëmarrësit kërkuan me forcë që «Asamblea të mblidhej në një nga prefekturat e Jugut, ose në atë të Shkodrës».²⁾

Njëkohësisht anëtarët e «Bashkimit», që punonin të shpërndarë nëpër qytete, nisën të përgatiteshin për të marrë hakun e kryetarit të tyre, gjendja shëndetësore e të cilit po keqësohej. Ata ishin shumë të shqetësuar. Venin e vinin nëpër zyrat e postë-telegrafeve, duke pyetur vazhdimisht për gjendjen e patriotit të plagosur për vdekje.

Telegrafistët, shumë prej të cilëve ishin anëtarë të «Bashkimit», ato ditë punonin vetëm me Tiranën, duke i lënë linjat e tjera. Populli e të rinjtë kudo pyesnin për shëndetin e kryetarit të «Bashkimit».

Bashkëpunëtorët, shokët e miqtë e ngushtë të Avniut shkruanin «Qoftë e mallkuar dor' e poshtër, që deshi të humbasë jetën».

Në spital, te kryet pranë Avniut qëndruan shokët e tij të dashur, shokët e idealit, anëtarët e «Bashkimit», demokratë përparimtarë e publicistë. 48 orë pranë tij qëndruan mjekët e infermierët si dhe të sëmurët e tjerë, të cilët thuajse kishin lenë bosh shtretërit e tyre. Duke u endur nëpër koridore ata prisnin përmirësimin e gjendjes së Avniut. Aq orë sa u dergj Avniu, aq kohë sa jetoi ai i plagosur rëndë, aq kohë i qëndruan edhe shokët e tij, rreth

1) Fondi i Qendrës Kulturore.

2) AQSH F. KM, Dosja Nr. 2, f. 367 origjinal.

spitalit, ca në këmbë, ca jashtë godinës duke shkëmbyer vetëm ndonjë fjalë, duke vështruar në sy plot ankth ata që dilnin nga dhoma e patriotit revolucionar.

Avniu herë mbyllte sytë, herë lëvizte ngadalë duart pa fuqi — shkruan një shoku i tij, — sikur donte të përqafonte Shqipërinë, nga e cila do të ndahej përgjithmonë». Plaga vazhdimisht keqësohej. Gjendja e tij shëndetësore gjithnjë e më shumë rëndohej. Fjalët e tij të fundit ishin këto: «Mos vajtoni për mua, kështu thuajuni shokëve, duajeni Shqipërinë. Luftoni për të qenë një ditë të lirë, të lumtur e të fortë, si shkëmbinj të e maleve tona».1) Në ato çaste ai kujtoi Mirditën e Labërinë, Skërficën e pashanë e shtrirë për tokë, kujtoi Vlorën dhe demonstratën e saj. Sytë e tij u mbyllën më 22 prill 1924 në ora, 2.20'.

Shoqëria «Bashkimi po atë ditë njoftoi lajmin e vdekjes së heroit. Mbarë vendi u përfshi nga një dhimbje e thellë. Nga tërë anët shpërthyen demonstrata të masave popullore.

Mitingjet e demonstratat antiqeveritare e bënë A. Zogun e bejlerët të dridheshin atje ku ishin struktur. Demonstratat e zhvilluara nga Veriu në Jug, i tmerruan ata. Qeveritarët morën masa mbrojtjeje për sigurimin e qetësisë. «Zogu, shqetësohej akoma më shumë pas vrasjes së heroit, po plumbi kishte dalë nga koburja dhe populli kërkonte shpagë».2)

Në këmbë ishte ngritur i madh e i vogël. Kërkesës së Opozitës dhe të popullit, që Avniu të varroset në Vlorë, në krah të Ismail Qemalit, prindërit

1) R. Këlliçi, Me djemtë e «Bashkimit» — Tiranë.

2) V. Hashorva. Kujtime.

e Avniut iu përgjigjën telegrafisht: «Avniu nuk ishte biri i tyre vetëm, por i gjithë popullit, për këtë teorizoi jetën». Kruja telegrafonte: «N'emër të djalërisë të kësaj fortese, kërkojmë që shokët e Tiranës t'a puthin zemrën e kombit, që plumbi tradhëtar të *zbulohej dhe gishti të dënohej*».1) Ndërsa Libohova, vendlindja e heroit, shkruante «se atentati tradhtar kundër Avniut ishte një grusht kundër idealizmës shqiptare, kryer me paramendime dhe ishte antikomëtar»!

Në Korçë, Mihal Gramenua shkruante: «Shqipëria ka veshur cipën e zezë për të», ndërsa Kolonja deklaronte «se populli shqiptar ka për të marrë shpëtim nga faqe dheut nga të gjithë tradhtarët». Normalja e Elbasanit, ku Avniu studioi «zjeusi e gjithë Shqipëria, dhe shprehu urrejtjen më të madhe kundër bishave me fytyrë njeriu, që vranë birin besnik të popullit shqiptar»2) Kur mori vesh vdekjen e Avniut, Gjirokastra mbajti zi një ditë e gjysmë për të.

Nxënës e mësues në Vlorë mësuan me pikëllim të thellë vdekjen e «të vdekurit të pavdekshëm»3). Mësuesi i vizatimit në shkollën Muradije të Vlorës, ditën e 22 prillit 1924 erdhi me vonesë në klasë. Ishte dyllë i verdhë në fytyrë, me sy të lotuar dhe me buzët që i dridhej. Kësaj here kishte lënë në shtëpi çantën dhe fletoren e vizatimit. Pasi doli përpara klasës, përpara nxënësve që kishin ngulur sytë te ai u tha atyre se mësim nuk do të bënin. Zëri i

1) Fondi i Qendrës Kulturore Gjirokastrë.

2) Po aty,

3) Shefqet Musaraj. Vlora, Vlora! Almanak letrar, Nr. 4, Vlorë f. 57.

tij ishte fare i mbytur, lotët nuk e linin të fliste, megjithatë ky lajmëroi me ngashërim vdekjen e Avni Rustemit¹⁾. Ai shtoi se kjo ishte një hata për Shqipërinë, se më vonë do ta kuptonin se sa e rëndë ishte kjo humbje për vendin tonë.

Nxënësit, të prekur nga lotët e mësuesit, mbetën si të mpirë dhe në dhomën e mësimit dukej sikur as frymë nuk po mirrin gjithë ata fëmijë të pikëlluar, njeri prej të cilëve, Shefqet Musaraj, që shkruan këto radhë, e kishte parë disa herë Avni Rustemin «që të hynte e të dilte në shtëpinë ku banonte me qira Halim Xhelua në Lagjen e Re, afër spitalit, në rrugicën prej kalldrëmi të vjetër, që ngjitej përpjetë bregut me ullinj».²⁾

Si kudo edhe një shtëpi vlonjate e kishte mbuluar zija. Dy plaka fshatare, gjyshja dhe nëna e Halim Xhelos, të ulura pranë e pranë, të ndriçuara nga një dritë e pakë e llambës me vajguri, mallkonin orë e çast dorën që bëri hatanë». E shoqja e Halimit qante me lot «që kullonin mbi djep, kur po i jipte gjii fëmijës, që të mos qante».³⁾

Në shtyllat e telefonit, nëpër mure, të nesërmen ishin vendosur letra me vija të zeza anëve, ku me gërma të mëdha ishin shkruar fjalët «Zi për heroin kombëtar Avni Rustemin!» Atë ditë qarkulloi një broshurë e vogël me kapak të hollë ngjyrë trëndafili, që përmbante një vjershë të gjatë, të shkruar në dialektin kosovar, hartuar për Avniun. Nxënës e nxënëse derdheshin nëpër oborret e Vlorës, për të mble-

1) Shefqet Musaraj. Vlora, Vlora! Almanak letrar, Nr. 4.

2) Shefqet Musaraj. Vepër e cituar, f. 59.

3) Po aty.

dhur lule, për t'i vendosur në arkivolin e «Lules së Shqipërisë dhe të heroit të pavdekshëm».1)

Në mes të këtij pikëllimi të përgjithshëm që ishte mbarë populli ynë, feudalët, ministrat, bajraktarët, bejlerët e tradhtarët, që kishin gisht në këtë vrasje, të trembur nga hakmarrja popullore s'dinin ku të futeshin. Mufit bej Libohova, i trembur nga forca e hakmarrjes popullore, e la vrapin në Shkodër. Të tjerët u mbyllën vrimave, dhe nuk dukeshin më si përpara. Revolucioni ishte në shpërthim e sipër.

Populli që mendoi ta kishte gjithnjë pranë zemrën e Avniut, të atij luani zemërçelik, kërkoi që zemra e patriotit dhe e trimit me fletë, të hiqej nga trupi, e pas ballcamimit në Spitalin e Tiranës të ruhej si simbol/ Autopsia provoi «se plumbi në drejtim nga pas. kish hyrë ndënë sqetullën e djathtë, dhe mbasi kish çpuar pak mëlcinë e bardhë, tej përtej pankreasin, shpretkën, stomakun dhe këmishtë e dhjavit, kishte ngelur në lëkurë».2)

Revolucionarët e rinj e anëtarët e shoqërisë «Bashkimi» e ruajtën zemrën e kryetarit të tyre revolucionar si kujtim trimërie e patriotizmi, ndërsa shtypi demokratik i kohës shkruante «se djalëria revolucionare e pa zemrën e tij të qitun, ku ishte e përshkueme me fjalë arit epoka e famshme e kalorësisë, lulëzue e kurorëzue me besë, burri e trimi, dashuni e shpirtmadhësi, prej kah Avniu i Labërisë u ndez flakë e dashuni për Shqipërinë».3)

Kështu e nderoi populli ynë zemrën e Avniut, që ndonëse jetoi vetëm 29 vjet, 7 muaj e 22 ditë,

1) Shefqet Musaraj. Vepër e cituar, f. 59.

2) Gazeta «Tirana». 27 prill 1924, Nr. 1.

3) «Politika». Vlorë, 8 maj 1924.



Avniu si asamblist më 19 prill 1924, një ditë para vrasjes nga agjentët e Ahmet Zogut.



Varrimi madhështor i heroit në Vlorë,
ku marrin pjesë rreth 10.000 veta.





Busti i Heroit të Popullit A. Rustemi në Vlorë.

kreu një vepër të pavdekshme. Thellë e ndjenë humbjen e Avniut jo vetëm vegjëlia por edhe gjithë patriotët e udhëheqësit e lëvizjes demokratike.

Me zemër të plagosur ishte Bajram Curri, i cili tha se: «Avninë na e vranë bash ata hajna qi duen me na vra tanë Shqypninë; porse gabohen se Shqypnia ka djemt e vetë qi do ta ruejnë si sytë e ballit»¹⁾.

Të helmuar për vdekjen e patriotit të madh edhe disa, oficerë të rinj demokratë e antizogistë, ngushëlluan familjen e Avniut. Kështu vepruan edhe shqiptarët e mërguar, kudo që ishin e kudo që punonin. Nga Stambolli shqiptarët e mërguar shkruanin se «Avniu u la atyre si trashëgim të paharruarat veprat e tij të shkëlqyera».²⁾

Tirana e gjithë, e pikëlluar për vdekjen e tij, ishte në këmbë. Mbarë populli i kryeqytetit u mobilizua për të nderuar kujtimin e Avniut. Me vajet e grave të Labërisë u përcoll trupi i tij, nga spitali gjer në sheshin kryesor të kryeqytetit. Trupi i heroit ishte i mbuluar me flamurin kombëtar, të qëndisur nga shoqëria e grave të Tiranës. Përpara arkivolit të tij folën oratorët, të cilët vunë në dukje veprën e Avniut, dhe treguan se një popull i tërë do të dinte t'i mirrte hakun. Trupi i Avniut u përcoll gjer në vendin, ku ndahet rruga e Kavajës me atë të Durrësit dhe aty u vendos në një makinë të veçantë dhe u nisën për në Durrës, të pasuar nga shumë makina të tjera.

Gjatë gjithë rrugës, për të nderuar kujtimin e

1) Fondi QK Gjirokastrë.

2) Po aty.

tij dolën fshatarët që t'i jepnin përshëndetjen e fundit heroit dhe për t'i treguar edhe një herë respektin që ushqenin ata për veprën e tij. Po kështu në Durrës doli tërë populli për ta përshëndetur. Aty e mori fjalën Ibrahim Arapi¹⁾ i cili me gjithë ndërhyrjet e policisë mundi të vinte në dukje meritat e shquara të kryetarit të shoqërisë «Bashkimi». Agjentët e prefekturës dhanë urdhëra të rrepta, për të ndaluar mitingjet, fjalimet e shpërndarjen e gazetave demokratike, që shkruanin për heroin.

Megjithatë, kudo u mbajtën fjalime dhe gazetat u shpërndanë. Populli e përcillte trupin e Avniut në liman, për ta çuar me anën e detit në Vlorë, e cila kërkoi ta kishte trupin e heroit në gjirin e vet, ashtu si e pati në krye të demonstratave, në krye të shoqërive përparimtare.

1) U ekzekutua më 1926 nga satrapi Zog, me varje në litar, për pjesëmarrje në një atentat kundër tij.

VARRIMI I AVNIUT — BETIMI I POPULLIT

«Po të kishte shpëtue gjallë, prapë Shqypnisë do t'ia falte jetën, se për Shqypninë kishte le Avnija».

BAJRAM CURRI

Atë ditë Vlora doli për të dytën herë, por këtë radhë jo për ta pritur Avniun e gjallë, por trupin e revolucionarit e patriotit të madh. Në liman kish dalë tërë qyteti, ashtu sikurse 40 muaj përpara, kur dolën për ta përqaftuar kur kthehej nga Parisi. Atëherë njerëzit uleshin në gjunjë dhe i rroknin atë dorë, me të cilën kishte shtrirë për tokë pashanë e tradhtive e të komploteve të panumërta, kurse tani ata kishin dalë për të marrë në sup trupin e tij.

«Një lumë njerëzish e kurorash mbulonte tejprtej rrugën Skelë-Vlorë. Në krye të korteut ishin nonja tridhjetë vajza të veshura me fustane të bardha, me kryet mbështjellë me lahure të zinj, që u vareshin prapa, gjer në mes të shpatullave. Prapa tyre ecte ngadalë, me hapin e rënduar të njerëzve qerrja e mortuar e tërhequr nga kuaj të lartë, të mbuluar fund e krye me rrobe të zeza, që sa u dukeshin vetëm sytë nëpër vrimat e lëna apostafat.

Në miting folën rreth 16 oratorë. Foli një shok i Avniut, i cili duke dënuar vrasësit, tregoi se ata nuk dolën përballë tij, sikurse i kishte dalë Avniu tradhtarit në Paris, porse vrasësi «fshehtasi i ishte afruar për mbrapa dhe e goditi atë me një plumb, me të cilin hidhëroi gjithë ndjekësit e Avniut».1)

Por këtu nuk folën vetëm oratorët. Titujt e gazetave, me shkronja të zeza që ishin hartuar me dorën e Halim Xhelos jepnin lajmin e hidhur. Ato shkruanin «se idetë nuk vdesin, se plumbi feudal ka goditur idealin shqiptar, se shkolla e Avniut ka për të rritur të tjerë therorë».2)

Pati në ato ditë patriotë që shkruanin se Shqipëria ishte veshur me të zeza për Avni Rustemin. Kishte gazetarë, si ata të fletores «Shkumbini», që e cilësuan Avniun «shtyllën e demokracisë, lule të djelmërisë, përkrahës të nxehhtë të bujkt».

Revolucionarë të rinj i mbanin tashti kurorat e tij në duart e tyre. Ata ishin bashkëpunëtorë e nxënës të tij. Njëpër shiritat e kurorave të dërguara nga të gjithë anët e vendit lexoheshin:

«Avniu, dëshmor, ideali i tij gjallë».

Ishte aty kurora e Libohovës me mbishkrimin «Libohova — Avni Rustemit e ndriçuar me dritën e tij». Dallohej kurora me trëndelinat e Çajupit, që nuk fishket kurrë, përgatitur nga shokë klubesh e shoqërisë të Gjirokastrës.

Aty shikoje lulet e Elbasanit me kurorën e Normales, ku ishin shkruar fjalët: «Shembëlltyrës së atdhedashurisë shqiptare; dëshmor i tradhtisë 500

1) Fondi QK Gjirokastrë — KOSH.

2) «Politika», Vlorë, 24.4.1924.

vjeçare». Binte në sy edhe kurora e Luigj Gurakuqit, ku shkruhej: «Më të madhit idealist shqiptar». Ajo e Gjirokastrës me fjalët: «Djalit tonë Avni Rustemit», kurora e shoqërisë kosovare «Shkodra» me mbi-shkrimin «Heroit të vet».

Me lulet e Vlorës ishte mpleksur kurora e saj me fjalët: «Mësuesit e udhërrëfyesit të edukatës kombëtare».

Nëpër qoshe të rrugëve e të sheshit qëndronin agjentët e qeverisë së bejlerëve, që kërkonin të shënonin emrat e atyre që kishin ardhur aty. Ata ishin porositur nga ministri i Drejtësisë Mufit bej Libohova, i cili duke iu drejtuar prokurorisë së Vlorës kërkonte ndihmën e saj për të ditur emrat e nëpunësve që kishin shkuar në varrimin e Avniut. Ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme, me telegramin e saj rezervat të datës 3 maj, kërkonte të dinte emrat e atyre që i kishin drejtuar telegrame Qeverisë së Tiranës, ku shfaqnin «një frymë revolucionare».

Mirëpo as kërcënimet dhe as urdhërat nuk frikësuan njeri. Cilin vallë mund të shënonin më parë agjentët e Qeverisë së Tiranës në defterin e tyre? Ata që flisnin? Ata që mbanin kurorat, apo popullin mbarë të mbledhur në Vlorë?

Dikur, më 16 maj 1920 rreth 400 të rinj vlonjatë hartuan një thirrje për djalërinë shqiptare, duke thënë se «theroria që kanë premtuar të bënin për atdheun e dashur, duhej bërë sot». ¹⁾ Ndërsa më 24 maj 1924, anëtarët e «Bashkimit», në një mbledhje të gjërë, në Vlorë, thërrisnin se «sot shpëton kombi nga robëria ose kurrë, se sot nga varri i tij Avniu thërret për bashkim e për betim» ²⁾ Në tërë

1) QK Gjirokastër.

2) Po aty.

anët e vendit iu përgjigjën thirrjes së djalërisë për t'u ngritur me armë kundër reaksionit çifligar.

Situata e krijuar në mbarë Shqipërinë, qëndrimi revolucionar i masave popullore, urrejtja e popullit për feudalët, i alarmoi qeveritarët antipopullorë të Tiranës dhe veglat e tyre. Tashmë urrejtjen popullore nuk mund ta përmbante asgjë. Shpërtheu Revolucioni demokratiko-borgjez i qershorit 1924. Forcat kryengritëse pas luftimesh të ashpra fituan mbi forcat e reaksionit çifligar. Pas fitores u formua Qeveria Demokratike e kryesuar nga Fan Noli.

Më 18 qershor 1924 Qeveria e Fan Nolit shpalli programin e saj ku publikonte objektivat e saj. Midis të tjerash ajo premtonte se do të zgjidhte problemet kryesore ekonomike. Do luftonte për përmirësimin e gjendjes së fshatarësisë e do të luftonte kundër klikave çifligare. Por këto premtime nuk u realizuan. Qëndrimi i lëkundshëm, i pavendosur, i udhëheqësve demokratë të revolucionit bëri që masat e gjëra të popullit të shkëputeshin prej tyre. Vetë Fan Noli deklaronte se ardhja e tij në fuqi shkaktoi zemërimin e aristokracisë së tokës, por duke mos i goditur ata, ai humbi mbështetjen e masave fshatare.

Populli u revoltua, kur mësoi se Mufit Libohova, i arrestuar në Shkodër, iku nga burgu dhe u arratis jashtë shtetit. Familja e Avniut e cilësonte atë «shkaktarin kryesor të vrasjes»²⁾, «tradhtarin që leu duart me gjakun e Avniut.» Akoma më shumë u revoltua populli dhe revolucionarët, kur mësuuan këtë fakt. Ata, ikjen e Mufitit nga burgu, të cilin e

1) QK Gjirokastrë.

2) QKGJ. Dokumenti i datës 17.6.1924.

konsideronin si kallauz të vrasjes së Avni Rustemit, e cilësuan falimentim të revolucionit dhe një pazotësi monumentale e gjyqit politik». ¹⁾

Masat popullore u revoltuan kur panë se këto forca reaksionare ishin lënë të lira të jetonin e të vepronin akoma edhe brenda në kryeqytet.

Qeverisë së Nolit i mungoi shpirti revolucionar, prandaj shoku Enver, duke folur për të thekson se «...qeveria që doli nga revolucioni demokratiko-borgjez nuk bëri reformat politike dhe ekonomike që kishin në mendje a në plan Avniu, shokët e tij e djalëria, që i vinte atij pas, dhe kështu revolucioni dështoi». ²⁾

I pashlyer mbeti në mendjet e në zemrat e revolucionarëve tani Avni Rustemi. I paharruar mbeti ai tek populli, i cili i këndoi me afsh patriotik, me vargjet e rapsodit popullor «Mos pande se u harrove, lule o Avni Rustemi»... Populli ka ditur ta ruajë të pavdekshëm kujtimin dhe veprën e tij, duke nderuar gjithashtu prindërit, që e ndjenin veten krenarë e që deklarorin «se gëzimi i pavdekur ishte dhe do t'ishte vetëm vijimi i programit të Avniut»... ³⁾

Anëtarët e degës së shoqërisë «Bashkimi», në Kavajë, propozuan që në gazetën «Bashkimi» të vihej data lindjes së Avniut. Në përvjetorin e dytë të vrasjes së tij, mësuesi i historisë në shkollën e Parrucës në Shkodër, patrioti Halim Shpuza, u foli nxënësve për figurën e Avni Rustemit. ⁴⁾ Po kështu ve-

1) QKGJ. Dokumenti i datës 17.6.1924.

2) Enver Hoxha. Fjala në Libohovë. «Zëri i popullit», 29 maj 1969.

3) QK Gjirokastër.

4) Deklaratë nga nxënës të vitit shkollor 1925-1926. QK Gjirokastër.

pruan edhe anëtarë të ish-shoqërive demokratike, që kishin punuar tok me Avniun, qysh në moshë të re. X Burim frymëzimi u bë Avniu dhe vepra e tij. Kujtimi dhe vepra e tij u përjetësua veçanërisht gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Me emrin e tij u emëruan çetat e para partizane. Por vepra e Avniut u vlerësua ashtu siç meritonte vetëm në epokën e Partisë. Sot emri e vepra e tij është e njohur kudo, në çdo cep të atdheut, për të cilin ai nuk kurseu as pikën e gjakut.

Te «Vorrezat e pashë», sot Sheshi «Avni Rustemi», në Tiranë ku ai u plagos për vdekje, Partia ngriti bustin e tij krenar dhe i dha atij dekoratën Heroi i Popullit. Në Libohovë, te sheshi, ku dikur tundte kamzhikun beu, qëndron përsëri kryelartë busti i Heroit të Popullit. Busti i Avniut, për jetë do të mbetet i rrethuar me lule, përgjithmonë i kujtuar me respekt. Po kështu me respekt të thellë e mbajnë dhe e nderojnë emrin e tij shumë shkolla të atdheut tonë që mbajnë emrin e heroit.

N Avniu mbetet i gjallë dhe i përjetshëm në muzetë e atdheut, në tablotë kushtuar atij. Emri e vepra e tij u përjetësuan edhe nëpërmjet botimeve të shumta që i janë dedikuar atij, transmetimeve radiotelevizive etj. X

«Partia jonë vuri në pedestal ata heronj si Avni Rustemi, ata luftëtarë të kohëve të kaluara e partizanë trima të kohëve tona që derdhën gjakun për Shqipërinë, për popullin e për rininë tonë».1)

Ky shpirt i paepur revolucionar e kryengritës,

1) Enver Hoxha. Fjalim në Libohovë. «Zëri i popullit», 29 maj 1969.

kjo rrugë militante do të kalojë ashtu siç ka kaluar brez pas brezi, duke u bërë një shembull i madh frymëzimi për mbarë popullin tonë e në radhë të parë për rininë tonë heroike, që janë duke ndërtuar socializmin, të udhëhequr me urtësi nga Partia e shoku Enver Hoxha.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Nga Libohova në shkollën e mesme.....	3
«Një tjetër pushkë mauzer» në Normalen e Elbasanit.	19
Në Zvicër — Shoqëria «Burimi».....	28
Në malet e Kurveleshit.	35
Mësues në Tepelenë dhe në Vlorë.	38
Në Shën Mitër Koronë dhe në Romë.	44
Në Paris.	59
Tribun i popullit.	82
Në gjirin e popullit që e lindi.	87
Kongresi i Vlorës.	95
Lidhja e mësuesve të Gjirokastrës.	101
Nga Jugu në Veri.	107
Organizata «Bashkimi».	112
Pikëpamjet politike e shoqërore të Avniut.	119
Në qendër të lëvizjes politike.	132
Avniu në Asamblenë Kushtetuese.	140
Vrasja e Avniut.	148
Varrimi i Avniut — Betimi i popullit.	163

